REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 40/22
Nr. i fq. / Br. st -1-
Data: / Datum 14. 2. 2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 45.1 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

**Ju fton**

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **24 shkurt 2022 (e enjte) me fillim në ora 10:00.** Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtrri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:

**R E N D  D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 31 janar 2022;
2. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021;
3. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022 – 2026;
4. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2021 në Komunën e Vushtrrisë;
5. Propozim – vendim për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina, për familjet përfituese të asistencës sociale;
6. Propozim – vendim për ndarjen e subvencioneve;
7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e nismës, për identifikimin e shtëpive – shkolla (themelimi i komisionit);
8. Të ndryshme.

**Melihate Basholli-Latifi**

**Kryesuese e Kuvendit të Komunës**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br 39/2022
Nr. i fq. / Br. st -2-
Data: / Datum 14.02.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**
**OPŠTINA VUČITRN**

| | |
|---|---|
| **PËR/ZA/TO:** | **Kuvendin e komunës** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Melihate Basholli Latifi** ______<br><br>**Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë** |
| **PËRMES/PREKO/THROUGH:** | **Sekretarisë së kuvendit** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 14.2.2022** |

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 54, paragrafit 5 të Statutit të Komunës dhe nenit 5, paragrafit 1, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më **14 shkurt 2022** ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit pesëvjeçar të menaxhimit të mbeturinave 2022 – 2026.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

2. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet shëndetësore për vitin 2021 në Komunën e Vushtrrisë.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të plotësohet si informatë dhe të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

3. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2021.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

4. Shqyrtimi i kërkesës për themelim të Asamblesë së Nxënësve.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të hiqet nga rendi i ditës dhe në koordinim me Drejtorinë pë Arsim të ndjeken procedurat për themelimin e Asamblesë së Nxënësve .*

5. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për lirim nga pagesa e taksës për mbeturina.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

6. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për ndarjen e subvencioneve.
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

7. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovimin e nismës për identifikimin e shtëpive – shkolla (themelimi i komisionit).
   *Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:*
   *Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.*

*Me respekt!*

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

**P R O C E S V E R B A L**
**NGA MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 JANAR 2022**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën* ***10:15.***

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:
Adnan Lahu, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nuri Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

**Mungoi:** Gentiana Rama.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, nënkryetari i komunës z. Shpëtim Zhegrova, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Në fillim të mbledhjes kuvendi nderoi me një minutë heshtje veprimtarin dhe ish-drejtorin e Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, të ndjerin Miran Halili. Po ashtu u nderuan edhe luftëtarët e lirisë, heronjtë e Kosovës Zahir Pajaziti, Edmon Hoxha dhe Hakif Zejnullahu.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** në fillim të mbledhjes duke ju adresuar kuvendit theksoi se: për disa herë gjatë prononcimeve të kryetarit të komunës po i njofton qytetarët e Vushtrrisë se e keni marr udhëheqjen e Komunës së Vushtrrisë me një borxh të trashëguar rreth 6 milionë euro, dhe këtë thuajse në çdo prononcim të juanin. Kryetar për hir të qytetarëve, të cilët po na dëgjojnë dua t'ju njoftoj që kjo shifër dhe ky borxh i pretenduar nuk është real.

Detyrimet kontingjente janë detyrime, të cilat mund t'i krijohen komunës nga kontestet gjyqësore që komuna i ka me palët e tjera. Gjithashtu ju njoftoj që detyrimet kontingjente në komunën tonë

ishin afër 3 milionë € kur Lidhja Demokratike e Kosovës erdhi në pushtet në Vushtrri. Gjatë katër viteve të fundit këto detyrime janë zvogëluar për afër 2 milionë euro që janë paguar për kontratën kolektive dhe shujtat e mësimdhënësve. Prandaj kryetar sa i përket detyrimeve kontingjente ju ftoj që të publikoni dokumentet, kontestet që Komuna e Vushtrrisë i ka në gjykatë me palë të tjera dhe të shihet që këto detyrime janë qysh prej kohës kur Vushtrria udhëhiqej nga Partia Demokratike e Kosovës. Gjithashtu obligimet kontraktuale nuk janë borxhe kryetar, janë kontrata që qeverisjet lokale i lidhin me operatorë ekonomik për periudhën dy (2) deri në trivjeçare (3), pra janë kontrata të nënshkruara që komuna jonë duhet t'i mbulojë nga buxheti i vitit vijues dhe nuk janë borxhe. Andaj kryetar ju lutem që të mos e keqinformoni opinionin publik. Në anën tjetër kryetar, në mesin e shumë premtimeve që ju i keni dhënë qytetarëve të Vushtrrisë janë edhe 55 premtimet e juaja të cilat keni premtuar që do t'i realizoni në 55 ditëshin e parë. Sot jemi në ditën e 56 nga marrja e pushtetit nga ana juaj kryetar, a ka mundësi të na njoftoni se a janë realizuar këto premtime të juaja për këtë 55 ditëshin e parë, në mesin e tyre : 10.Trajtimi i problemit me qentë endacakë; 12. Takim me të gjitha shoqatat kompetente për t'u dakorduar për hapjen e zyrës për promovimin e turizmit malor; 16. Zgjedhja e problemit të ndriçimit në fshatra; 21. Pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve. 22; Rikonstruimi i parkut të qytetit; 41. Takimi me përfaqësuesit e fshatrave për vendosjen e gypit kryesor të kanalizimit përgjatë lumit "Silnica"; 46. Pajisja e zjarrfikësve me veshje dhe mjete moderne; 47. Shndërrimi i Hamamit në galeri të arteve, e kështu me radhë. Kryetar nëse keni realizuar ndonjërin nga 55 premtimet për 55 ditët e para a mund të na tregoni se cilat janë ato premtime të realizuara.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** pasi i përshëndeti të pranishmit, kërkoi informacione nga ana e kryetarit të komunës sa i përket realizimit të premtimeve në 55 ditët e para qeverisëse, kësisoj në ditën e shtatë (7) –nisma për themelimin e zyrës për hartimin e projekteve, në ditën e 10 fillimi i trajtimit të problemit me qentë endacakë, në ditën e 11 takimi me institucionet përgjegjëse për hartimin e kalendarit turistik, nëse një punë e tillë është kryer, atëherë si grup kuvendar kërkojmë që ai kalendar t'u dërgohet ashtu siç janë të informuar, në ditën 12 takimi me të gjitha shoqatat kompetente për t'u dakorduar për hapjen e zyrës për promovimin e turizmit malor, nëse është hapur kjo zyrë të bëhet i ditur vendi i asaj zyre dhe funksionimi i saj, në ditën e 13 fillimi i realizmit të mbulimit të normës së interesit për stimulimin e bizneseve në shumën deri në 20,000.00 €, në ditën e 16 do të fillojë zgjidhja e problemit të ndriçimit në qytet dhe fshatra, në ditën e 17 organizimi i takimit me kompanitë për rregullimin e trafikut urban, kërkoi të bëhen të ditura se cila prej këtyre kompanive ka pasur takim kryetari i komunës, në ditën 19 fillimi i rikthimit të bufeve nëpër shkolla, në cilat shkolla janë hapur këto bufe, në ditën e 20 rregullimi i ndriçimit dhe ulëseve tek shëtitorja "Enver Zymberi" , në ditën 21 fillimi i rregullimit dhe pastrimit të shtretërve të lumenjve, në ditën 22 fillimi i rikonstruktimit të parkut të qytetit, vendosja e detektorëve në drunj, në ditën 24 fillimi i implementimit të planit për financimin e bizneseve individuale me shumat 2000-4000 dhe 10,000.00 €, në ditën e 26 fillimi i implementimit të planit për pajisjen e laboratorëve me pajisje për shkollat profesionale, në ditën e 28 fillimi digjitalizimit të gjitha qendrave të mjekësisë familjare dhe ambulancave, në ditën 29 fillimi i reformimit të sektorit të shëndetit oral, në ditën 30 avancimi i sektorit diagnostik në shëndetin primar, ku shihet se në këtë segment kemi një disavancim, ku prej 19 parametrave kemi ra në 2 parametra diagnostik, takimi me përfaqësuesit e familjeve të pastreha për ndërtimin e banesave për banim social, që është një projekt shumë i qëlluar, por kërkoj të bëhet e ditur se a është i inkorporuar në buxhetin për vitin 2022. Për të gjitha këto tema, kërkoi si grup kuvendar t'u ofrohet një raport për realizimin e këtyre punëve dhe projekteve, përtej kësaj ngriti çështjen e vijueshmërisë së mjekut në ambulancën mjekësore në

fshatin Oshlan, çështje kjo e propaganduar se sukses dhe mbajtje e premtimit gjë kjo e cila nuk është e vërtetë, sepse mjeku edhe më herët ka shërbyer atje, për më shumë për të qenë ndryshe kjo çështje, ai kërkoi të publikohet kopja e protokollit e të njëjtës ambulantë, ku njerëzit dhe mjekët janë dëshmitarë të gjallë që kanë shërbyer atje. Në të kundërtën nëse vërtetohet e kundërta se mjekët nuk kanë shkuar atje, kërkoi nga menaxhmenti që të ndërmerren masa ndaj atyre mjekëve.
**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** pasi përshëndeti të pranishmit, njoftoi se ashtu si ka premtuar në fushatën zgjedhore, për projektet për 55 ditët e para qeverisëse ashtu edhe është duke i realizuar takimet me përgjegjësit që lidhen me domenin e kompetencave në realizimin e atyre projekteve të premtuara. Nëse lexohet në detaje plani del se p.sh në ditën e parë është planifikuar fillimi i skanimit të gjendjes sa i përket furnizimit me ujë të pijes dhe instalimit të rrjetit të ujësjellësit, lidhur me këtë çështje ai ka mbajtur tri takime dhe kështu kemi filluar të merremi me zgjidhjen e këtij problemi. Në këtë kontekst është themeluar një grup punues i cili ka hartuar një raport, ku është konstatuar se në disa fshatra për shkak të mungesës së shtypjes së ujit nuk shkon uji dhe këtu mendohet të bëhet një zgjidhje tjetër. Lidhur me problemin e qenve endacakë, është kontaktuar një kompani nga Zvicra, ku do të vazhdohet kontrata për trajtimin e qeneve endacakë. Tutje shtoi se ka pasur takim me bizneset, taksit dhe është duke ju përmbajtur me përpikëri planit. Sa i përket deklarimeve për borxhet, shtoi se koha do të dëshmojë se ai ka pasur të drejtë, dhe për këtë parashtroi shembull me depon e patates, i cili projekt është dashur të përmbyllet në muajin korrik 2021, ku komuna ka pagur mjete financiare për këtë projekt, ndërsa ai projekt nuk është realizuar kurrë, dhe rasti tjetër është rruga Vushtrri-Nadakoc-Pestovë, por ka edhe tjera projekte ku komuna ka borxhe, ndërsa projektet nuk janë realizuar. Sa i përket mjekut në fshatin Oshlan ai e siguroi këshilltarin e kuvendit se mjeku në këtë fshat nuk ka vijuar në punë dy herë në javë ashtu siç e ka pasur për obligim.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit -** tha se pasi që Kopshti "Foleja" është mbyllur si rezultat i masave anti-covid-19, kërkoi që prindërit, fëmijët e të cilëve vijojnë në këtë kopsht të lirohen nga pagesa e taksës për këto shërbime, për muajin shkurt. Pastaj ngriti çështjen e mospërfilljes së vendimit të MASHT-it, nga ana e menaxhmentit të shkollës "Andon.Zako.Çajupi", për kompensimin e orëve të humbura si rezultat i vonesës së fillimit të vitit shkollor, shkollë kjo e cila ka hartuar një plan vetanak për kompensimin e orëve që bie ndesh me vendimin e ministrisë. Mandej çështja e shpalljes së një tenderi nga komuna në muajin tetor për asfaltimin e shtatë rrugëve në fshatin Stanoc i Epërm e që përfitues i këtij tenderi është "Bageri Kompani" nga vizita në terren del se vetëm katër rrugë janë asfaltuar, andaj lidhur me këtë pyeti qeverinë komunale se cilët do të jenë hapat e mëtejmë lidhur me këtë çështje, dhe cilat janë veprimet ligjore që do të ndërmerren.
**Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës -** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika për lirimin nga pagesa e taksës për çerdhet publike për prindërit, fëmijët e të cilëve marrin shërbime në këto çerdhe.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** lidhur me rendin e ditës vlerësoi se kemi të paktën pesë pika të cilat nuk kanë kaluar fare në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe shtoi se nga praktika e kaluar, procedimi i pikave në kuvend pa kaluar në filtrin e KPF-së është bërë kur temat kanë pasur ndonjë urgjencë, ndërsa pikat që ne sot i kemi para vetes nuk janë të natyrës urgjente, andaj kërkoi sqarime se përse të njëjtat janë procedura.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** vlerësoi se është i çuditshëm fakti se qysh në seancën e parë të procedohen materiale pa kaluar në KPF dhe ceku se me një pajtueshmëri me të gjithë këto pika mund të largohen nga rendi i ditës pasi që të njëjtat nuk kanë ndonjë urgjencë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit -** tha se është e vërtetë se disa prej pikave të rendit të ditës nuk kanë kaluar në filtrin e KPF-së, por se të gjitha këto tema janë të natyrës urgjente siç është formimi

i komisioneve për ndërmarrjet publike, Komiteti për Komunitete, por edhe nisma për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, janë të natyrës urgjente, sepse kanë ndryshuar rrethanat dhe legjislacioni dhe ka nevojë që të plotësohet ky statut.
**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** duke arsyetuar rendin e ditës, vlerësoi se është në dorën e kuvendit që të vendos për procedimin e pikave të rendit të ditës apo jo, por nëse i analizojmë pikat një nga një del se të gjitha e kanë rëndësinë, peshën dhe urgjencën e vet, andaj i sugjeroi anëtarëve të kuvendit që në mënyrë të lirë të vendosin nëse dëshirojnë që të procedohen apo jo. Në vazhdim ai arsyetoi secilën pikë një nga një duke gjykuar se të gjitha pikat kanë urgjencën e tyre sikur është ajo për themelimin e komisionit për intervistimin e drejtorëve të shkollave.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** përsëriti se nuk është mirë të bëhet praktikë që pikat të sillen në kuvend pa kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, dhe i sugjeroi kryesueses së kuvendit që herëve tjera mos ta lejoj këtë gjë.

**Në fund të debatit jashtë rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" aprovoi këtë:**

## R E N D  D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 6.12.2021;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14.1.2022;
3. Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021;
4. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
6. Shqyrtimi i propozim – buxhetit për vitin 2022;
7. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
8. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
9. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit komunal të aksionarëve në KRM "Uniteti" Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtrri;
10. Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit komunal të aksionarëve në NPL "Përparimi" SH.A, në Vushtrri;
11. Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelim të Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet edukativo arsimore dhe aftësuese parauniversitare në Komunën e Vushtrrisë;
12. Shqyrtimi i kërkesës të Kryetarit të komunës për miratimin e nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të komunës;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e Komisionit për përgatitje të draftit të Statutit të komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të komunës;
14. Shqyrtimi i peticionit të ish-banorëve të fshatit Skoçan për përfshirje në buxhetin e vitit 2022, asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Skoçan me Vushtrrinë.
15. Shqyrtimi i propozim-vendimit për lirimin nga pagesa e taksës për shërbimet e çerdheve publike në Komunën e Vushtrrisë;
16. Shqyrtimi dhe aprovimi i deklaratës për mbështetjen e profesorit Lulizim Paci.

**1.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 6.12.2021

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 6.12.2021.**

**2.** Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14.1.2022

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** kërkoj që të bëhet korrigjimi i procesverbalit në faqen nr.5 ku thuhet: Adnan Lahu, anëtar i kuvendit të shtohet fjalia në emër të LDK-së, ndërsa tek Behar Duraku të mbetet vetëm anëtar i kuvendit.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota "unanime" aprovoi procesverbalin nga mbledhja jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 14.1.2022, me korrigjimin e lartshënuar.**

**3.** Shqyrtimi i Raportit për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën janar – dhjetor 2021

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit -** tha se në analizë pak më të thellë del se raporti ka disa gabime, fillimisht në titull të raporti thuhet raport tremujor janar-dhjetor, d.m.th është raport vjetor e jo raport tremujor. Tutje shtoi se në raport evidentohet një shpërputhje mes planifikimit dhe realizimit të të hyrave, andaj shihet se kemi një planifikim joprofesional, sepse është alogjike të planifikohen 12, 000.00, ndërsa të teprojnë 15.000.00 €. Tutje shtoi se kemi rritje drastike të shpenzimeve sa i përket drekave zyrtare nga viti 2020 në vitin 2021, dhe kjo a ka ndodhur për shkak të fushatës zgjedhore apo për çfarë arsye. Derisa në vitin 2020 për dreka zyrtare kishim të shpenzuara 17,065.30 €, në vitin 2021 kemi një rritje prej 31,183.68 €. Lidhur me borxhin qeveritar në vlerën prej 24, 730.092 €, pyeti se për çfarë borxhi bëhet fjalë.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** tha se raportin të cilin e kemi përpara është një raport i hartuar në mënyrë joprofesionale, në raport mungojnë komentet për secilën fushë dhe kod ekonomik. Sa i përket shpenzimeve për furnizim me dru nëpër shkolla, ku kemi një diskrepancë ndër vite, ku në vitin 2020 kemi pasur të shpenzuara 47,000.00 €, ndërsa në vitin 2021 kemi 190,000.00 €, ky dallim ka ndodhur për faktin se në vitin 2020 kishte dështuar tenderi për furnizim me dru, ndërsa pagesa për furnizim me dru është bërë në vitin 2021 për vitin 2020. Sa i përket referimit në një borxh qeveritar sqaroi se bëhet fjalë për një borxh ndaj Komisionit Evropian, më saktësisht për fabrikën e riciklimit në fshatin Bukosh, por ky borxh ka qenë shumë herët në emër të komunës.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar parafolësve, vlerësoi se sa i përket emërtimit të raportit si raport tremujor, këtë kritikë e kishin bërë edhe në kohën kur Nasuf Aliu ishte kryesues, por asnjëherë nuk ishte përmirësuar. Tutje shtoi se në raport evidentohen disa shqetësime të cilat nuk e di se si do të mund t'i arsyetojmë edhe para vetes e edhe para qytetarëve. Pastaj ceku se tek të hyrat e realizuara kodi 660, kemi një performancë shumë të lartë, ku bëhet fjalë për lejet ndërtimore ku realizimi është 533,178.24 €, pastaj lejet mjedisore 63,989.72 €, por çka është më e mirë është se kemi një vlerë të lartë sa i përket legalizimit të objekteve 18,365.90 €, por në këtë pozicion ai i ka dyshimet e tij dhe për këtë kërkoi përgjigje me shkrim se për çfarë legalizimi të

objekteve bëhet fjalë, për ato të vjetra apo për cilat objekte. Pastaj tek përmbledhja e shpenzimeve sipas burimit të financimit, kemi një suficit prej 2, 563.588.99 € që tregon një performancë jo të mirë të shpenzimit të buxhetit dhe të menaxhimit të parasë publike. Mandej është interesante që tek përmbledhja e shpenzimeve sipas kategorisë së lartë të shpenzimeve, kodi 111 kategoria paga dhe mëditje, pyeti se si është e mundur që realizimi të jetë 100 %, kjo është shqetësuese nëse vetëm paraqiten shifra sa për të plotësuar dëshira, sepse vlera prej 10, 603. 183.40 € në tërësi është shpenzuar dhe kjo as teorikisht nuk është e mundur, e lëre më kur ia shtojmë faktin se disa vende pune janë vakante si rezultat i pamundësie së zhvillimit të procedurave të rekrutimit. Tek mallrat dhe shërbimet kodi ekonomik 14410, vendimet e gjykatave për vitin 2020 paraqiten 717,648.07 €, ndërsa në vitin 2021 vetëm 7,271.64 €, për këtë jemi në dijeni se janë përmes përmbarimit shujtat e mësimdhënësve dhe ato të mjekëve, në vitin 2021 kemi pasur edhe vendime të dyshimta të gjykatave që janë realizuar si p.sh ajo e kompanisë "Astra Pllan" në vlerë prej 70,000.00 € e cila këto mjete i ka marrë në saje të një vendimi gjyqësor të dyshimtë, e që nuk kemi deklarime se zyra ligjore e komunës a e ka mbrojtur interesin e komunës apo kemi hapësirë për ndonjë hetim të kësaj çështjeje. Andaj vetë pagesa me vendim gjyqësor për Kompaninë "Astra Pllan" në vlerë mbi 70, 000.00 € bëjnë më shumë se vlera totale e këtyre shpenzimeve për vitin 2021 e paraqitur në raport në vlerë prej 7,271.64€. Dhe si përfundim i krejt kësaj pa hyrë në detaje tjera kërkoi nga ZKF-ja që në formë analitike të ofrojë shënime lidhur me shpenzimet, të hyrat dhe planifikimet, në të kundërtën ne si kuvend po kalojmë një dokument i cili nuk i përmbush standardet e raportimit të drejtë e korrekt, e madje ka edhe vend për pasaktësi e dyshime, të cilat fshehin vendime gjyqësore që realizohen e të njëjtat nuk raportohen në kuvend, ku qëndron zyra ligjore këtu e cila po fshehet, ku është përfaqësimi, çka kanë përfaqësuar, kënd e kanë mbrojtur e kënd e kanë favorizuar. Lidhur më këto ai kërkoi nga zyra ligjore e komunës që në kopje fizike t'i ofrohet lënda e kompanisë <Astra Pllast>, me të gjitha shkresat e lëndës, mënyrën e përfaqësimit, deklarimi i zyrës ligjore para gjykatës, ushtrimi i rregullt dhe brenda afateve ligjore i mjeteve juridike apo ka pasur ndonjë marrëveshje të dyshimtë dhe të fshehtë.

**Faton Hyseni, anëtar i kuvendit -** kërkoi sqarime se përse anëtari i kuvendit Adnan Lahu, nuk u përgjigj në pyetjet e Nasuf Aliut, anëtar i kuvendit nga radhët e LVL-së, lidhur me shpenzimet për drekat zyrtare për vitet 2020-2021.

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** përsëriti se raporti është joprofesional dhe si i tillë nuk është i shoqëruar me komente sqaruese, për çka e kemi tërhequr vëmendje edhe më herët.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** tha se në përgjithësi pajtohet me deklarimet e anëtarëve të kuvendit se raportit i mungon ana analitike dhe komentet shoqëruese për secilin kod ekonomik dhe shpenzim buxhetor. Ai ka mendimin se kërkesat e parashtruara të përmbledhura të procesohen dhe evidentohen në procesverbal dhe përgjigjet të merren nga dikasteret komunale, por mbi të gjitha ky raport do t'i nënshtrohet edhe procedurave të auditimit të përgjithshëm, ku nga fundi i vitit do të jetë rasti që të gjitha këto çështje të ngritura të dalin në sipërfaqe.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** duke i kushtuar një vëmendje të hollësishme investimeve kapitale, shtroi temën e projektit vendosja e rrethojave QKMF-Vushtrri vlera prej 30,000.00 € realizimi total i tyre 30,000.00 €, për këto pyeti se ku janë vendos këto rrethoja dhe a janë kryer pagesat për këtë projekt. Pastaj kodi ekonomik 48280 projekti rregullimi i hapësirave dhe oborreve të QMF-ve dhe AMF-ve planifikimi 47,000.00 €, ndërsa 15,000.00 € të realizuara një pjesë prej 30,000.00 € të mbetura, andaj cilat QMF dhe AMF janë rregulluar dhe cilat kanë mbetur pa u rregulluar. Po ashtu ndërtimi i QMF-së së re në Vushtrri e cila para një viti ka qenë në përfundim e sipër, por që më vonë kanë shkuar duke u zvarritur punimet, ku për këtë projekt kanë qenë të planifikuara 78, 000.00 €, ndërsa janë realizuar 12,000.00 €, kurse kanë shkuar në suficit

65, 000.00 €, dhe kjo është tepër e dëmshme për faktin se qendrat e mjekësisë janë tepër të ngarkuara, ndërsa zvarritja e punimeve po shkakton dëme ekonomike dhe dëme në aspektin e akomodimin e nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

**4.** Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2022

**Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit -** kërkoi që pika lidhur me informatën për ecurinë e dhënies së pronës në shfrytëzim të zhvendoset nga muaji prill në muajin shtator.
**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit -** kërkoi që të bëhen disa korrigjime në Planin e Punës të Kuvendit të Komunës për vitin 2022, gabime teknike sa i përket referimit në vitin kalendarik. Pastaj propozoi që në muajin tetor të futet si pikë <Informata lidhur me zbatimin dhe efektet e Planit për rimëkëmbje ekonomike>, ndërsa në muajin nëntor të sillet informata e korrigjuar si informatë lidhur me strukturën e bizneseve, numrin e të punësuarve, zhvillimin e bizneseve, si dhe statistikat lidhur me stimujt komunal në hapjen e vendeve të reja të punës. Në muajin dhjetor propozoi që të kemi një informatë lidhur me zbatimin e Planit të punës të Kryetarit të komunës për vitin 2022.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** me qëllim që të kemi një tablo sa më gjithëpërfshirëse lidhur me gjendjen epidemiologjike në Komunën e Vushtrrisë, propozoi që në plan të futet një informatë gjashtëmujore lidhur me gjendjen epidemiologjike, për sëmundjet infektive, sigurinë e ushqimeve dhe ujit të pijes, në muajin korrik.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit -** propozoi që nga plani të hiqet Informata lidhur me sigurinë e produkteve ushqimore nga Drejtoria e Inspektimeve, kjo për faktin se inspektorët e sanitarisë, tashmë kanë kaluar në përgjegjësinë e Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinës, dhe kompetentë për këtë çështje tash e tutje është kjo agjenci.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit -** kërkoi që në plan të korrigjohet numri i mbledhjeve të kuvendit, pasi që thuhet që kuvendi mund të mbajë 11 mbledhje të rregullta, ndërsa ne sot jemi në ditën e fundit të muajit janar dhe kuvendi ka mbajtur 2 mbledhje të jashtëzakonshme, kjo për shkak të konstituimit të organeve komunale.
**Mek Selaci, anëtar i kuvendit -** propozoi që në plan të futet nxjerrja e një rregulloreje për organizimin e këshillave të fshatrave dhe sponsor i këtij dokumenti të jetë Drejtoria për Administratë.

**Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime” aprovoi Planin e Punës të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022.**

**5.** Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2022

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** tha se kemi bërë përpjekje që të kemi një plan gjithëpërfshirës, i zbërthyer në objektiva dhe aktivitete, andaj këtë plan do të tentojmë që ta përmbushim në tërësi gjatë vitit 2022.
**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit -** referuar në faqen 2 dhe 3 të këtij plani kemi përzierje kompetencash sa i përket objektivave të zhvillimit ekonomik dhe arsimit për të rritur, ku thuhet ofrimi i arsimit për të rritur pa pagesë për profilet që kërkohen në tregun e punës, këtu kërkoi të specifikohet se për cilin arsim bëhet fjalë dhe pika tjetër mbështetje në hapjen e bizneseve, dhe kjo sipas tij bie në domenin e kompetencave të sektorit të zhvillimit ekonomik. Pastaj ka paqartësi sa i përket rritjes së fondeve për stimulim në bujqësi, të specifikohet se sa do të jetë kjo rritje, sepse nga granti qeveritar kemi vetëm 33,450 € ndërsa pjesa tjetër janë bashkëfinancime dhe nga të hyrat

vetanake. Mandej mbështetja e bizneseve prodhuese duke iu mbuluar normën e interesit të kredive në vlerë deri 20,000.00 €, kjo është mirë dhe i ndihmon bizneset e vogla dhe të mesme, ndërsa askund nuk është dhënë shifra se sa do të jetë buxheti i drejtorisë për këtë objektivë. Hapja e zyrës për diasporën dhe promovimin e klimës së investimeve, është nevojë imediate dhe e kahershme, për këtë pyeti se kur do të ndodhë kjo dhe si do të duket. Aplikimi i lehtësirave për investitorët nga diaspora, është mirë të ndryshohet lehtësira për investitorët e jashtëm dhe ata nga diaspora, këtu kërkoi të sqarohet se për çfarë lehtësirash bëhet fjalë, kur dihet se kjo do të jetë sfida kryesore e qeverisë komunale që lidhet me nxitjen e investimit dhe zhvillimit ekonomik lokal në përgjithësi. Tutje ai i rekomandoi kryetari të komunës që t'i ngrit kapacitetet humane, duke rekrutuar staf shtesë sidomos në Drejtorinë e Ekonomisë, e cila duhet të jetë fondamenti kryesor dhe bartëse e zhvillimit ekonomik lokal. Në këtë plan kishte me qenë mirë që të buxhetohet dhe inkorporohet edhe fondi për ndërmarrësi që shumë të ri dhe të reja të posadiplomuara të kenë mundësi të stimulohen për hapjen e bizneseve dhe vendeve të punës. Mandej në plan nuk është inkorporuar stimulimi i qumështit, dhe pyeti se kur pritet ristrukturimi i Drejtorisë për Ekonomi që është një ide e kahershme.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** duke ju referuar parafolësit, sqaroi me sa vijon: së pari arsimi për të rritur nënkupton grupmoshën mbi 18 vjeç dhe që janë jashtë asaj që është arsim i rregullt. Pastaj shtoi se arsimi jo i rregullt apo siç njihet si arsimim privat, komuna do ta bëjë pa pagesë duke e shndërruar në aftësim-arsimim modular artizanal i cili do të zgjatë nga 3-5 muaj dhe në fund të bëhet certifikimi. Do të hartohen dhe harmonizohen kurrikulat. Qëllimi është që të kemi ndërlidhje mes aftësimit profesional dhe ndërmarrësisë, ndërsa aty ku nuk do të ketë mundësi punësimi në ndonjë ndërmarrje, do të krijohen start-up që do të financohen nga komuna për ngritjen e tyre. Sa i përket bujqësisë ai njoftoi se ka pasur një takim me fermerët vushtrrias, ku është njoftuar nga afër lidhur me sfidat e tyre, dhe ka një plan që pas miratimit të buxhetit do të mendohet edhe subvencionimi i bujqve e sidomos subvencionimi me 50% i pronave nën masën komosative dhe të ujitjes. Në fund tha se të gjitha kërkesat nga fermerët i kanë marrë dhe tani ato do të analizohen dhe bashkërisht do të vendosim për më të mirën e mundshme (ai e falënderoi parafolësin dhe u zotua se propozimet e tij do të jenë pjesë integrale e planit).

**Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit -** paraqiti vërejtjet e tij në faqe 32, pika 10, organizimi i sektorit të teknologjisë janar-qershor duhet të jetë për tërë vitin, kjo duhet të jetë kështu për faktin se teknologjia është aspekt mjaft me rëndësi në zhvillimin ekonomik, ndërsa si aktivitet duhet të inkorporohet në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik. Pastaj tek inspektimet ku thuhet: mbikëqyrja inspektuese dhe procedura për lëshimin e certifikatës së përdorimit për të gjitha objektet e ndërtimit të lartë për lëshimin e lejes së ndërtimit së bashku me Drejtorinë e Urbanizimit vetëm gjatë muajit mars dhe prill dhe kështu kjo është e kufizuar apo ndoshta është ndonjë gabim teknik. Po ashtu në faqe 39 pika 10 thuhet: do të angazhohemi në mbrojtjen e qytetarëve nga zhurma dhe vibracioni, është vetëm në muajit mars dhe prill, kjo duhet të jetë gjatë tërë vitit. Mandej pika 12 ripyllëzimi i sipërfaqeve djerr me fidane të reja dhe të shtojmë sipërfaqet e gjelbëruara në qytet, kjo pikë duhet të futet në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural. Tek Drejtoria e Urbanizimit faqe 44 pika 4 thuhet: inicimi i procedurave për asfaltimin e rrugëve të aprovuara nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë sipas Planit Zhvillimor Komunal, duhet të jetë edhe sipas buxhetit të aprovuar nga ana e kuvendit. Në faqen 49 mungon titulli i organit përgjegjës.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar planit, u ndal tek objektivat në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale faqen 19-20, dhe kësisoj ai vlerësoi se të gjithë kandidatët për kryetar komune janë pyetur se si do ta menaxhojnë pandeminë covid-19, dhe këtu në këtë plan nuk kemi asnjë fjalë të vetme sa i përket kësaj çështjeje, edhe ai në Komitetin për Politikë dhe Financa

kishte rekomanduar që të futet në plan trajtimi i kësaj problematike. Lidhur me këto ai vlerësoi se nuk kemi asnjë informacion se si Komuna e Vushtrrisë e sheh çështjen e menaxhimi të pandemisë, pastaj përdorimi dhe qasja ndaj vaksinimit kundër covid-19 dhe mendon se kjo është mjaft shqetësuese, sepse është mungesë fondamentale në një plan në situatën pandemi siç ndodhemi aktualisht. Mandej është caktuar si objektiv riorganizimi i reformimit të sektorit të shëndetit oral, por nuk është dhënë asnjë sqarim se si do të bëhet kjo, mandej tek pjesa e detajuar në faqet 18,19 dhe 20 pothuajse është i vetmi sektor shëndetësia që nuk kemi të dhëna as tabelare se si komuna do t'i qaset zhvillimit të këtij sektori dhe realizmit të objektivave të planit në lëmin e shëndetësisë, dhe në këtë kontekst krejt çka është paraqitur është një kopje e udhëzimit administrativ, ku parashihen shërbimet nga kujdesi parësor shëndetësor, por jo plani i punës se si do të arrihen këto objektiva para nuk ka asnjë sqarime lidhur me këto çështje. Përkundër kësaj kemi ide ambicioze e mjaft të pëlqyeshme sa i përket zgjidhjes së çështjeve të familjeve pa strehë dhe e mbështet këtë projekt, por kërkoi të di se sa është planifikuar buxhet për këtë projekt, dhe a do të ketë objekte banimi për këto shtresa mjaft sensitve të qytetarëve tanë, dhe se a do të rritet numri i familjeve që do të strehohen, kjo do të ishte mirë, por duhet të rishikohen edhe familjet tjera që nëse iu është përmirësuar gjendje t'i ia lëshojnë radhën një familjeje tjetër e cila ka nevojë.  Në fund tha se është tepër imanente dhe imediate që të fillohet me digjitalizimin e administratës komunale, duke filluar nga organi më i lartë Kuvendi i komunës, ku duhet të bëhet digjitalizimi i votimit elektronik, përmirësimi i zërimit, krijimi i kushteve të ngrohjes, kjo duhet të bëhet përmes kodeve të caktuara ekonomike dhe i takon kryesueses së kuvendit që bëjë presion tek qeveria komunale të ky projekt të realizohet sepse kjo do të ngritë performacën dhe transparencën komunale.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar planit, u ndal tek arsimi për të rritur, aty ku thuhet ofrimi pa pagesë i arsimit për të rritur i profileve që kërkohen nga tregu i punës, ku sqaroi se arsimi për të rritur organizohet në dy shkolla në shkollën profesionale dhe teknike, ku semestri zgjat 6 muaj dhe pagesa për një vit është 150 €, llogaritja e një viti shkollor në afat prej 6 muajsh, del që një i rritur për një vit e gjysmë të përfundojë aftësimin profesional, andaj duke llogaritur 3 vitet nga 150 € bëjnë 450 € kur ia shtojmë edhe pagesën e diplomës del se kostoja totale e një drejtimi për aftësim profesional është 500 €. Andaj lidhur me këtë ai vlerësoi se është një mundësi e mirë, për këta të rritur për të marrë një profesion, por duhet pasur parasysh që së pari të merren drejtimet e mandej profilet, ashtu që të bëhet një targetim se cilat janë drejtimet më të kërkuara në tregun e punës në Komunën e Vushtrrisë, dhe pyeti se cilat do të jenë kriteret mbi bazën e të cilave të bëhet lirimi këta nga pagesa për këta persona. Pastaj është ide e mirë mbështetja e hapjes së bizneseve dhe ceku se është me rëndësi t'u jepet përparësi bizneseve prodhuese dhe atyre përpunuese.
**Bekim Zabërgja, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar faqes 4 të planit ku thuhet: do të angazhohemi në kthimin në pronësi të komunës të parcelave që më herët i janë dhënë në shfrytëzim Burgut të Smrekonicës, të cilat tani evidentohen në emër të Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim të themelimit të zonës së lirë ekonomike në fsh. Banjskë dhe Smrekonicë. Tutje sipas informatave të tij komuna në fshatin Banjskë ka rreth 75 hektarë tokë në pronësi të saj, dhe afër 200 hektarë me male. Ai propozon që ky projekt të mos quhet zonë ekonomike, por zonë industriale dhe sugjeroi që të iniciohet menjëherë procedura për kthimin e këtyre pronave në pronësi komunale. Dallimi në mes të zonës ekonomike dhe asaj industriale sipas tij është se zona ekonomike është ajo që kemi investime më të vogla sikur është ajo në Lumadh, ndërsa zona industriale është ajo që kemi investime më të mëdha kapitale ekonomike, kjo e fundit është bazë apo themel i investimeve të mëdha të huaja dhe vendore dhe për hapjen e vendeve të reja të punës. Pastaj tek faqja 35 ku flitet për manifestimin përkujtimor të masakrës së Studimës, konkretisht tek organizimi i Turneut

memorial në shah, kërkoi që këtë të drejtë ekskluzive ta ketë Klubi i shahut "Llamkosi", sepse është klub profesional dhe ka pasur suksese edhe në arenën ndërkombëtare.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit -** në referim të planit tek objektivat e DKRS-së, propozoi që të futet festival i këngëve për fëmijë, sepse ky event kishte filluar edhe më herët po për shkak të pandemisë është ndërprerë. Ky organizim do të ishte një hapësirë e mirë për shprehjen e talentit të fëmijëve në lëmin e muzikës.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit -** tha se pasi që kryetari i komunës ka dhënë shumë premtime elektorale për arsimin si veprimtari shoqërore, andaj pyetje do t'i adresojë direkt kryetarit e jo drejtoreshës së arsimit. Andaj vlerësoi se në plan lidhur me arsimin ka ndërtim, ka mirëmbajtje, ka renovim, ka furnizim d.m.th. gjithçka ka por jo edhe arsim që i bie arsim në kuptimin e investimeve në ngritjen e cilësisë së arsimit. Në këtë kontekst mori disa shembuj si: furnizim me material higjenik, ndërtim i tualeteve prej 85,000.00 €, ndërsa subvencionim me bursa për nxënësit kemi vetëm 60,000.00 €, ky është një shembull që shpërfaq haptazi se sa i është kushtuar rëndësi arsimit në Komunën e Vushtrrisë. Krejt vëmendja është koncentruar në ndërtim, furnizim dhe mirëmbajtje dhe kjo nuk është element që ndikon në ngritjen e cilësisë së arsimit. Në fund tërhoqi vëmendjen se duhet pasur shumë kujdes sa i përket këtij arsimit për të rritur, duke i specifikuar mirë drejtimet sepse dihet nga e kaluara se sot ka mësues që e kanë kryer shkollën e mesme në këtë formë e të cilët nuk dinë shkrim-lexim për veten e tyre, ndërsa ju japin "mësim" nxënësve andaj kujdes me këto gjëra!

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** tha se tek fusha e shëndetësisë flitet për ndërtimin e dy laboratorëve e të cilët me sa di ai ata janë të ndërtuar. Pastaj në plan nuk është i përfshirë premtimi elektoral për shujtat për profesionistët shëndetësorë, dhe pyeti se ky premtim a do të përmbushet, nëse po, si, a ka bazë ligjore për faktin se profesionistët shëndetësorë e marrin një shtesë në pagën e tyre për shujtat në mënyrë ekskluzive dhe pyeti se a do të ketë bazë ligjore për të bërë një subvencionim të dytë për ta realizuar këtë premtim.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, shtoi se menaxhimi i pandemisë duhet të futet në kuadër të planit të punës të kryetarit të komunës, kjo për faktin se jo vetëm të shkruhet në letër, porse është punuar në këtë drejtim sepse është themeluar shtabi emergjent komunal për menaxhimin e gjendjes së pandemisë, dhe ai shtab ka mbajtur disa takime dhe menaxhimi është duke u bërë sipas udhëzimeve të IKSHPK-së. Sa i përket shujtave të profesionistëve shëndetësorë vlerësoi se ka vullnetin të realizojë këtë premtim por gjithherë në kuadër të ligjit, por është menduar që realizmi të bëhet nga fondi mallra dhe shërbime. Pastaj u zotua se në plan do të bëhet përshkrimi i objektivave tek shëndetësia në formë tabelore. Tek turneu memorial i shahistëve do t'i jepet hapësirë Kubit të shahistëve "Llamkos". Lidhur me pronat në fshatin Banjskë ceku se ato prona nuk janë në pronësi komunale, por do të bëjmë përpjekje që ato të rikthehen për nevojat e komunës. Për sa i takon targetimit të drejtimeve profesionale që janë të kërkuara në tregun përmendi disa prej tyre si: elektor-saldues, instaluese i ujit, instalues i rrymës, instalues i ngrohjes qendrore, kuzhinierë, rrobaqepësi, janë këto drejtime që kërkohen më së shumti në tregun e punës dhe është menduar që të shkohet në sistemin modular 3-5 muaj dhe do të jetë mësim drejtpërdrejt në vendin e punës, do të bëhen kontrata me ndërmarrjet gjegjëse aty ku ka mundësi. Propozimi për organizmin e festivalit të këngëve për fëmijë u zotua se do të futet në planin e punës dhe obligoi DKRS-në që ta inkorporojë këtë propozim në planin e punës të kryetarit. Sa i përket investimeve në infrastrukturën shkollore normalisht se kanë një kosto më të lartë, por edhe në ngritjen e cilësisë së arsimit do të fillohet me organizmin e garave sidomos në shkencat ekzakte por edhe në disa lëndë shoqërore, fillimisht do startohet me një pilot-projekt në të gjitha shkollat për klasat e 5,9 dhe 12 dhe të organizohen gara-kuize të diturisë. Mandej është menduar

të organizohen gara sportive por edhe në muzikë dhe kulturë. Do të themelohet një grup punues që do t'i hartojë të gjitha pyetjet për këto gara të diturisë. Është menduar për mësimdhënësit që marrin pjesë të jepet një kompensim monetar- pagesë për t'i motivuar dhe po ashtu edhe nxënësit.

**6.** Shqyrtimi i propozim – buxhetit për vitin 2022

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit** - pasi i përshëndeti të pranishmit tha se para nesh kemi propozim buxhetin për vitin 2022, buxhet i cili duhet të ishte shumë më ndryshe. Në 55 premtimet e para të kryetarit Idrizi, është thënë që buxheti do të hartohet se bashku e në konsultim me qytetarët, ngase siç thoshte kryetari nga 100 fije sa kishte, 99 fije nga to ka me qytetarët ndërsa një fije me PDK-në. Sot, në këtë moment jemi në ditën e 56, e z. Idrizi nuk ka përmbushur as edhe një premtim të vetëm nga 55 premtimet e tij të para e natyrisht që nuk kemi as buxhet në konsultim me qytetarët. Përkundrazi para nesh kemi një buxhet të përgatitur nga dega e PDK-së në Durrës. Madje në këtë buxhet nuk kemi as edhe një projekt-propozim të vetëm të ri nga qeverisja juaj. Keni larguar projekte të rëndësisë se veçantë nga draft-buxheti i përgatitur nga qeverisja e kaluar, projekte që janë në shërbim të qytetarëve, madje keni larguar edhe projekte për të cilat Komuna e Vushtrrisë ka të nënshkruar memorandum bashkëpunimi e për të cilat komuna ka edhe obligime financiare. Largimi i projektit të ndërtimit të tregut për prodhues vendor, duke pasur të nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit në mes të IRW dhe Komunës se Vushtrrisë është qesharak nga ana juaj. Sa për informim, kuvendi komunal ka ndarë pronën afër ish Motel "Vicianum" për ndërtimin e tregut për prodhues vendor pasi që Qeveria e Kosovës i ka kthyer atë pronë Komunës së Vushtrrisë. Komuna e Vushtrrisë ka hartuar projektin kryesor, kostoja e të cilit është afër 450,000€, e që 400,000$ mbulohen nga donatori, ndërsa pjesa e mbetur nga Komuna e Vushtrrisë. Andaj, me këtë buxhet ju rrezikoni Komunën e Vushtrrisë të humbë 400,000$ nga donatori dhe rrezikoni ndërtimin e tregut. Situatë të njëjtë kemi edhe të ndërtimi i Qendrës për Qëndrim Ditor për të moshuarit, po ashtu kemi memorandum bashkëpunimi në mes të Jetimeve të Ballkanit dhe Komunës së Vushtrrisë. Ndërtimi i këtij objekti për të moshuarit tanë kap shifrën mbi 1 milion euro, shumë e cila mbulohet pothuajse tërësisht nga Jetimat e Ballkanit, ndërsa një vlerë simbolike nga Komuna e Vushtrrisë. Të gjitha procedurat për dhënien e pronës për ndërtimin e këtij objekti kanë kaluar përmes kuvendit komunal, duke u respektuar të gjitha procedurat ligjore. Në këtë rast rrezikoni humbjen e 1 milion € dhe largimin e donatorit nga Vushtrria, kur dihet që në katër vitet e fundit Halil Kastrati së bashku me Komunën e Vushtrrisë kanë ndërtuar shtëpi, duke strehuar afër 100 familje në nevojë. Kryetar, premtimet që i keni dhënë për Artakollin, i hodhët poshtë menjëherë duke larguar nga buxheti projektin e rrugës që lidh Novolanin me varrezat e qytetit, për të cilin projekt ka shumë nevojë ngase shkurton distancën për banorët e Artakollit. Premtimet e shumta për rininë tanimë nuk ju bëjnë përshtypje, larguat nga buxheti parkun rekreativ Taraxha, vazhdimin e rregullimit të lumenjve "Tërstena e Podranqa". Krejt çfarë kemi parë ndryshe në këtë buxhet, është rritja e buxhetit në asfalt e në kubëza dhe kjo nënkupton rikthimin e vërtetë të PDK-së së vjetër në Vushtrri. Të dashur qytetarë të Vushtrrisë, pavarësisht gjitha këtyre, pavarësisht që ky buxhet është sjell për aprovim në Kuvendin Komunal të Vushtrrisë pa dëgjime buxhetore, praktikë kjo e cila nuk ka ndodhur asnjëherë në të kaluarën, Lidhja Demokratike e Kosovës sot do të votojë buxhetin për vitin 2022 dhe si subjekt politik asnjëherë nuk do të bllokojë vendimet e rëndësisë së veçantë si në këtë rast buxhetin.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** tha se hartimi i buxhetit për vitin 2022 është bazuar në nevojat e qytetarëve dhe se asnjë projekt që ka qenë në të mirë të qytetarëve nuk është larguar nga buxheti dhe se nëse shikohet faqja e 2 e draft-buxheti kodi ekonomik bashkëfinancimi me donatorë në vlerë financiare prej 495,61.000 € e që i bie se prej këtij kodi ekonomik do të merren mjete për financimin e projekteve që ju i referoheni. Pastaj përsëriti prapë se 99 fije i ka me qytetarin e vetëm një fije me partinë që i përket. Dhe në mënyrë konkludente deklaroi se nuk do të jetë më i afërt me deputetët e anës së djathë sesa edhe me ata të LDK-së, bashkëpunimin do ta ndajë në mënyrë të barabartë. Sa i përket planifikimit të për ndërtimin e tregut për prodhues vendorë, aty kanë qenë të planifikuar vetëm 5000 € nga qeveria e kaluar, mandej kemi probleme pronësore se projekti është planifikuar në pronë të AKP-së, është një vendim i qeverisë që lejon zhvillimin e projekteve nga ana Qeverisës së Kosovës, por derisa certifikata pronësore shkruan se titullar nuk është Komuna e Vushtrrisë por AKP-ja, atëherë nuk ke të drejtë sepse nuk e kemi paguar 20 % ndaj AKP-së për këto prona. Në mënyrë të ngjashme në pronën e AKP-së është ndërtuar edhe QMF-ja në Vushtrri, dhe në këtë rast po dëshiroj AKP-ja do të mund ta padiste komunën dhe do t'i shkaktonte mjaft shumë dëme ekonomike komunës. Pastaj informoi se ka bërë kërkesë që ato prona të kthehen në pronësi të komunës, porse komuna duhet të paguajë 20% dhe gjendje e njëjtë është edhe me tregun, dhe nuk ka dashur që të vëjë gurëthemelin në një pronë të huaj sepse nuk jemi pronar legjitim i asaj prone, në saje të konsultimeve që ka pasur me drejtorin IRW-së, ai kishte deklaruar hapur se është i mashtruar sepse prona është në emër të dikujt tjetër. Lidhur me ndërtimin e tregut për prodhuesit vendorë, mendohet të ndahen rreth 250,000.00 €, por që prona ku do të ndërtohet akoma nuk është evidentuar dhe përcaktuar. Andaj përfundimisht potencoi se asnjë projekt nuk është larguar nga buxheti dhe i siguron qytetarët se nuk do ikë përgjegjësisë që ka marrë si kryetar komuna, ndërsa sa i përket ndërtimit të rrugës nga fshati Novolan në drejtim të varrezave dhe kyçjes në magjistrale, ky ka qenë një projekt utopist nga ana e qeverisë së kaluar komunale sepse vetëm ura tek hyrja në qytet mbi lumin "Silnica" kap shifrën rreth 2 milionë euro, dhe mos-hyrja në buxhet është bërë sepse ai nuk fut projekte pa mbulesë buxhetore. Në fund tha se buxheti është planifikuar në interes qytetar, dhe shtoi se ata që kanë lënë komunën me ngrohje me tela dhe flasin për megaprojekte e kanë radhën të pushojnë pak.
**Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së-**sqaroi se obligimet e bartura nga vitin 2021 në vitin 2022 janë me sa vijon: për rrugë me kubëza dhe beton kemi 289,561. 024 €, për zgjerimin e rrjetit të ujësjellësit kemi 180,000.00 €, për rrugën tek varrezat e qytetit kemi 44, 264.053 €, për rikonstruktimin e rrugëve të asfaltuara kemi obligime të bartura prej 100,000.00 € dhe për rregullimin e lumit "Silnica" kemi 40,000.00 €.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit -** tha se shuma financiare prej 2, 500,000.00 € nuk janë borxhe por janë mjete që kanë shkuar në suficit buxhetor dhe këtë duhet ta keni parasysh, ku nga kjo shifër 820 mije euro janë nga 21-shi pra të hyra vetanake, 620 mijë euro nga 22-shi pra të hyra të bartura, pra të hyrat nga 21 dhe 22 janë mjete që barten në vitin vijues dhe nuk janë mjete të humbura. 1 milion janë nga granti Qeveritar, ku prej të cilave 550 mijë euro kanë qene për investime kapitale, dhe duke pasur parasysh mos funksionimin e OSHP dhe bordit te saj për një kohë të gjatë dhe për shkak të pandemisë këto procedura nuk kanë pasur mundësi të përfundohen. Ndërsa kryetar sa i përket pronave të AKP-së, përveç vendimit të ish kryeministrit Haradinaj, kemi edhe një vendim nga AKP te cilin po ju citoj : " Vendim, Aprovohet lejimi/pëlqimi për zhvillimin e projekteve te Komunave Istog, Deçan, Vushtrri sipas kërkesave të tyre , respektivisht sipas vendimit te qeverise". Pra kryetar në këto prona mund të zhvillohen projektet e komunës në bazë të këtij vendimi. Krejt ne fund Kryetar kam një pyetje, Gjimnazi i ri në Vushtrri në cilën toke është i ndërtuar dhe në cilën kohë. Është i ndërtuar në tokë të AKP-së në kohë te PDK-së.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** tha se miratimi i buxhetit, gjegjësisht vendimi për buxhetin përbën aktin më themeltar dhe më fondamental të aprovuar nga një kuvend komunal në një vit të zhvillimit të seancave të tij. Duke parë që ky buxhet është sjellë në kuvend pa zhvilluar konsultim publik me qytetarë e bënë këtë buxhet dhe këtë proces jo fortë kredibil. Por ajo që është akoma më shqetësuese është fakti se tek planifikimi urban dhe mjedisi, kemi ndërtimin e rrugëve lokale në fshatra dhe pastaj kodin e riasfaltimit të rrugëve në fshatra si tërësi apo si pako, por ajo që ata i bën të shqetësohen është dhe që është një praktikë e pahasur më parë në Komunën e Vushtrrisë dhe e cila bie në kundërshtim të plotë me parimet e transparencës, gjithëpërfshirjes dhe trajtimit të barabartë të secilit lokalitet, është diskriminimi pozitiv apo favorizimi që i bëhet tri fshatrave me shumicë të komunitetit serb, të cilat caktohen si kode të veçanta buxhetore dhe atë: asfaltimi i rrugëve në fshatin Prelluzhë, asfaltimi i rrugëve në Gracë dhe asfaltimi i rrugëve në fshatin Gojbulë, kjo është e papranueshme dhe jo për faktin se janë kundër investimeve në këto fshatra, por të hedhen poshtë 63 lokalitete tjera, fshatra dhe vendbanime tjera të Komunës së Vushtrrisë me shumicë shqiptare, të mos favorizohen të mos përmenden të futen në pako dhe të nxirren nga pako vetëm këto tri fshatra të komunitetit serb me kode të veçanta buxhetore, kjo definitivisht është një mendësi e vjetër që na ka përcjellë që nga koha e UNMIK-ut për 20 vite me radhë, kjo është logjikë e diskriminimit pozitiv, e kompetencave të zgjeruara, të favorizimeve të caktuara që i janë bërë lokaliteteve dhe nacionaliteteve të caktuara në këtë vend, andaj pa dashur të diskutojmë për çfarëdo çështje tjetër për këtë buxhet, kërkoi që këto kode të përmirësohen menjëherë ashtu që shumat për këto fshatra prej 50,000.00 €, 25,000.00 € dhe 20,000.00 € të kalojnë në pakon e përgjithshme <ndërtimi i rrugëve në fshatra>, nuk pranojmë që të favorizohen grupe të caktuara dhe lokalitete të veçanta, kjo nuk i bënë nder askujt e as juve, dhe si subjekt politik nuk lejojnë që ta shantazhojnë kryetarin e komunës asnjë grup etnik, duke vendosur kushte, sepse do të ia japin votën, se shumica shqiptare është prej 34 deputetëve në kuvend dhe ka mundësinë formale e ligjore të kalojë çdo pikë të rendit të ditës, duke përfshirë edhe buxhetin e komunës. Andaj përfundimisht kërkoi që kjo çështje të korrigjohet menjëherë dhe një logjikë dhe formë e tillë e diskriminimit pozitiv të mos përsëritet më kurrë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit -** tha se sot jemi në këtë mbledhje të jashtëzakonshme të kuvendit ku pritet të votohet buxheti i komunës për vitin 2022 dhe edhe ashtu jemi vonuar në aprovimin e tij. Buxheti për vitin 2022 do të jetë 19,862.886.00 €, nga këto 53,97 % janë te dedikuara për paga dhe mëditje, tek investimet kapitale kemi 4,779.107.00 €, marr në shpenzime i bie qe 26 % e buxhetit komunal janë për këtë kategori ekonomike, këtu sigurisht kemi të bëjmë me ndonjë gabim teknik sepse shpenzimet nga investimet kapitale janë 24,06 %, dhe nëse e bëjmë dallimin mes 26% dhe 24.04 € del një vlerë financiare prej më shumë se 385,000.00 € dhe për këtë kërkoi që kjo të përmirësohet sepse kemi të bëjmë me dokumentin kryesor financiar të komunës. Kur flitet për investimet kapitale, shihet se tek arsimi është planifikuar ndërtimi i një çerdheje ku është ndarë një shumë prej 20,000.00 €, ndërsa vitin e kaluar ish kryetari i komunës shkollën e fshatit Stanoc i Epërm e ka dhënë në shfrytëzim për destinim ndërtimin e një fabrike të tekstilit e quajtur “Vitex” e cila sipas tij do të mund të punësonte 60 gra, kjo kontratë është njëvjeçare dhe përfundon në muajin shkurt, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që ta trajtojë me seriozitet çështjen e ish-objektit të vjetër të shkollës fillore “Migjeni” në Stanoc të Epërm” dhe pas skadimit të kontratës ky objekt t’i kthehet atij komuniteti, të kthehet në gjendjen ashtu siç ka qenë objekt edukativo-arsimor. Ajo se çka e brengosë atë dhe komunitetin atje është se është promovuar se do të punësohen 60 gra dhe kanë kaluar 11 muaj dhe pas 25 ditësh kontrata skadon, ndërsa nëse shikohet në ARBK, del se në këtë fabrikë evidentohet se është i punësuar vetëm një (1) punëtor, por për të qenë real dhe objektiv nëse shkon në atë objekt shihet se sillën 6 apo 7 vajza apo gra.

Në këtë kontekst kërkoi që në buxhetin për vitin 2022 të futen 20,000.00 € për renovimin e ish-objektit të shkollës “Migjeni” në Stanoc të Epërm që ky objekt të shndërrohet në çerdhe për atë komunitet. Pastaj tek arsimi dhe shkenca parashtroi disa pyetje, a keni planifikuar që në buxhetin për vitin 2022 të bëhet pagesa e shujtës, pagesa e udhëtimit, pagesa e pagës jubilare, pagat përcjellëse në rastin e pensionimit të mësimdhënësve dhe pagesën e licencës së mësimdhënësve siç janë të parapara me kontratën kolektive të nënshkruar nga MASHT-i dhe SBASH-ku në vitin 2017 dhe e ripërtërirë në vitin 2021. Sa për informimin e kryetarit të komunës në vitin 2020 Komuna e Vushtrrisë ka paguar 717, 648.00 € për shujta dhe paga jubilare, po ashtu shuma e cila u cek edhe në vitin 2021 kemi një shumë të paguar marramendëse, pra kemi fakte të vërtetuara nga gjykatat se mësimdhënësit kanë të drejtë në kërkesat e tyre dhe pagesa e detyrimeve që del nga kontrata kolektive do t’i zvogëlonte shpenzimet edhe për komunën, por edhe për mësimdhënësit të cilët po detyrohen të paguajnë avokat për realizimin e të drejtave të tyre, ndërsa në fund propozoi që në buxhetin për vitin 2022 të futet blerja e lap-topve për anëtarët e kuvendit ashtu që t’u mundësohet një punë e dinjitetshme.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit -** tha se kuvendi i komunës është përgjegjës për miratimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit të komunës, ndërsa kryetari i komunës mbikëqyrë administrimin e financave të komunës dhe zbatimin e vendimeve që miratohen nga kuvendi. Kuvendi duhet të ketë informata të mjaftueshme për të bindur veten se financat janë në rregull dhe se objektivat e planifikimit buxhetor dhe financiar janë duke u përmbushur. Dallimi në mes të rolit të kuvendit dhe ekzekutivit është i rëndësishëm në këtë fushë. Në planifikimin e buxhetit të komunës përfshihen një mori e institucioneve sikurse Kuvendi i Kosovës, Qeveria, Ministria e Financave dhe institucione të pushtetit lokal, si kryetari dhe kuvendi i komunës. Gjithsesi ndikim të madh në këtë proces kanë vetë qytetarët, dëgjimet publike dhe konsultimi me grupe të interesit, si dhe shoqëria civile. Anëtarët e kuvendit të komunës duhet të kenë informata të hollësishme mbi secilin hap të procesit të planifikimit të buxhetit të komunës sepse afati kohor nuk është i mjaftueshëm për anëtarët e kuvendit të komunës që të sigurohen se propozim-buxheti i pranuar nga kryetari i komunës është në përputhje me kërkesat e qytetarëve të komunës. Në këtë kontekst, kuvendi i komunës duhet të jetë i njoftuar nga zyrtari kryesor financiar në afatet përkatëse që anëtarëve të kuvendit të komunës t’u japë informata mbi qarkoret buxhetore. Komiteti për Politikë dhe Financa dhe kuvendi i komunës në përgjithësi, kanë përgjegjësi të madhe në fazat e planifikimit dhe mbikëqyrjes së financave komunale. Në fazën e planifikimit, Komiteti për Politikë dhe Financa shqyrton dokumente të rëndësishme si: buxhetin komunal, korniza afatmesme buxhetore komunale, plani i prokurimit dhe i jep rekomandimet për veprime kuvendit të komunës, në rastin konkret mungon plani i prokurimit. Kuvendi i Komunës duke marrë parasysh edhe rekomandimet nga Komiteti për Politikë dhe Financa, shqyrton, dhe në rast pajtimi, miraton, dokumentet kyçe të komunës që lidhen me menaxhimin e financave komunale. Departamenti i Buxhetit Komunal është departamenti në kuadër të Ministrisë së Financave që merret me financat komunale. Ky departament është i përfshirë në proceset e planifikimit dhe zbatimit të financave komunale, pasi që: përgatit propozim-buxhetin për komuna; përgatit pjesën e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) Komunale; ndihmon komunat në zbatimin e buxhetit; shqyrton dhe vlerëson kërkesat për ndryshimin e ndarjeve buxhetore; analizon dhe ofron rekomandime rreth transfereve, rialokimeve dhe dorëzimeve tjera që kanë të bëjnë me ndarjet buxhetore; menaxhimin e sistemit elektronik të të dhënave (BDMS); programin e investimeve publike (PIP) apo sisteme tjera për komunat, etj. Analistët e buxhetit komunal, bashkëpunojnë me zyrat komunale për të gjitha çështjet e menaxhimit financiar të komunave. Për shembull, ata pranojnë kërkesat nga komunat dhe i dorëzojnë për procedim, informojnë dhe këshillojnë komunat me qëllim të

respektimit të kornizës ligjore dhe vendimeve të marra në nivel ministror, informojnë dhe këshillojnë komunat në rast se ka deficit të mjeteve në kategoritë ekonomike, etj. Planifikimi i buxhetit duhet t'i përmbahet disa parimeve: të jetë i targetuar ashtu që merr për bazë nevojat specifike të grupeve të caktuara dhe të margjinalizuara të shoqërisë. Të jetë gjithëpërfshirës sepse nuk mund të flasim për buxhet të targetuar pa buxhetim gjithëpërfshirës - si mund t`i kuptojmë nevojat e grupeve të ndryshme të shoqërisë pa i përfshirë ata në procesin e planifikimit të buxhetit. Të jetë transparent, ka të bëjë me lejimin e qasjes së publikut në të gjitha fazat e buxhetimit, duke përfshirë fazën e planifikimit, por edhe të realizimit të buxhetit të komunës. Transparenca nënkupton që buxheti të jetë jo vetëm lehtësisht i qasshëm, por duhet që të përpilohen formate të thjeshtëzuara lehtësisht të kuptueshme nga të gjithë. Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në buxhetin vjetor për vitin 2022. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike. Lidhur me propozim-buxhetin 2022 që do ta trajtojmë sot, theksoi se të njëjtit i mungon tabela 4.4 -projektet e bartura dhe gjithashtu i mungon plani i prokurimit, po ashtu i mungon edhe lista e obligimeve kontingjente të komunës e që rrjedhimisht këto do të artikulonin edhe një deklaratë apo zotim të kryetarit të komunës lidhur me implementimin me sukses të projekt-buxhetit 2022. Pavarësisht të cekurave unë kam bindjen se kryetari dhe qeveria komunale kanë marrë obligime dhe kanë dhanë zotime se buxheti është gjithëpërfshirës, inkorporon zhvillim ekonomik, është në harmoni me nevojat e qytetarëve dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit -** përsëriti se pa u larguar tri kodet buxhetore për fshatrat Prelluzhë, Gojbulë dhe Gracë të cilat do të duhej të futen në pako me kodin ekonomik buxhetor-asfaltimi i rrugëve në fshatra si pako e përgjithshme, grupi kuvendar i LVV-së as që do të diskutojë lidhur me buxhetin.

**Spasoje Stefanoviq, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar tri fshatrave me shumicë serbe të cekur në buxhet, pra bëhet fjalë për Prelluzhën, Gracën dhe Gojbulën, mund të thuhet se në katër vitet që shkuan, nuk ka pasur investime publike në rregullimin e infrastrukturës, andaj e falënderon kryetarin dhe qeverinë komunale që kanë vendosur që të investojnë në këto fshatra. Investimi në rrugët e këtyre fshatrave është shumë domethënës sepse në ato rrugë nuk do të qarkullojnë vetëm serbët, por edhe komunitet tjera që jetojnë në komunën tonë. Andaj inkurajon qeverinë dhe kryetarin e komunës që të vazhdojë me investime në këto fshatra dhe për këtë e falënderon përzemërsisht.

**Alban Bajrami, anëtar i kuvendit -** tha se projekt -buxheti i Komunës është instrumenti kryesor për përmirësimin e jetës së qytetarëve dhe për realizimin e investimeve zhvillimore. Natyrisht, si përfaqësues të qytetarëve ne kemi obligimin dhe detyrën të trajtojmë me hollësi projekt-buxhetin dhe të japim vlerësimin tonë. Mbi të gjitha, detyra jonë primare është të sjellim në dukje nevoja dhe të pasurojmë atë me kërkesa të qytetarëve. Unë kam dy kërkesa që mendoj se duhen futur patjetër në këtë projekt-buxhet. E para ka të bëjë me një objekt të cilit si qytetar i kemi shumë borxh. Objekti i çerdhes së qytetit. I kërkoj qeverisjes komunale që të përfshij në projekt buxhet renovimin e jashtëm dhe të brendshëm të këtij objekti. Çerdhja e qytetit është në gjendje jo të mirë. Me investimet që mungojnë dhe kushtet e pamjaftueshme, nuk mund të lejojmë që fëmijët tanë të marrin hapat e parë të dijes dhe socializmit në kushte nën-minimale. Qe 37 vite nga hapja e saj asnjëherë nuk ka pasur renovim të mirëfilltë në çerdhen e qytetit andaj investimi aty është i domosdoshëm. - Kërkesa ime e dytë ka të bëjë me një padrejtësi që ka ndodhur me banorët e rrugës Lidhja e Lezhës. Në një akt diskriminues atyre u është shtruar vetëm njëra anë e rrugës me trotuar. Kërkoj pra gjithashtu që në projekt-buxhet të përfshihet shtrimi i trotuarit të plotë në rrugën "Lidhja

e Lezhës” në qytet Këto dy projekte janë plotësisht të realizueshme dhe nuk kërkojnë buxhet të papërballueshëm andaj kërkoj nga qeverisja komunale që t'i përfshij në buxhet para se të votojmë atë. Gjithashtu, u bëj thirrje që buxhetin ta shpenzoni me përgjegjësi dhe transparencë. Unë si asamblist i LDK-së do të ngre zërin kurdo që këto premisa nuk zbatohen.

**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** duke ju referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, vlerësoi se do të ishte shumë e logjikshme që të gjitha rrugët që planifikohen të ndërtohen të ishin të specifikuara, sikurse është bërë në rastin e ndërtimit të shkollave dhe objekteve tjera të rëndësisë vitale për komunën. Sa i përket tri (3) pozicioneve buxhetore Prelluzhë, Gracë dhe Gojbulë, sqaroi se mund të futen të gjitha në pako në kodin buxhetor- asfaltimi i rrugëve në fshatra dhe më pas të gjitha këto projekte të ndahen dhe specifikohen me vendim të veçantë të  kuvendit, sepse ato investime në ato fshatra të përmendura do të realizohen. Tutje sqaroi se logjika e shpërndarjes së buxhetit në investime kapitale ka qenë që orientimi të bëhet në lokalitetet ku ka më shumë popullatë. Tek kërkesa e Ymer Haradinaj për renovim të çerdhes-shkollës mendon që nga të hyrat e bartura të bëhet një projekt i tillë, dhe sqaroi se problemi nuk qëndron shumë tek ndërtimi dhe adaptimi i objekteve-çerdheve, por problemi kryesor është tek rekrutimi i stafit. Sa i përket hartimit të një tabele buxhetore lidhur me bartjen e obligimeve kontraktuale dhe detyrimeve kontingjente tha se pajtohet plotësisht se do duhej të hartohej një tabelë e tillë me qëllim që të kemi një prerje të zhvillimit të projekteve. Sa i përket propozimeve të anëtarit të kuvendit z.Alban Bajrmai, sqaroi se projektet për renovimin e çerdhes publike dhe ndërtimi i trotuarit në rrugën “Lidhja e Lezhës” do të mund të financoheshin nga të hyrat e bartura. Andaj duke i inkorporuar këto projekte që i potencoi më lart, bëri thirrje që të votohet dhe aprovohet buxheti i komunës për vitin 2022.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit -** duke u nisur nga parimi i tij mbipartiak, vlerësoi se gjatë mandatit LDK-LVV, në fshatrat e rrethit të shalës, nuk investuar pothuajse fare, ndërsa vetëm PDK-ja i kishte ndërtuar disa rrugë në fshatin e tij të lindjes, kjo e vërtetë dikujt mund edhe t'i pengojë, por kur thuhet e vërteta atij fare nuk i bënë përshtypje se dikujt i pengon. Pastaj ai ceku dhe përsëriti problemin e kamotshëm të eksploatimit të gurëve shkëmbor në fshatin Pasomë, dhe si rezultat i peshave të rënda janë shkatërruar rrugët dhe po shkaktohet pluhur i madh nga shfrytëzimi i zhavorrit dhe materialeve tjera shkëmbore, dhe kështu këto fshatra janë duke u zbrazur nga banorët e atjeshëm lokal. Pastaj shtoi se investimet janë koncentruar kryesisht në pjesën e rrafshit dhe disa rrugë janë kryer edhe në rajonin e Artakollit. Lidhur me këto ai kërkoi që të ketë investime në fshatin Pasomë dhe fshatrat përreth, si dhe të hiqen deponitë ilegale të mbeturinave në fushat e fshatit Banjskë, ku si rezultat i këtyre mbeturinave shpesh bllokohet edhe rruga. Në fund ai kërkoi që në buxhetin e vitit 2022 të futet edhe riparimi i rrugës që fillon nga fshati Sllatinë deri tek fshati Pasomë, si dhe riparimi i disa rrugëve në fshatin Tërllobuq.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit -** duke ju referuar diskutimit të parafolësit të tij se ka mungesë investimesh në zonën e shalës, pyeti kryetarin e komunës se a do të jetë në projekt-buxhet projekti investues zona turistike nga “Kodra e flamurit” në fshatin Vesekoc, ku gjatë fushatës e ka vlerësuar si bukuri natyrore të disa fshatrave siç ceken: Kurillova, Bozhlani, Vesekoci, si dhe rregullimi i infrastrukturës që do të bëhet me Prishtinën dhe Podujevën.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit -** në emër të grupit kuvendar të LVV-së falënderoi kryetarin e komunës për reflektimin e tij që tri kodet ekonomike për tri fshatra me shumicë serbe të trajtohen si të barabarta me lokalitet tjera dhe të jenë në një kod të vetëm buxhetor. Andaj reflektimi i tij vlerësoi se është për t'u respektuar dhe duartrokitur. Tutje shtoi se kjo na jep mundësi që të lëshohemi në trajtimin analitik të buxhetit, duke shtuar se pajtohet me kryetarin e komunës që mos të ketë projekte partiake dhe politike, por ku do që shtrohet nevoja të orientohen investimet, sepse kudo që shtrohet një rrugë apo ngritet një çerdhe apo qendër e mjekësisë, ajo është në të mirën

qytetare, dhe për këtë do ta keni përkrahjen e tyre si grup politik dhe atë kurdoherë që shtrohet nevoja. Megjithatë paraqiti vërejtjet e tij sa i përket shumave buxhetore që janë ndarë në sektorët e caktuar. Tek investimet kapitale ka një shpërputhje të ndarjes së fondeve, dhe se kemi një koncentrim tek pjesa e shërbimeve publike dhe tek pjesa e urbanizmit e që i bie në kanalizime dhe kubëza, si dhe asfalt, 1,818,234.00 € të ndara për infrastrukturë publike janë më tepër se i tërë buxheti i dedikuar për investime kapitale për bujqësi, arsim, shëndetësi, administratë, kadastër e kështu më radhë. Kjo është një shpërputhje e madhe dhe një pabarazi mes sektorëve, andaj ata nuk janë kundër që të investohet sepse ka nevojë, por nuk duhet të ketë kaq shumë pabarazi dhe të mbesin prapa politikat publike sa i përket arsimit dhe shëndetësisë që edhe vetë kryetari i komunës i ka pasur prioritet gjatë fushatës paraelektorale. Është dallim i madh që të kemi 1,818,234.00 € investime në infrastrukturë publike e vetëm 403,000.00 € në bujqësi, kur dihen rrethanat e komunës sonë ku më së shumit zhvillohet bujqësia si veprimtari shoqërore, ose edhe në raport me ndarjet buxhetore për shëndetësi dhe arsim. Njëjtë është situata edhe tek planifikimi urban ku kemi një ndarje buxhetore prej 115,473.00 €, andaj më mirë do të ishte si për qytetarët ashtu edhe për qeverinë e komunës që të kemi balanësim të shpërndarjes së buxhetit mes sektorëve aq sa është e mundshme. E kupton se disa pozicione ekonomike të ndarjeve buxhetore janë determinuar nga borxhet dhe kjo ka bërë që janë rritur kostot financiare. Vërejtje tjetër serioze e që ka qenë për vite me radhë është mungesa e kodit buxhetor për ndërtimin e rrugëve, asfaltimi i rrugëve në qytet dhe konsideron se ky kod buxhetor duhet të kthehet në buxhet tek pjesa e urbanizmit për faktin se ka nevojë të intervenohet në riparimin e rrugëve në qytet sidomos tek unaza e qytetit. Gjithashtu parashtroi vërejtje edhe tek shpërputhjet mes tabelave financiare buxhetore dhe tabelat financiare të planit të punës të kryetarit, për këto propozoi që të harmonizohen. Mbi të gjitha për hir të transparencës në shpenzimin e parasë publike, kërkoi që pas aprovimit të këtij buxheti të ketë transparencë për sa i takon ndërtimit të rrugëve, për shkak të interesit qytetar, por edhe për shkak të përgjegjësisë që bartni si qeveri, duke u lehtësuar nga drejtim-gishti për favorizime politike dhe rajonale siç edhe kishte ndodhur pak muaj më herët nga ish-kryetari i kaluar që në fshatin e tij kishte ndërtuar apo planifikuar ndërtimin e 35 rrugëve. Kjo mendësi duhet të tejkalohet dhe të rritet transparenca dhe llogaridhënia, në ndërtimin e rrugëve dhe projekteve tjera, në këtë kontekst njoftoi se me ndryshimet e bëra në këtë projekt-buxhet vota e tyre do të jetë pro aprovimit të Buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022.

**Fatmire Cecelia, anëtare e kuvendit -** duke ju referuar subvencioneve të planifikuara në DKRS, njoftoi se në vitin 2018 për këtë drejtori kanë qenë të planifikuara rreth 50,000.00 €, ndërsa shuma e tyre ka shkuar duke u rritur vit pas viti, në vitin 2021 shuma e subvencioneve në DKRS ka qenë 90,000.00 €. Andaj duke i njohur nevojat në DKRS për t'i mbështetur klubet sportive, organizata joqeveritare, kulturore, rinore, artizanalet, artistët, botimet e librave e të ngjashme, kërkoi që subvencionet në DKRS të rriten për së paku edhe 30,000.00 € që shuma totale të jetë 120,000.00 €. Kjo për faktin se në total kemi rritje të subvencioneve sepse deri në vitin 2020 kemi pasur deri në 200,000.00 € subvencione komunale, ndërsa në vitin 2022 kemi një shumë financiare prej 657,000,00 €.

**Mek Selaci, anëtar i kuvendit -** tha se duke parë që jemi në 100 vjetorin e themelimit të klubit të futbollit, kërkoi që për këtë klub të ndahen 100,000.00 €, mendoi se ka mundësi financiare, sepse shuma e subvencioneve për komunën është mbi 600,000.00 €, dhe beson se do ta ketë përkrahjen edhe të anëtarëve tjerë të kuvendit.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit -** propozoi dhe kërkoi që në buxhetin e komunës për vitin 2022 të futet ndërtimi i lapidarit të UÇK-së, në lokacionin afër urës së Prelluzhës në fshatin Gllavatin, kjo për faktin se ky projekt ka qenë i iniciuar qysh para 15 viteve.

**Remzi Ahmeti, drejtor i DBF-së -** tha se kur bëhet fjalë për ndërtimin e rrugëve nëpër fshatra, duhet bërë të ditur se obligimet e bartura nga viti 2021 në vitin 2022 janë për rrugët në këto fshatra: Taraxhë, Bruznik, Studime, Sllatinë, Stanoc, Maxhunaj, Ropicë, Samadrexhë, Mihaliq dhe Novolan, ndërsa sa i përket kodeve buxhetore të veçanta për tri fshatrat me shumicë serbe, sqaroi se ky ka qenë një zotim i dhënë para OSBE-së, kjo ishte veç sa për informatë. Për sa i përket shtyllave buxhetore ceku se kemi borxhe-obligime të bartura dhe se është tentuar të ketë një balanc nëpër sektorë dhe drejtori sipas kërkesave që i kanë pasur.
**Ferit Idrizi, Kryetar i komunës -** duke i rikapitulluar diskutimet dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit sqaroi me sa vijon: sa i përket ndërtimit të lapidarit të UÇK-së në fshatin Gllavatinë, deklaroi se Agjencioni për Menaxhimin e Memorialëve e ka marrë përsipër ndërtimin e këtij lapidari. Pastaj sa i përket subvencioneve për klubin e futbollit, jemi në mbështetje sepse është 100 vjetori dhe do ta mbështesë nga të hyrat e bartura, sepse e ka kontaktuar edhe klubin dhe kanë dakortsinë që të mbështetet ai klub, madje do të formohet edhe një këshill organizativ për manifestimin e 100 vjetorit. Pastaj i njoftoi anëtarët e kuvendit se për festat shtetërore do t'u dërgohen ftesa për të gjithë anëtarët e kuvendit ku do ti kenë ulëset e veçanta dhe apeloi që të gjithë ta marrin pjesë në ato organizime. Sa i përket rritjes së subvencioneve në DKRS, në vlerë prej totale 120,000,00 €, tha se pajohet që kjo të bëhet nga të hyrat e bartura. Sa i përket propozimit të z.Ali Januzit njoftoi se për fshatin Pasomë janë planifikuar dy projekte: ndërtimi i lapidarit tek vendi i quajtur "Lama e Vocollëve" ku janë ndarë 12,000.00 €, dhe projekti tjetër është renovimi i shkollës në vlerë prej 62,000,00 €. Ndërsa sa i përket rrugëve ai bëri të ditur se të gjitha rrugët janë të buxhetura në mënyrë kumulative, e të cilat do të specifikohen më vonë. Sa i përket kodeve buxhetore për tri fshatrat me shumicë serbe: Prelluzhë, Gojbulë dhe Gracë, njoftoi se vitin e kaluar ish-kryetari i Komunës së Vushtrrisë ka marrë zotimin para OSBES-së për një ndarje të tillë të veçantë, por tani po vendosim që të gjitha rrugët të aprovohen në pako, dhe më vonë i ndajmë përmes vendimeve të veçanta. Lidhur me zonën turistike nga "Kodra e flamurit" në fshatin Vesekoc, njoftoi se në njërën nga seancat e kuvendit do të sillet propozimi për shpalljen e asaj zone dhe do të bëhet ndërtimi i atyre rrugëve. Rëndësi të posaçme do t'i kushtohet ndërtimit të rrugës që fillon nga Kozarica tek Barileva, dhe për këtë do të thërras një takim mes kryetarit të Prishtinës , Podujevës dhe Obiliqit, me qëllim të bashkërendimit të veprimeve për zhvillimin e këtij projekti pasi që kjo rrugë i lidhë këto katër komuna. Kjo rrugë do të jetë një artere e fuqishme me qëllim që të vejmë në shërbim turizmin malor sidomos banorëve të Prishtinës në zonën e maleve të shalës.
**Ali Januzi, anëtar i kuvendit-**e përgëzoi kryetarin për punën që po bënë, dhe shtoi se është shumë e mirëseardhur ndërtimi lapidarit në fshatin Pasomë, për ta lartësuar figurën e Adem Vocës i cila ka rënd si hero në vitin 1945 në krahun e ballistëve, dhe më këtë po shënjohet historia jonë e lavdishme. Më tej ai shprehu drojën e tij për shumën e mjeteve financiare e cila dedikohet për ngritjen e këtij lapidari, pasi që kemi të bëjmë me një figurë të madhe kombëtare.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se sa i përket çështjes së shujtës për shërbyesit civil, njoftoi se kërkesën e kemi marr nga sindikata e shërbimit civil, por edhe në vitin 2010 është marrë vendimi për realizmin e shujtave, por që ai vendim është i panënshkruar dhe kjo sigurisht se ka pasur ndonjë defekt se përse ai vendim nuk është nënshkruar. Më tej vlerësoi se kërkesa e sindikatës ka shkuar në zyrën ligjore të komunës, për vlerësim të ligjshmërisë dhe vlerësimi i tyre është se meqë nuk është marr mendimi nga MAPL-ja një vendim i tillë nuk ka fuqi juridike. Andaj kjo çështje duhet të mbetet në pako dhe të shikohet mundësia ligjore dhe financiare e realizmit të këtyre shujtave.

**Melihate Basholli-Latifi-** duke i falënderuar të gjithë për kontributin e dhënë lidhur këtë pikë të rendit të ditës, e hodhi në votim draft-buxhetin e komunës për vitin 2022, duke i inkorporuar të gjitha propozimet e arsyeshme të dhëna nga anëtarët e kuvendit.

**Në fund të diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendit pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijo:**

1. Me këtë vendim aprovohet buxheti i Komunës së Vushtrrisë, për vitet 2022-2024, konform Qarkoreve Buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 për komuna të lëshuara nga MFPT-ja, për vitin 2022 dhe projeksionet për vitin 2023 dhe 2024.

2.Shuma e përgjithshme e buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2022 është **19,862,886.00 €,** prej të cilave për:

2.1 Paga dhe mëditje.........................................................................10,720,000.00 €
2.2 Mallra dhe shërbime....................................................................3,278,239.00 €
2.3 Shpenzime komunale....................................................................428,000.00 €
2.4 Subvencione.................................................................................657,540.00 €
2.5 Shpenzime kapitale.......................................................................4,779,107.00 €

**Gjithsej:........................................................................................19,862,886.00 €.**

3.Të hyrat vetanake të planifikuara.....................................................2,262,795.00 €.

4. Mjetet financiare të cekura në pikën 2 dhe 3 të këtij vendimi janë në pajtim me Qarkoret Buxhetore 2022/01 dhe 2022/02 të MFPT-së, si dhe në bazë të kufijve buxhetorë.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Kryetari i komunës dhe drejtoritë tjera kompetente komunale.

6. Tabela 4.1- plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2022-2024, (kopja e shtypur prej SZHMB, të vulosura si dhe nënshkruar nga kryetari i komunës dhe ZKF). Tabela 4.2 – financimi i projekteve kapitale për vitin 2022 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2023-2024 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF-ja). Tabelat 4.3 plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga kryetari i komunës dhe ZKF-ja), si dhe tabelat e buxhetimit të përgjithshëm gjinor janë pjesë e këtij vendimi, të bashkëngjitura në shtojcë.

7. Ky vendim hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit dhe i njëjti i dorëzohet Ministrisë së Financave për zbatim.

**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**falënderoi të gjithë grupet politike në kuvend për të mbështetjen unanime në aprovimin e buxhetit të komunës për vitin 2022, i uroj të gjithë duke dëshiruar suksese dhe punë në të mirë të përgjithshme.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**propozoi që të futet për trajtim një deklaratë për mbështetjen e profesorit të gjimnazit "Eqrem Çabej" z.Lulzim Paci. Ai potencoi se në qytet është krijuar një atmosferë jo e mirë dhe për ta shmangur gjuhen e bullizimit propozoi që kjo temë të trajtohet jashtë pikave të rendit të ditës ku kuvendit ta ngrit një komision për hartimin e tekstit të asaj deklarate.

**Kuvendi me 29 vota "për" 1 votë "kundër" 2 vota "abstenim" e aprovoj propozimin e anëtarit të Kuvendit z.Ilmi Azemi.**

Kuvendi me vota "unanime" aprovoj themelimin e komisionit kuvendar ad-hoc për hartimin e tekstit të deklaratës në mbështetje të profesorit Lulzim Paci në përbërjen si në vijim:

**Ilmi Azemi PDK;**
**Shkelzen Xhaferi LDK;**
**Mek Selaci LVV.**

**7.** Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;

**Me vota "unanime" kuvendi aprovoj çelësin e themelimit të Komitetit për Komunitete dhe atë 2 anëtarë nga PDK-ja, 1 anëtar nga LDK-ja, dhe 1 anëtar nga LVV-ja.**

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit-** propozoi Kushtrim Hysenin dhe Zojë Hajrizin për anëtarë të Komitetit për Komunitete nga radhët e PDK-së.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi znj.Leonora Gërgurin për anëtare të Komitetit për Komunitete nga radhët e LDK-së.
**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit-** propozoi për anëtar të Komitetit për Komunitete z.Behar Duraku, nga radhët e LDK-së.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**propozoi znj.Gresa Mulin për anëtare të Komitetit për Komunitete nga radhët e LVV-së.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**tha se edhe në rastin e themelimit të KPF-së është vepruar njëjtë sikurse edhe tani, dhe shtoi se propozimet janë përfaqësim dhe se propozimet në emër të grupit kuvendar të LDK-së i shefi i grupi.

**Kryesuesja e kuvendit i hodhi në votimi dy propozimet e dhëna nga anëtaret e kuvendit nga radhët e LDK-së, pas votimit znj. Leonora Gërguri mori 10 vota "Për", ndërsa z.Behar Duraku mori 13 vota "për" dhe ky i fundit u konstatua si propozim i aprovuar nga ana e kuvendit.**

**Në fund të gjitha propozimeve të dhëna nga anëtarët e kuvendit, kuvendit pas votimit me 23 vota "për", 3 vota "kundër" të tjerët nuk morën pjesë në votim u vendos me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim themelohet Komiteti për Komunitete, i Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:**

- **1.1 Kushtrim Hyseni, anëtar i Kuvendit të komunës PDK;**
- **1.2 Zojë Hajrizi anëtare e Kuvendit të komunës PDK;**
- **1.3 Behar Duraku anëtar i Kuvendit të komunës LDK;**

**1.4 Gresa Muli anëtare e Kuvendit të komunës LVV;**
**1.5 Zdravko Zdravkovic, përfaqësues i komunitetit serb;**
**1.6 Berat Maloku, përfaqësues i komunitetit turk;**
**1.7 Zana Krasnic Saraci, përfaqësuese e komunitetit boshnjak;**
**1.8 Aziz Emini, përfaqësues i komunitetit rom;**
**1.9 Adem Hoti, përfaqësues i komunitetit ashkali.**

**2. Komiteti për Komunitete, detyrat dhe përgjegjësitë do t'i ushtrojë në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ për Procedurën e Themelimit Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve Tjera në Komunë, Statutin e komunës, akteve tjera, si dhe Rregulloren e punës.**

**3. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Komunitete është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të komunës, përveç nëse ky mandat i pushon në rastet e parapara me legjislacionin në fuqi.**

**8.** Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit**-lidhur me propozim-vendimin për themelimin e KKSB-së, kërkoi sqarime lidhur me pikën 1.16 të këtij propozim ku bëhet fjalë për z.Habib Mustafa, përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi për fshatrat Strof, Beçuk, Gllavatin, Bivolak Zhilivodë, Prlluzhë dhe Mihaliq. Lidhur me këtë ai tha se nuk kemi informacione se i njëjti është i zgjedhur me vendimi si përfaqësues i këtyre fshatrave. Për më tepër i njëjti vite me radhë ka qenë i ngarkuar në pozita të ndryshme nga radhët e PDK-së dhe ai është zyrtar i PDK-së. Nëse kjo është kështu atëherë kjo nuk është një praktikë e mirë që këshillat e tillë të politizohen, andaj kërkoi që ai të zëvendësohet.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 18 vota "për", 4 vota "kundër" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim, themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në këtë përbërje:**

**1.1. Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – kryesues;**
**1.2. Reshat Kovaqi, komandant i stacionit policor – anëtar;**
**1.3. Miradije Maloku, drejtoreshë për arsim – anëtare;**
**1.4. Maliq Ferizi, drejtor për mbrojtje dhe shpëtim – anëtar;**
**1.5. Edolind Vishaj, përfaqësues i FSK-së – anëtar;**
**1.6. Hadije Zuçaku, kryetare e Këshillit të prindërve të arsimit të komunës – anëtare;**
**1.7. Remzije Zekolli, zyrtare për barazi gjinore dhe të drejta të njeriut – anëtare;**
**1.8.__________________, kryesues i Komitetit për Komunitete;**
**1.9. Shemsi Rrahimi, përfaqësues i Bashkësisë Islame në Vushtrri – anëtar;**
**1.10. Simor Çimburoviç, përfaqësues i Kishës ortodokse serbe – anëtar;**
**1.11. Banush Elezi, përfaqësues i Kishës protestante ungjillore – anëtar;**
**1.12. Milan Bojkovic, përfaqësues i komunitetit serb - anëtar;**
**1.13. Nermin Munishi, përfaqësuese e komunitetit turk – anëtare;**
**1.14. Sedat Durmishi, përfaqësues i komunitetit ashkali – anëtar;**

**1.15. Brendon Shaqiri, përfaqësues i komunitetit rom – anëtar;**
**1.16. Habib Mustafa, përfaqësues i Këshillit lokal për siguri në bashkësi për fshatrat: Bivolak, Zhilivodë, Gllavatin, Prelluzhë, Stroc, Beçuk dhe Mihaliq – anëtar;**
**1.17. Gjylsime Feka, përfaqësuese e Këshillit lokal për siguri në bashkësi, për fshatrat: Banjskë, Gojbulë, Sllatinë, Tërllobuq, Karaçë, Begaj, si dhe "Kalaja" Vushtrri – anëtar;**
**1.18. Ekrem Merovci, kryesues i Ekipit veprues për siguri në bashkësi – anëtar;**
**1.19. Branisllav Vuksanoviq, përfaqësues i Zyrës komunale për komunitete dhe kthim – anëtar;**
**1.20. Vildane Mulaku, kryetare e Shoqatës "Martirët e Lirisë" (OJQ) – anëtare;**
**1.21. Avni Deliu, përfaqësues i mediave – anëtar;**
**1.22. Hakif Kalludra, përfaqësues i komunitetit të biznesit – anëtar;**
**1.23. Isak Hyseni, përfaqësues i komunitetit të personave me aftësi të kufizuara – anëtar;**

**2. Kryesuesi dhe anëtarët e Këshillit komunal për siguri në bashkësi, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre do t'i ushtrojnë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MPB-së për themelimin e KKSB-së.**

**3. Mandati i KKSB-së është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.**

**4. Kryesuesi dhe anëtarët e KKSB-së, për pjesëmarrje në mbledhje do të kompensohen në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë.**

**5. Në rast se anëtari / ja i/e KKSB-së nuk merr pjesë në tri mbledhje radhazi ose për çfarëdo sjellje ose veprim e komprometon funksionin efektiv të KKSB-së, me propozimin e kryesuesit të KKSB-së, Kuvendi i Komunës emëron anëtarin tjetër të këtij këshilli.**

**6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**9.** Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM 'Uniteti" Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtrri;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**kërkoi një pauzë prej 5 minutave për konsultim mes grupeve kuvendare.
**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit –** në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi Galip Avdiun për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM 'Uniteti" Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtrri.
**Bekim Zabrgja, anëtar i kuvendit-**duke ju referuar Ligjit për Ndërmarrjet Publike neni 5 ku thuhet: Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, të drejtat e saj të aksionarit do të ushtrohet nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me

shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar. Andaj në bazë të këtyre përcaktimeve ligjore askund nuk thuhet se anëtaret e këtij komisioni duhet të jenë nga grupet me të mëdha kuvendare, por nga kuvendi, në rastin konkret është duke u shkelur Ligji për Ndërmarrjet Publike.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi Refik Malokun, për anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM 'Uniteti" Mitrovicë SH.A, njësia në Vushtrri.

**Pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim emërohen dy (2) anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Uniteti" SH.A Mitrovicë - njësia në Vushtrri, si në vijim:**

**1.1 Galip Avdiu, anëtar i Kuvendit të komunës;**
**1.2 Refik Maloku, anëtar i Kuvendit të komunës.**

**2. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, si dhe Statutin e KRM "Uniteti" SH.A në Mitrovicë.**

**3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të Kuvendit të komunës.**

**10.** Shqyrtimi i propozim – vendimit për emërimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL 'Përparimi" SH.A, në Vushtrri;

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit –** në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi Mensur Kosumin për anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL 'Përparimi" SH.A, në Vushtrri.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Agim Bregajn për anëtar të Komisionit Komunal të Aksionarëve në NPL 'Përparimi" SH.A, në Vushtrri.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota "unanime" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim emërohen dy (2) anëtarë të Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Përparimi" SH.A në Vushtrri, si në vijim:**

**1.1 Mensur Kasumi, anëtar i Kuvendit të komunës;**
**1.2 Agim Bregaj, anëtar i Kuvendit të komunës.**

**2. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i ushtrojë detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi për ndërmarrjet publike, si dhe Statutin e NPL "Përparimi" SH.A në Vushtrri.**

**3. Mandati i Komisionit Komunal të Aksionarëve është i njëjtë me mandatin e tanishëm të Kuvendit të komunës.**

**11.** Shqyrtimi i propozim – vendimit për themelim të Komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Institucionet Edukativo Arsimore dhe Aftësuese Parauniversitare në Komunën e Vushtrrisë;

**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**lidhur me këtë propozim –vendim tha se duhet respektohet kota gjinore, ndërsa deklaroi se janë pro këtij komisioni.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**tha se në fushën e arsimit është investuar mjaft shumë e sidomos në infrastrukturë shkollore, por ajo se çfarë e karakterizon dobësinë në procese shkollore është menaxhimi i shkollave. Kur jemi tek procesi i përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mendon se është procesi më i rëndësishëm në menaxhimin e një institucioni arsimor dhe këtë duhet ta ketë parasysh kryetari dhe drejtori i DKA-së. Janë bërë shumë vite që përzgjedhje e drejtorëve është bërë në mënyrë të gabueshme. Për të qenë adekuat një drejtor ai duhet ti ketë disa karakteristika specifike për të që i suksesshëm: së pari ai duhet të jetë mësimdhënës i mirë i dëshmuar për 15-20 vite, në mënyrë që ai të jetë i mishëruar me procesin e arsimit, të mishërohet me praktikat që ndodhin në procesin mësimor gjatë trajtimit të një nxënësi, duhet të jetë i respektuar në kolektivin punues, të jetë i njohur si person që ka prirje në menaxhim. Andaj lidhur më këto ai duke përmendur një shkrim të bërë para disa muajsh, shtoi se ish kryetari i komunës, kishte vendosur drejtorë politikë nëpër shkolla, për çka edhe e kishte kritikuar. Në këtë kontekst vlerësoi se duhet pasur objektiv që të vendosen drejtor të cilët do ti qojnë proceset përpara në ngritjen e cilësisë së arsimit dhe jo drejtor të dëgjueshëm politikë e partiak. Tutje shtoi se dy anëtarët e propozuar sipas tij është kundër tyre jo pse ka diçka personale, është kundër Hashim Hajrizi sepse ka qenë njëri prej anëtarëve në komisionin e kaluar i cili ka bërë vlerësime që sipas tij, që nëse nuk janë të dënueshme me ligj, vlerësimet e tij kanë qenë jo etike, kjo për faktin se vlerësimi ka qenë asisoj që i njëjti kandidat për drejtor në dy shkolla ka marrë 60 pikë, ndërsa në shkollën që kanë dashur ta pranojnë ka marr 80 pikë, dhe për këtë ky anëtar i komisionit ka dështuar të jetë parimor në vlerësimet e tij. Personi tjetër është Ruzhdi Igrishta, për të cilën prapë nuk ka asgjë personale, por nuk e di se a duhet të jetë patjetër drejtor që të jetë pjesë e komisionit, por se vlerësoi se ka edhe perona tjerë që kanë përvojë më të gjatë në menaxhim dhe për këto dhe gjëra të ngjashme ai propozoi që pjesë e komisionit të jetë profesori Sabit Kadriu, i cili ka një përvojë të gjatë dhe është një njeri mjaft korrekt dhe parimor, dhe në të njëjtën kohë është i mishëruar me procesin e arsimit.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se komisioni i propozuar nga qeveria komunale është ndoshta prej komisioneve që ka treguar performancë të lartë në kontinuitet për gjatë shumë viteve. Hashim Hajrizi si zyrtar ligjor në DKA, gjithherë ka marr vendime të bazuar në ligj, pretendimi se një kandidat për drejtor në dy shkolla të ndryshme ka marrë pikë të ndryshme është logjik dhe normal, sepse komisioni ka qenë i njëjtë por pyetjet nuk kanë qenë të njëjta, dhe vlerësimi ka qenë real dhe nuk ka pasur ankesa lidhur me këto procese, për çka tregon se kanë kryer detyrën me përgjegjësi të lartë. Ndërsa drejtori Ruzhdi Igrisha është drejtor shumë vjeçar në shkollën fillore në fshatin Maxhunaj dhe i njëjti ka tregua performancën më lartë të mundshme në menaxhimin e shkollave amë dhe dy shkollave në Vilancë dhe Pestovë, ku në të ardhmen duhet menduar që në këtë të fundit të kemi pavarësi në menaxhimin e asaj shkolle sepse edhe numri i nxënësve është i lartë. Andaj përfundimisht performanca e drejtorit në fjalë për vite ka qenë e shkëlqyer, dhe propozoi që të gjitha grupet kuvendare ta aprovojnë këtë propozim-vendim në mënyrë unanime.

**Refik Maloku, anëtar i kuvendit-**duke replikuar me parafolësin e tij vlerësoi se nëse pozita i ka bërë numrat për ta votuar këtë komision ,sepse këta anëtar janë të PDK-së dhe janë të dëgjueshëm atëherë votojeni. Por nëse nisemi nga parimi për të cilin foli më herët atëherë është tjetër gjë. Lidhur me kandidatin e propozuar nga ai z.Sabit Kadriu, njoftoi se ai nuk është në partinë e Vetëvendosje, dhe ceku se ai është meritor dhe cili ka përvojë të gjatë në arsim.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**tha se Partia Demokratike e Kosovës, asnjëherë nuk do të thirret në arrogancën e numrave, por ceku se anëtarët e komisionit janë profesional dhe që kanë treguar përgjegjësi të lartë në kryerjen e punëve.
**Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-**kërkoi sqarim nga drejtoresha e arsimit, se cila është përgatitja shkollore e dy anëtarëve të propozuar të këtij komisioni dhe a kanë vlerësim të përformacës brenda vitit të fundit kalendarik. Tutje shtoi se procesi i zgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave në Komunën e Vushtrrisë, duhet të bëhet sipas legjislacionit në fuqi Ligjit për arsimin Parauniversitarë dhe Udhëzimin Administrativ Nr.151/2020 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar, ku përcaktohen edhe parimet bazë siç janë: parimi i ligjshmërisë dhe depolitizimit, parimi i meritokracisë dhe kompetencës profesionale, parimi i transparencës dhe bashkëpunimit institucional, parimi i paanësisë mundësive të barabarta dhe mos diskriminimit dhe parimi i barazisë gjinore. Tek pika 1.7 thuhet se: kandidati duhet të sjellë dëshmi dhe dokumente si në vijim: dhe aty në mënyrë taksative përshkruhen një mori e kushteve dhe dokumenteve që duhet ti posedoj kandidati pjesëmarrës në konkurs, ndërsa tek pika 1.7.7. thuhet se: kandidati duhet ta nënshkruaj deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike. Dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA, dhe miratohen nga kuvendi i komunës .Anëtari i parë duhet të jetë i punësuar në DKA dhe duhet të jetë kryesuese i komisionit, anëtari i dytë po ashtu i propozuar nga DKA mund të jetë ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me përformancë të lartë, përfaqësuese nga këshilli i prindërve me kualifikim të lartë dhe ekspertizë në fushën e edukimit po ashtu pjesëmarrës gjatë këtij procesi duhet të jenë dy përfaqësues nga Këshilli Drejtues në cilësinë e vëzhguesve një prind dhe një mësimdhënës. Neni 6 pika 7 e Udhëzimit Administrativ nr.151/2021 përcakton anëtaret e MASH dhe DKA duhet të kenë së paku një kualifikim të barasvlefshëm me kërkesat për kualifikim të kandidatëve për pozitë të drejtorit/zëvendësdrejtorit si dhe përvoja në arsim së paku tri vite. Nga të cekurat më lartë nuk e konteston propozimin për profesorin Ruzhdi Igrishta, por duhet pasur kujdes, dhe është mirë të dimë se cilat janë përgatitjet profesionale të këtyre anëtarëve të propozuar për komision, kjo për faktin se a do mund të ndodh që një anëtar i komisionit me përgatitej themelore universitare të intervistoj një kandidat për drejtor me titull master/magjistër apo doktor i shkencave në këtë drejtim duhet të kemi informata të sakta, nga drejtoresha e arsimit. Këto dhe parime tjera të lartë cekura duhet të jenë pika referuese, të punës së këtij komisioni që do shërbejnë për përzgjedhjen dhe për vendimmarrësit për emërimin e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të shkollave.

**Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 21 vota "për", 6 vota "kundër", 1 votë "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim formohet komisioni për përzgjedhje për vendet e punës: drejtor dhe zëvendësdrejtor, në shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Komunën e Vushtrrisë, me këtë përbërje:**

**1.1. Hashim Hajrizi, zyrtar ligjor dhe personel i DKA-së;**
**1.2. Ruzhdi Igrishta, drejtor i SHFMU ”Rilindja”Maxhunaj**
**1.3_________________, përfaqësues i MASHT-it**

**2. Komisioni do t’i zhvillojë të gjitha procedurat për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në Komunën e Vushtrrisë, konform Udhëzimit Administrativ nr.151/2021 për Detyrat, Përgjegjësitë, Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar.**

**3. Komisioni i cekur si në nenin 1 të këtij vendimi ka mandat për një vit shkollor.**

**4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria e Arsimit dhe komisioni i lartcekur.**

**12.** Shqyrtimi i kërkesës të Kryetarit të komunës për miratimin e nismës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës;

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se edhe mandatin e kaluar kemi pasur një nismë për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës, por që ka qenë një iniciativë e dështuar, andaj edhe tani konsideron se vetëm do të kemi humbje kohe, sepse do të jetë problematike gjetja e një ujdie të përbashkët, sepse zakonisht fillon me ndryshime kozmetike të statutit dhe përfundon tek tendenca kryesore e ndryshimeve për rritjen e numrit të drejtorive komunale, në një buxhet edhe ashtu të varfër. Prandaj në një situatë të tillë që jemi nuk e shohin qe kemi një domosdoshmëri që akti më i lartë juridik i komunës të ndryshohet, prandaj janë kundër plotësim-ndryshimeve të tilla në këtë fazë.
**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**konsideron se nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës, ka qenë e domosdoshëm edhe më herët, mirëpo për arsye subjektive nuk kishte mundur të procedohet. Kur flasim duhet ti referohemi fakteve, Statuti i Komunës ka mbet i pandryshuar që nga viti 2011, ndërsa Ligji për Vetëqeverisje Lokale dhe disa udhëzime administrative kanë pësuar ndryshime të mëdha. Më tej vlerësoi se ka nevojë të kemi ristrukturim të departamenteve komunale duke shtuar drejtori me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve që ofrohen për qytetarët. Edhe nëse nuk shtohet numri i drejtorive komunale, prapëseprapë statuti ka nevojë të ndryshohet sepse edhe kuvendi nuk do të mund ta luaj rolin e vetë, sepse kemi ndryshime legjislative, andaj bërë thirrej që të përkrahet kjo nismë.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**propozimi dhe nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë, është nevojë e funksionimit të organeve të komunës, kjo marr parasysh se prej vitit 2011 nuk është ndryshuar ky akt. Andaj kushdo që do ishte në udhëheqje të komunës, do të fillonte një iniciativë të tillë dhe edhe ai në çfarëdo pozicioni do të përkrahet një nismë të tillë, por gjithësie do të kërkonte të ketë komision profesional prej qeverisë dhe prej kuvendit që janë të gatshëm të marrin përgjegjësi dhe lexojnë nenë për nenë dhe paragraf për paragraf. Statuti i Komunës duhet të ndryshohet sepse është nevojë e kohës dhe duhet të bëhet harmonizimi me ligjet dhe udhëzimet administrative dhe me qëllim të funksionimit sa më të mirë të organeve komunale. Andaj kërkoi nga kuvendi që të përkrahet kjo nismë dhe të formohet komisioni profesional për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.

**Në fund të debati lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 20 vota “për”, 5 vota “kundër”, 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim miratohet nisma e Kryetarit të komunës për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë 01Nr. 58/11, i miratuar më datë 28.4.2011.**

**13.** Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e Komisionit për përgatitje të draftit të Statutit të Komunës për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës;

**Mentor Hasani, anëtar i kuvendit –** në emër të grupit kuvendar të PDK-së, propozoi Ilmi Azemi, për anëtar të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së, propozoi Shkelzen Xhaferin për anëtar të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.
**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-** në emër të grupit kuvendar të LVV-së, propozoi Nasuf Aliun për anëtar të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**propozoi Ismet Gashin dhe Albanez Tahirajn, për anëtarë të komisionit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të komunës.

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota "unanimi" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim formohet komisioni për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Vushtrrisë në këtë përbërje:**

**1.1. Ilmi Azemi, anëtar i Kuvendit (PDK);**
**1.2.Shkelzen Xhaferi, anëtar i Kuvendit (LDK);**
**1.3 Nasuf Aliu, anëtar i Kuvendit (LVV);**
**1.4 Albanez Tahiraj, (drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë) dhe**
**1.5 Ismet Gashi, (udhëheqës i Zyrës ligjore).**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet komisioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, i cili ka për obligim që t'i hartojë ndryshimet statutare dhe të njëjtat duhet t'ia ofrojë Kuvendit të komunës për aprovim.**

**3. Komisoni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi ka për detyrë të mbajë takime, dhe në përbërjen e tij duhet të zgjedh kryesuesin e komisionit dhe procesmbajtësin, ashtu që të evidentojë ndryshim-plotësimet e dispozitave statutare dhe të përgatitë draftin <Propozim-ndryshimet e Statutit bazë të Komunës së Vushtrrisë>.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.**

**14.** Shqyrtimi i peticionit të ish banorëve të fshatit Skoçan për përfshirje në buxhetin e vitit 2022, asfaltimi i rrugës që lidh fshatin. Skoçan me Vushtrrinë.

**Sylejman Meholli, anëtar i kuvendit-**tha se si grup kuvendar e përkrahin këtë kërkesë të banorëve të fshatit Skoçan, për ndërtimin e rrugës në fjalë. Ai shtoi se është i vetëdijshëm se kjo rrugë ka një

gjatësi bukur të madhe, por duhet të fillohet të bëhet ndërtimi i asaj rruge qoftë edhe si projekt dy apo tre vjeçar.
**Adnan Lahu, anëtar i kuvendit-**në emër të grupit kuvendar të LDK-së, tha se e mbështesin peticionin e këtyre banorëve, dhe ceku se ky projekt do të mund të realizohej nga të hyrat e bartura.
**Ferit Idrizi, kryetar i komunës-**tha se marr parasysh gjendjen financiare të komunës se si e kemi aktualisht, mendon që këtë vit të fillohet nga të hyrat e bartura, me rregullimin e tamponit dhe të jetë si projekt që vazhdon në vitin 2023 dhe 2024

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota "unanimi" vendosi me sa vijon:**

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 31 janar 2022, ka shqyrtuar peticionin e adresuar në emër të Fehmi Kasumit, përfaqësues i banorëve të fshatit Skoçan, lidhur me kërkesën për futje në buxhet të komunës, projektin – asfaltimi i rrugës që lidh fshatin Skoçan me Vushtrrinë, përkatësisht segmenti nga Begaj, pjesa e asfaltuar deri në fshatin Skoçan, në gjatësi prej 6 km, në ç'rast ka vendosur me sa vijon:**

**Projekti i cekur më lart do të futet në planifikim të buxhetit për vitet 2022-2023-2024, nga buxheti i komunës, nga të hyrat e bartura.**

**Në vitin 2022 do të fillohet me rregullimin e tamponit të rrugës. Ky projekt do të zhvillohet si projekt trevjeçar për shkak të kufizimeve buxhetore që ndodhet aktualisht Komuna e Vushtrrisë.**

**Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Vushtrrisë që bëjë inkorporimin e këtij projekti në buxhetin e komunës.**

**15.** Shqyrtimi i propozim-vendimit për lirimin nga pagesa të taksës për shërbimet e çerdheve publike në Komunën e Vushtrrisë;

**Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota "unanimi" vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim lirohen nga pagesa e taksës për ofrimin e shërbimeve për fëmijët që marrin shërbime nga çerdhja publike.**

**2. Vendimi për lirimin nga obligimi i pagesës së takës për shërbimet e çerdheve publike, bëhet për prindërit, fëmijët e të cilëve marrin shërbime nga çerdhet publike, kjo masë aplikohet si rrjedhojë e rëndimit të gjendjes sociale të familjeve, si pasojë e pandemisë covid-19, e njohur si corona-virus.**

**3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

**4. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë dhe fillon të prodhojë efekt juridik për muajt shkurt dhe mars 2022 dhe vazhdon deri në një vendim të ardhshëm të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.**

**16.** Shqyrtimi dhe aprovimi i deklaratës për mbështetjen e profesorit Lulizim Paci.

**Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit-**në emër të komisionit ad-hoc kuvendar lexoj deklaratën në mbështetje të profesorit Lulzim Paci.

**Lidhur me këtë pike të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 22 vota "për" 1 votë "kundër" vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë **31 janar 2022,** pasi ka shqyrtuar propozimin e anëtarit të kuvendit z.Ilmi Azemi, për futje në rendin e ditës të mbledhjes, propozimin e tij lidhur me reagimet publike ndaj profesorit Lulzim Paci, miraton këtë:

**DEKLARATË**

Ne anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë në cilësinë e përfaqësuesve qytetarë, kemi përcjell me shqetësim akuzat e pabaza ndaj profesorit z.Lulzim Paci, andaj jemi të bindur se reagimet dhe kërkesat absurde publike, kanë ardhur në mënyrë të rastësishme dhe pa u artikuluar drejt. Kërkesat dhe pretendimet ndaj Lulzim Pacit janë të paarsyeshme dhe të padrejta, kështu që ftojmë të gjithë akterët që të distancohen nga fyerjet ndaj profesorit Lulzim Paci, ftojmë gjithashtu të gjithë ata që kanë kritikuar profesorin pa bazë, të kërkojnë falje publike dhe të tërheqin fjalët denigruese, të cilat e kanë rënduar emocionalisht profesorin e nderuar Lulzim Paci, por edhe opinionin publik.

**Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë.**

**31 janar 2022**

**Mbledhja përfundoj në ora: 15:50**

| | |
|---|---|
| **Bastri Duraku** | **Melihate Basholli-Latifi** |
| ____________________ | ________________________ |
| **Procesmbajtës** | **Kryesuese e Kuvendit** |

**MEMORANDUM ZYRTAR - SLUZBENI MEMORANDUM - OFFICIAL MEMORANDUM**

| | | | |
|---|---|---|---|
| **PËR:**<br>**ZA:**<br>**TO:** | Zonja Melihate Basholli<br>Kryesues i kuvendit komunal Vushtrri | **Data:**<br>**Datum:**<br>**Date:** | 10.02.2022 |
| **PËRMES:**<br>**PREKO:**<br>**THROUGH** | Drejtpërdrejtë | **Nr. i Referencës:**<br>**Br. Referencije:**<br>**Reference No:** | 04/1-02 VSH-K / 028 / 2022 |
| **PREJ:**<br>**OD:**<br>**FROM:** | Kapiten Reshat Kovaçi<br>Komandant i Stacionit<br>Stacioni Policor Vushtrri | | |
| **LËNDA:**<br>**PREDMET:**<br>**SUBJECT:** | Informatë mbi gjendjen e sigurisë në zonën e pëgjegjesisë së komunës së Vushtrrisë për vitin 2021 | | |

E nderuara Kryesuese zonja Melihate BASHOLLI

Gjendja e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Stacionit Policor ne Vushtrri konsiderohet se është stabile dhe e qetë . Gjatë vitit 2021 në përgjithësi janë përmbushur objektivat policor, posaçërisht gjendja e sigurisë ka qen e mirë dhe nuk karakterizohet me raste madhore me ndikim te madh ne jetën e qytetareve. Me anë të një bashkëpunimi të ngushtë me qytetarë, por edhe me të gjitha institucionet lokale dhe qendrore relevante në fushën e sigurisë, Policia e Kosovës, respektivisht stacioni policor Vushtrri, ka arritur që të ofrojë siguri, rend dhe qetësi publike të qëndrueshme, për të gjithë qytetaret. Viti 2021 ka qene një vite i angazhimeve te shumta, zbatimi i Ligjit për parandalimin e pandemisë “Covid 19” ka qene një nder angazhimet me te mëdha gjate këtij viti. Po ashtu zgjedhjet nacionale dhe lokale kane kërkuar angazhime shtese te Stacionit Policor ne Vushtrri. Në vazhdën e aktiviteteve të zyrtarëve policor të stacionit policor Vushtrri, janë arritur rezultate në luftimin e dukurive më shqetësuese të shoqërisë, përkundër sfidave të shumta të cilat janë paraqitur gjatë përmbushjes së objektivave policore.

Për periudhën raportuese, është vërejture një tendence e rritjeve te incidenteve dhe se ne Stacionin policor Vushtrri janë evidentuar gjithsej: 1126 raste, prej të cilave 784 janë klasifikuar si vepra penale, ndërsa 342 raste janë klasifikuar si kundërvajtje dhe raste të natyrave të tjera.



Adresa: Rr. „Bedri Pejani” pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

- **Disa nga Veprat penale me serioze**

Gjate këtij viti tek Veprat penale kundër Jetës dhe Trupit janë shënuar ulje te rasteve serioze siç janë Vrasjet dhe Vrasjet e renda ku ka vite qe nuk na ka ndodhur asnjë, por kemi shënuar një rritje te vogël tek veprat me pak serioze siç janë Lëndimet trupore dhe Kanosjet . Veprat penale kundër pasurisë ka pas një rënie ne veprat me serioze siç janë grabitjet dhe vjedhjet ,por te vjedhjet e rënda ka pas një rritje te lehte . Angazhimi i zyrtareve hetues ne pune tjera ka bere qe te mos jemi te kënaqur ne zbulimin e këtyre veprave edhe pse konsiderojmë qe jemi te suksesshëm. Mbetet të punohet edhe me shume ne përmirësimin e gjendjes në këtë drejtim me qëllim të parandalimit apo reduktimit të mëtutjeshëm dhe shtimin e zbulimit të këtyre rasteve.

Një nder dukuritë me shqetësuese qe është duke ndodhur ne qytetin e Vushtrrisë është dukuria e përdorimit dhe konsumit te Narkotikeve. Në këtë drejtim Stacioni policor Vushtrri ka ndërmarr aksione parandaluese dhe ka identifikuar dhe iniciuar shume raste te cilat janë proceduar ne Prokurori. Janë te njohura edhe zonat me problematike te qytetit ku dyshohet se behet shitblerja dhe përdorimi i narkotike, këto zona janë në fokusin tone të punës dhe gjate vitit 2022, meqë kemi rritje te kapaciteteve njerëzore do ti rrisim edhe angazhimet . Gjatë vitit 2021, kemi hasur në 23-raste, 27-persona të dyshuar të cilët kanë pasur në posedim substanca narkotike dhe pajisje për përdorimin e tyre.

Përdorimi dhe Posedimi i armeve vazhdon te jete i madh dhe shqetësues, duke vërejtur një përdorim me te vogël ne ahengje si shkak edhe i këmbëngulësisë sonë ne luftimin e kësaj dukurie. Gjatë vitit 2021 gjithsej janë konfiskuar 32 armë zjarri dhe municion i kalibrit të ndryshëm 204 copë .

Gjatë vitit 2021 në zonën e përgjegjësisë së Vushtrrisë dhe zonat me minoritete nuk ka pasur të raportuar asnjë rast me motive ndëretnike.

- **Siguria Publike**

Për veç angazhimeve të rregullta policore në patrullimet si në qytet edhe në fshatra ka pas angazhime dhe patrullime sidomos në orët e mbrëmjes si masë parandaluese kundër veprave penale kundër pasurisë . Edhe në vitin 2021 kanë vazhduar planet operative të rregullta për çdo vit si plani Sezoni veror ,plani Sezoni dimërore dhe një numër të planeve si Zgjedhjet nacionale, Zgjidhjet lokale ,Grabitjet ,Siguria në shkolla , Plani kundër Narkotikeve ,Testi i maturës ,Siguria në trafik etj . Kemi pas plane veprimit në zbatim të masave të qeveris kundër pandemisë përgjatë gjithë vitit e sidomos në fund të muajit gusht ,shtator e tutje deri te stabilizimi i gjendjes ,me ç’rast janë ndërmarr shumë masa dhe janë shkruar shumë gjoba për mos respektimin e masave . Angazhime të shtuar ka pas gjatë ardhjes së mërgatës ku kemi pas një fluks të qytetarëve dhe automjeteve si në rrugët e qytetit ashtu edhe në ato rajonale. Patrullime të shtuara rreth vendeve ku ka pas frekuentime te të rinjve në lokale sidomos në rrugët :Dëshmorët e Kombit ,Pandeli Sotiri dhe Galip Badivuku dhe përgjatë bulevardit Adem Jashari dhe Hasan Prishtina.

Një nder problemet shume shqetësues qe paraqesin edhe qytetaret ne Adresën e Policisë është problemi i Qeneve endacak, te cilët janë shqetësim i madh që zgjidhje kërkohet nga niveli i qeverisjes lokale.



Adresa: Rr. „Bedri Pejani” pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

- **Trafiku**

Edhe për kundër angazhimeve të shtuara në trafik dhe planeve operativë në trafik viti i 2021 është karakterizuar me shtim të aksidenteve, ku kemi pasur 277 aksidente prej tyre 180 me dëme materiale dhe 97 aksidente me lëndime, kurse me fatalitet ne gjithë zonën e përgjegjësisë se S.P.Vushtrri kane qene tre raste me tre viktima edhe për kundër masave që janë marr me shkrimin e tiketave për kundërvajtje ku janë shënuar një numër i madh i tiketave 4958, gjendja në trafik është jo e mirë . Parkimet e pa rregullta në qytet për shkak të mungesës së infrastrukturës të parkimeve publike janë shumë problematike. Si problematik e trafikut është mungesa e sinjalistikës rrugore si në qytet e sidomos në magjistrale ku kemi tri pika kritike në vend kalimet e katër korsive në udhëkryqin rrugës magjistrale me ,, 2 Maji , udhëkryqin me Begaj dhe udhëkryqi me rrugën Shote Galica, me ç 'rast kemi pas edhe protesta të qytetarëve . Vendet e cekura janë rreziqe potenciale për këmbësor e sidomos për nxënës që çdo dit kalojnë në ato vend kalime . Marrja e masave ndaj taksive ilegale dhe kombi busëve që bartin qytetarët jemi detyruar që të marrim masa ndëshkimore .Edhe pse problemi i parkimeve në qytet është potencuar dhe është kërkuar zgjidhje ende asgjë konkrete nuk po duket rreth kësaj problematike . Pengesë kanë qenë edhe punimet e rrugëve e sidomos rruga nacionale Mitrovicë – Prishtinë , ku gjatë kohës së verës ka qenë i ngarkuar dhe me ngadalësim të qarkullimit dhe ardhjes së një numri të madh të mërgimtarëve me automjete . Zyrtarët policor me pika kontrolli dhe me radar kanë bërë kontrollime mbi shpejtësinë dhe respektimin e shenjave të komunikacionit ku janë marr masa kundërvajtës .

- **Siguria në shkolla**

Siguria në shkolla është në nivel falë punës së zyrtarëve Policor që janë të angazhuar rreth sigurisë në shkolla dhe bashkëpunimit të mirë mes drejtorisë së arsimit dhe drejtorëve të shkollave . Koordinimi institucional i drejtoreve dhe zyrtarëve policor ka tregu rezultat. Patrullime të shpeshta ka sidomos në kohët e pauzave sidomos rreth shkollave të mesme . Qëllimi i angazhimit të zyrtarëve rreth shkollave është shtimi i sigurisë ,besimi në bashkëpunim edhe me nxënës dhe mos lejimi i personave që nuk janë nxënës të kenë qasje në objektet shkollore . Angazhim ka edhe rreth parandalimit të përdorimit të substancave narkotike nga nxënësit . Në bashkëpunim me drejtorin e arsimit kemi realizuar një kontrolle në disa shkolla me të vetmin qëllim parandalimin e bartjeve të mjeteve të rrezikshme nga ana e nxënësve dhe ky kontroll ka pas efekt pozitiv edhe në besimin e nxënësve dhe stafit të shkollave që nuk ka vend për bartjen e mjeteve të rrezikshme dhe substancave narkotike në shkolla .

- **Bashkëpunimi institucional dhe me qytetar**

Bashkëpunim të mirë kemi me të gjitha institucionet si lokale ashtu edhe qendrore ,gjykatat dhe kompanitë që ofrojnë shërbime si janë KEDS dhe Përparimi, me përmbarues etj. Në komunën tone funksionon Këshilli Komunal për Siguri ne Bashkësi qe udhëhiqet nga Kryetari i Komunës se Vushtrrisë dhe qe ne këtë këshill është një numër i madh i anëtareve te cilët japin kontributin e tyre ne këshilla dhe ne identifikim te problemeve qe i preokupojnë qytetaret. Gjate vitit 2021 janë mbajtur takime te cilat kanë kontribuar në rritjen e sigurisë në përgjithësi dhe koordinim i mirë ka qenë me komitetin për luftën kundër pandemisë Covid -19 . Gjithashtu në zonën tone te përgjegjësisë funksion edhe dy Këshilla Lokale për Siguri Publike, ne fshatin Bajnske dhe fshatrat përreth dhe një ne fshatin



Adresa: Rr. „Bedri Pejani" pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

Prilluzh dhe ne fshatrat përreth . Kemi mbajtur takime me qëllim shtimin e sigurisë sidomos në zonat me popullatë të përzier me minoritet .

- Polica e Kosovës, respektivisht Stacioni Policor Vushtrri edhe gjatë viti 2022, do të vazhdojë me përkushtimin të lartë të angazhohet në përmbushjen e objektivave Policore për të krijuar një ambient , sa më të sigurt dhe të qetë për të gjithë qytetarët.

Me respekt!



Adresa: Rr. „Bedri Pejani” pn. 42000 Vushtrri, Kosovë
Stacioni Policor Vushtrri, Mitrovicë

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës

---

**Datë:** **08.02. 2022**

**Për: KPF, Kuvendin Komunal**

**Propozues:** **Kryetari i Komunës, Ferit Idrizi** ____________

**Hartues:** **Drejtoria për Shërbime Publike, Benjamin Shala** ____________

**Për miratim:** **Propozim –Vendim për miratim të Planit Pesëvjeçar për Menaxhim të Mbeturinave 2022-2026**

---

Bazuar në Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 3, nenit 10 paragrafi 2 në lidhje me nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L -060 për mbeturina, Nenin 12 pika (d) si dhe nenin 17.1 pika (f) të Ligjit 03/L-40 mbi vetëqeverisjen Lokale, Nenin 41.2 pika (ç) të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _________ **2022**, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËR APROVIM TË PLANIT PESËVJEÇARË TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE 2022-2026**

1. Me këtë vendim aprovohet Plani Pesëvjeçar i Menaxhimit të Mbeturinave 2022-2026.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria e Inspektimeve.

3. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

_________________

Melihate Basholli-Latifi

**Arsyetim**

Që nga hyrja në fuqi të Ligjit për Mbeturinat (Ligji nr.04/L-060), sipas politikave të Qeverisë, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve si dhe shërbimet tjera të pastrimit, i janë deleguar autoriteteve lokale përmes promovimit të decentralizimit. Ky ligj ka deleguar më shumë autoritet dhe përgjegjësi te qeverisja lokale sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Pra në këtë kuadër janë qartësuar edhe përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji. Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Vushtrrisë, me qëllim të implementimit të kësaj infrastrukture ligjore, krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë përmes menaxhimit të plotë të mbeturinave dhe pas skadimit të afatit kohor të Planin Komunal Pesëvjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2020, ka hartuar Planin Komunal Pesëvjeçar për Menaxhimin e Mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026. Ky plan i menaxhimit të mbeturinave korrespondon me ligjin për mbeturinat dhe Strategjinë Kombëtare për menaxhimin e mbeturinave si një plan afat mesëm dhe është një vazhdimësi që synon rritjen e cilësisë së shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, si shërbim prioritar për qytetarët.

Objektivat e këtij Plani të menaxhimit të mbeturinave janë:
- rritja e cilësisë së ofrimit të shërbimit për menaxhimin e gati të gjitha mbeturinave komunale në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë,
- zvogëlimi i sasisë së mbeturinave që duhet të deponohet në deponi përmes promovimit dhe aplikimit të ndarjes së mbeturinave që në burim pra riciklimit të mbetjeve të ricikueshme, me qëllim të rritjes së jetëgjatësisë së deponisë, si dhe kompostimit të mbetjeve organike.

Drejtoria për Shërbime Publike në Komunën e Vushtrrisë në kuadër të reformës në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe me qëllim të arritjes së objektivave të Planit Komunal, si dhe Rregulloren për menaxhim të mbeturinave është e përkushtuar në:
- krijimin e mekanizmit institucional përmes formimit të sektorit për menaxhim të mbetjeve,
- fuqizimin e mekanizmave për rritjen e shkallës së inkasimit të taksës për mbeturina si e hyrë komunale, dhe
- promovimin e 3R që nënkupton reduktimin, riciklimin dhe ripërdorimin e sasisë së mbeturinave.

Përveç këtyre komuna e Vushtrrisë ka ndërtuar një partneritet të qëndrueshëm me GIZ, GAC i cili partneritet, ka ndikuar dukshëm në ngritjen e kapaciteteve të grupit punues, për formësimin e idesë dhe konceptit për menaxhimin e mbetjeve si shërbim prioritar për qytetarët.

Drejtori i Drejtorisë

Benjamin Shala

# PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

KOMUNA E VUSHTRRISË

2022~~1~~-2026~~5~~

## Përmbajtja


Parathënie nga Kryetari i Komunës ........ 998

Shkurtesat ........ 10109

Përkufizimet e Mbeturinave ........ 111110

1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT ........ 141413

1.1 Hartimi i planit komunal për menaxhim të mbeturinave ........ 141413

1.2 Metodologjia ........ 141414

2. POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE ........ 151515

2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave ........ 161615

2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave ........ 161616

2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat ........ 171717

2.4 Rolet dhe përgjegjësitë ........ 181817

2.4.1 Pushteti lokal ........ 181818

2.4.2 Kompanitë rajonale/komunale të menaxhimit të mbeturinave ........ 191918

2.4.3 Kompanitë e tjera ........ 191919

3. ASPEKTI INSTITUCIONAL ........ 202020

3.1 Organizimi në nivel qendror ........ 202020

3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune ........ 202021

4. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS ........ 242425

4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës ........ 252525

4.2 Vlerat natyrore dhe turistike ........ 252526

4.3 Infrastruktura rrugore ........ 262626

4.4 Aspekti socio – ekonomik ........ 262626

4.4.1 Industria ........ 292929

4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore ........ 292930


**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

5. KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE .......... 303031

5.1 Situata aktuale e shërbimi të grumbullimit të mbeturinave në komunë .......... 303031

5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave .......... 313132

5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave urbane .......... 323233

5.4 Orari i operimit (referent 2019-2020) .......... 333333

5.5 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim mbeturinash .......... 333334

5.6 Riciklimi i mbeturinave .......... 353535

5.7 Kompostimi .......... 353536

5.8 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera .......... 363636

5.9 Deponimi i mbeturinave .......... 363637

5.10 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje .......... 373737

5.11 Mjetet për ofrimin e shërbimit .......... 373738

5.12 Financat dhe të hyrat financiare .......... 404040

5.12.1 Çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues .......... 404041

5.13 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare .......... 414142

5.14 Nevojat dhe prioritetet .......... 424242

6. PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE .......... 444445

6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni .......... 444445

6.2 Objektivat dhe Rezultatet e PKMM .......... 454546

7. VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE .......... 494950

7.1 Kriteret për planifikim .......... 494950

7.2 Gjenerimi i mbeturinave .......... 494950

7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Vushtrrisë .......... 515152

7.4 Projeksioni i rritjes së mbeturinave 2021 – 2026 .......... 545455

8. PLANI FINANCIAR I SHËRBIMIT TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË MBETJEVE 575759

8.1 Kosto e shërbimit 2021-2025 ........ 585859

8.1.1 Kosto administrative........ 585859

8.1.2 Të ardhurat net të planifikuara ........ 585859

8.1.3 Kosto e menaxhimit të mbeturinave ........ 585859

8.2 Kosto operative të shërbimit........ 585860

8.3 Kosto kapitale ........ 595960

8.3.1 Kostot investive për realizimin e shërbimit të bartjes së mbeturinave........ 595961

8.3.2 Kostot investive për Sigurimin e kontenierëve për unifikim të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave ........ 606061

8.3.3 Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për deponinë inerte ........ 606061

8.3.4 Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës për qendrën e grumbullimit të mbeturinave të vëllimshme dhe të riciklueshme........ 606061

8.3.5 Kostot investive për Realizimin e infrastrukturës përcjellëse për qendrën e reduktimit dhe riciklimit ........ 606061

8.3.6 Kostot investive Sigurimin e kontenierëve dhe infrastrukturës për ndarje në burim, përfshirë dhe enët kompostuese........ 606062

8.3.7 Kosto shtesë ........ 616163

8.3.7.1 Ndërgjegjësim dhe edukimi i banorëve për mbrojtjen e mjedisit........ 616163

8.3.7.2 Ngritja e bazës së të dhënave të subjekteve pagues ........ 626263

8.4 Kostot investive për realizimin e PKMM........ 626263

9. PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE........ 787877

10. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL ........ 828281

10.1 Rregullorja komunale........ 828281

10.2 Zbatimi i rregullores dhe sanksionet ........ 828281

10.3 Licencimi mjedisor........ 838382

10.4 Pjesëmarrja e sektorit privat ........ 838382

10.5 Mbështetja politike ........ 838383

## Lista e Tabelave


Table 1. Statistika për Komunën e Vushtrrisë ..... 26

Table 2. Shpërndarja e popullësisë në zonen urbane ..... 27

Table 3. Shpërndarja e popullësisë sipas fshatrave ..... 27

Table 4. Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga KRU "Uniteti") ..... 31

Table 5. Irinerari i grumbullimit të mbeturinave në fshatra ..... 32

Table 6. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave ..... 34

Table 7. Shpërndarja e shportave për riciklim me kapacitet 120 l dhe 240 l ..... 36

Table 8. Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave ..... 38

Table 9. Logjistika e operimit për grumbullimin e mbeturinave ..... 38

Table 10. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, Komuna dhe KRU "Uniteti" ..... 41

Table 11. Objektivi 1 sipas PKMM ..... 46

Table 12. Objektivi II sipas PKMM i ofrimit të shërbimit për ndarje në burim ..... 48

Table 13. Objektivi i III sipas PKMM ..... 48

Table 14. Objektivi i IV sipas PKMM ..... 49

Table 15. Objektivi i 5.1 sipas PKMMError! Bookmark not defined.~~Error! Bookmark not defined.5~~0

Table 16. Objektivi i 5.2 sipas PKMMError! Bookmark not defined.~~Error! Bookmark not defined.5~~0

Table 17. Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Vushtrrisë referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore)Error! Bookmark not defined.~~Error! Bookmark not defined.5~~4

Table 18. Gjenerimi i mbeturinave për periudhë 1 vjeçare në komunën e Vushtrrisë..............Error! Bookmark not defined.~~Error! Bookmark not defined.5~~4


**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Font: +Body (Malgun Gothic), 12 pt, Not Bold, Font color: Auto, Albanian

**Formatted:** Albanian, Do not check spelling or grammar

**Formatted:** Albanian (×27)

Formatted: Albanian

## Parathënie nga Kryetari i Komunës

Të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë,

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave është i një rëndësie të veçantë për Komunën e Vushtrrisë. Qëllimi kryesor i këtij plani është krijimi i një strategjie për integrim dhe optimizimin e planeve për menaxhim të mbeturinave komunale me qëllim përmbushjen e objektivave të komunës për maksimizimin e efiçiencës së shërbimit për qytetarë dhe minimizimin e impakteve mjedisore dhe financiare me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të Komunës në fushën e mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj.

Hartimi i planit për menaxhim të mbeturinave është mbështetur në pjesëmarrjen aktive të institucioneve përkatëse lokale dhe atyre qendrore, të komunitetit dhe organizatave joqeveritare.

Realizimi i programeve dhe aktiviteteve të propozuara në plan do t'i referohet mundësive për zhvillim ekologjik të komunës së Vushtrrisë dhe qasjes sistematike dhe gjithëpërfshirëse me implikime aftagjata për jetën e qytetarëve të komunës sonë.

Ky dokument do t'ju shërbejë të gjithë akterëve, institucioneve vendore dhe institucioneve qeveritare të huaja, që të fokusohen në investime në fushën e mjedisit në Komunën e Vushtrrisë dhe zbatimin e planeve që fokusohen në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave.

Zhvillimi i politikave mjedisore për reduktim, riciklim apo trajtim të duhur të mbeturinave do të nënkuptojë krijimin e mundësive për zhvillimin ekonomik në këtë sektor në nivel komunal dhe nivel vendi si dhe shfrytëzimin sa me racional të resurseve natyrore.

Për realizimin e këtij plani, dua të falënderoj grupin punues dhe organizatën joqeveritare Green Art Center –Prishtina (GAC) për mbështetje dhe përkrahjen e vazhdueshme profesionale për përmirësim të gjendjes mjedisore në Kkomunën e Vushtrrisë dhe hartimin e planeve konkrete në menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave me rëndësi të veçantë për komunën tonë.

Formatted: Albanian

Ndërkohë, si komunë dhe bashkarisht do të punojmë në vazhdimësi për të krijuar kushte për të rritur kulturën e ruajtjes së mjedisit dhe mbështetjen ndaj iniciativave reduktuese dhe ricikluese.

Kryetari i Komunës

~~Xhafer Tahiri~~Ferit Idrizi

Formatted: Albanian

## Shkurtesat

| | |
|---|---|
| **AKMM** | **Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës** |
| ASK | Agjensia e Statistikave të Kosovës |
| BE | Bashkimi Evropian |
| DMSHSHP | Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbimeve Publike |
| GAC | Green Art Center Prishtina |
| KMDK | Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë |
| MEA | Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit |
| NPK | Ndërrmarrja publike komunale |
| MM | Menaxhimi mbeturinave |
| MIM | Menaxhimi integruar i mbeturinave |
| PMIM | Plani lokal për menaxhim të interguar të mbeturinave |
| PKMM | Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave |
| PMMI | Plani lokall i Menaxhimit të Mbeturinave Inerte |
| SRKMM | Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave |

**Formatted:** Font: 11 pt, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Font: 11 pt, Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted:** Font color: Text 1, (Asian) Japanese, (Other) Albanian
**Formatted:** Font: Not Bold, Albanian
**Formatted** ...
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted** ...
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian

## Përkufizimet e Mbeturinave

Përkufizimet që janë përdorur në këtë document janë ato që janë përdorur në Ligjin Nr.2012/04-L-060 për Mbeturinat.

**Bio-mbeturinë** – mbeturinat biodegraduese nga kopshtet, parqet, ushqimet dhe mbeturinat e kuzhinës nga familjet, restorantet, objektet turistike, shitoret me pakicë dhe mbeturinat engjashme nga impiantet për përpunimin e ushqimit.

**Deponi** – vendi i caktuar dhe rregulluar për mbeturina, ku do të vendosen mbeturinat nën apo mbi sipërfaqe të tokës.

**Deponim përfundimtar i mbeturinave** – operimet të cilat ofrojnë zgjidhje përfundimtare për mbeturinat të cilat nuk mund të ripërdoren apo përpunohen, duke mos rrezikuar mjedisin apo shëndetin e njeriut.

**Deponim** – çdo operim i cili nuk është përpunim, as në rastet kur operimi ka për pasojë sekondare rikuperimin e substancës apo energjisë.

**Kompostim** – trajtim i mbeturinave të biodegradueshme nën veprimin e mikroorganizmave në prezencën e oksigjenit,i cili kryhet me qëllim të prodhimit të kompostit nën kushte të kontrolluara.

**Konsumator** – personi icili ka lidhur kontratë për shërbime me ofruesin eshërbimeve ose merr shërbime tëcaktuara sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinat”, Republika e Kosovës.

**Kullim** – çdo lëng që rrjedh ose i shpërlarë nga mbeturinat e deponuara dhe që shkarkohet nga deponia ose gjendet brënda deponisë.

**Liçenca për menaxhimin e mbeturinave** –leje me shkrim e cila lëshohet me vendim të Ministrisë, me të cilën vërtetohet se janë plotësuar kushtet sipas Ligjit Nr. 04/L-060 “Për Mbeturinat”, Republika e Kosovës.

**Mbeturinë** – substancë apo objekt që prodhuesi apo zotëruesi e hedh, ka për qëllim ta hedhë apo është i detyruar ta hedhë.

**Mbeturina industriale** – mbeturinat të cilat krijohen nga aktivitetet, proceset industriale, prodhimtari artizanale dhe veprimtari të tjera prodhuese.

**Mbeturina inerte** – mbeturinat të cilat nuk pësojnë ndonjë ndryshim të rëndësishëm fizik, kimik dhe biologjik në vendet ku janë deponuar si:

i.mbeturina inerte që nuk treten, nuk ndizen ose nuk reagojnë fizikisht apo kimikisht, nuk zbërthehen biologjikisht në kontakt me materiete tjera dhe nuk ndikojnë në mënyrë të ndjeshme në mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

ii.i tërë kullimi dhe përmbajtja ndotëse e mbeturinës, mbetjet ekotoksike duhet të jenë të vlerës së papërfillshme dhe të mos rrezikojnë cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

**Mbeturina komerciale** – mbeturinat të cilat vijnë nga objektet që përdoren për qëllimet e tregut ose biznesit, sportit, edukimit, rekreacionit, por nuk përfshihen mbeturinat industrial.

**Mbeturina komunale** – mbeturina nga amvisëritëdhe mbeturina nga aktivitetet e tjera të cilat,për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.

**Mbeturina medicinale** – mbeturina të cilat krijohen gjatë kryerjes së shërbimeve medicinale.

**Mbeturina të parrezikshme** – mbeturinat që nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut dhe që nuk posedojnë karakteristika të mbeturinave të rrezikshme.
**Mbeturina të rrezikshme** – mbeturinat që paraqesin një apo më shumë veti të rrezikshme.

**Mbeturina të veçanta** – mbeturinat të cilat për nga natyra e krijimit dhe trajtimit konsiderohentë veçanta.

**Mbeturina të vëllimshme** – mbeturinat me përmasa të mëdha fizike nga pajisjet dhe makineritë, grumbullimi, transportimi dhe largimi i të cilave bëhet në mënyrë të veçantë.

**Mbledhje** – mbledhje dhe transportim i mbeturinave duke përfshirë klasifikimin paraprak në lloje dhe magazinimin e mbeturinave për qëllime të bartjes deri në objektin për trajtim ose deponim të mbeturinave.

**Mbledhje e ndarë** – nënkupton mbledhjen, kur grumbullimi imbeturinave bëhet në mënyrë të ndarënë lloje, të klasifikuar sipas natyrës dhe pajisjeve për të lehtësuar trajtimin specifik.

**Menaxhim i mbeturinave** – aktivitetet për evitimin dhe reduktimin e prodhimit të mbeturinave dhe ndikimit të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut, mbledhjen, transportin, trajtimin, ripërdorimin, përpunimin, riciklimin dhe deponimin përfundimtar të mbeturinës, përfshirë monitorimin dhe kujdesin edhe pas kryerjes së këtyre aktiviteteve.

**Parandalim** – masat e ndërmarra para se substanca, materiali apo produkti të bëhet mbeturinë, për të redukuar:
I.sasinë e mbeturinës, përfshirë ri-shfrytëzimin e produkteve ose zgjatjen e jetëgjatësisë së produkteve;
Ii.efektet negative të mbeturinave për mjedisin dhe shëndetin e njeriut;
Iii.përmbajtjen e substancave të dëmshme në materiale dhe produkte.

**Përdorimi mbeturinave** – çdo operim, veprimtari që kryhet për qëllime riciklimi ose ripërdorimi të mbeturinave, pjesërisht ose në tërësi, duke përfshirë edhe çdo aktivitet të specifikuar.

**Përpunim i mbeturinave** – operim, rezultati kryesor i të cilit është vënia në shërbim e mbeturinave për qëllime të dobishme, duke zëvendësuar materialet e tjera të cilat përndryshe do të duhej të përdoreshin për të plotësuar një funksion të caktuar, apo përgatitja e mbeturinës për të plotësuar ato funksione në ndonjë impiant apo në ekonominë e gjerë.

**Person** – person fizik ose juridik i cili është i involvuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi në proceset për menaxhimin e mbeturinave.

**Prodhuesi mbeturinës** – çdo person, veprimtaria e të cilit krijon /prodhon mbeturinë ose çdonjëri që merret me para-procesim, përzierje apo operime të tjera që rezultojnë në ndryshimin e natyrës apo përbërjen e mbeturinës.

**Riciklim** – çdo operim I përpunimit nga i cili materialet mbeturinë janë rikthyer në produkte, materiale, substance, qoftë si origjinale apo për qëllime tjera. Kjo përfshin rikthimin e materialeve organike, por nuk përfshin përfitimin e energjisë dhe ripërpunimin në materiale që përdoren si karburante apo për operimet e mbulimit të mbeturinave.

**Ri-përdorim** – çfarëdo operimi me të cilin çdo produkt apo komponent, i cili nuk është mbeturinë, përdoret përsëri për të njëjtin qëllim për të cilin është destinuar.

**Stabilizim i mbeturinës** – çdo trajtim i mbeturinës me metodën e caktuar me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

**Zotëruesi mbeturinës** – prodhuesi i mbeturinës apo personi që e posedon mbeturinë.

# 1. HYRJE DHE KONTEKSTI I PLANIT

## 1.1 Hartimi i planit komunal për menaxhim të mbeturinave

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 13 pt, Not Bold, Albanian

Formatted: Albanian

Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave (PKMM) është një dokument planifikimi strategjik, i cili mundëson zbatimin e politikave kombëtare të mbeturinave duke i harmonizuar me politikën në nivel qëndror dhe atë lokal për menaxhimin e mbeturinave komunale.
PKMM mundëson orientimin strategjik për të ardhmen e sektorit për menaxhim të mbeturinave për Komunën e Vuhstrrisë si dhe njëkohësisht krijon një qëndrim të përbashkët midis akterëve të ndryshëm në nivel lokal. Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave PKMM-ja paraqet dokumentin bazë me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës.

Qëllimi i PKMM është parashtrimi i qartë i politikave të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal, duke harmonizuar interesat e të gjithë akterëve dhe publikut, të cilit ky shërbim i ofrohet për të siguruar një menaxhim më efikas dhe të qëndrueshëm, ku do të krahasohen dhe vlerësohen të gjitha opsionet e mundshme, duke përfshirë impiantet e përshtatshme për trajtimin e mbeturinave sipas llojeve.
Më konkretisht, ky plan ka si qëllim të mundësoj dhe siguroj si më poshtë:

- Përputhshmëri me Strategjinë e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM) dhe objektivat e saj: duke kontribuar në zbatimin e politikave dhe arritjen e objektivave kombëtare të paracaktuara në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
- Identifikimin e prioriteteve në sektorin e menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë aktorët e mundshëm për përcak- timin e këtyre veprimeve dhe krijimin e strategjive për zbatimin e tyre në mënyrë efektive, të ndërthurura sipas një Plan Veprimi.
- Opsionet më të mira për menaxhimin e mbeturinave: për të mundësuar grumbullimin dhe trajtimin e mbeturinave në përputhje me objektivat kombëtare. Plani identifikon fushat dhe teknologjitë e duhura për minimizimin dhe depozitimin (asgjësimin) final të mbeturinave;
- Instrumente institucionale, organizative dhe rregullore: mundëson paraqitje të plotë të kuadrit institucional, organizativ dhe rregullator dhe rekomandon masat për përmirësimin e elementëve përbërës të tij, duke përfshirë ato që kontrollojnë mbeturinat në të gjithë sistemin e menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë me standartet e menaxhimit të tyre
- Nevojat financiare për investime: duke përshkruar dhe argumentuar nevojat financiare dhe nevojën për investime për zbatimin e skemave të grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave;
- Burime financiare për investime: duke krijuar një klimë të favorshme për sigurimin e fondeve qeveritare për mbeturina sikurse dhe fonde nga institucione ndërkombëtare.

Zhvillojë bashkëpunimin me shoqërinë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të organizataje joqeveritare, biznesin, expertizë të jashtme, duke shpjeguar teknikat specifike që institucionet lokale mund të përdorin, të rrisin pjesëmarrjen dhe kontributin e publikut në proces dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesuara dhe organizatave.

## 1.2 Metodologjia

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit në hartimin e planeve komunale për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave, Komuna Vushtrrisë në partneritet me Green Art Center-Prishtina dhe përmes asistencës teknike të expertizës së angazhuar prej Institutit për Zhvillim Të Qëndrueshëm (ISD), u mundësua hartimi i Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave për Komunën e Vushtrrisë.
Në fazën e parë u themelua grupi i punës me përfaqësues nga zyrtarë të komunës dhe përfaqësues të Green Art Center – Prishtina (GAC). GAC si bashkëpunëtor me Komunën e Vushtrrisë ishte pjesë e zhvillimit të PKMM që në fillimet e tij duke rishikuar dhe përzgjedhur opsionet që i përshtaten më shumë politikave të Komunës. Çdo etapë e këtij plani, duke përfshirë prioritetet e komunës, vizionin, objektivat, opsionet, investimet dhe afatet kohore u diskutuan dhe u ranë dakort gjatë takimeve të grupit të punës si edhe janë bazuar dhe harmonizuar me prioritetet e Komunës në Kuadër të planit për menaxhim të mbeturinave komunal.

Konkretisht të shprehura në mënyrë të listuar hapat bazë të ndjekura në proçesin e planifikimit të menaxhimit të mbeturinave janë si mëposhtë:

Hapi 1. Krijimi i strukturave organizative
Hapi 2. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese
Hapi 3. Planifikimi operacional i menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave
Hapi 4. Planifikimi financiar për menaxhimi të qëndrueshëm të mbeturinave
Hapi 5. Konsultimet për zbatueshmërinë e planit me përfaqësuesit kryesorë të komunës.

Procesi i konsultimit ka parashtruar nevojat në sektorin e menaxhimit të mbeturinave që i nevojiten komunës, duke ofruar mundësi për komente apo diskutime të ndryshme. Përfaqësuesit e Komunës së Vushtrrisë kanë asistuar gjatë lëvizjeve në terren si edhe kanë dhënë asistencën e tyre në lidhje me identifikimin e gjendjes ekzistuese të ofrimit të shërbimit në gjithë territorin e komunës përmes ofrimit të të dhënave për analizim të detajuar gjatë përgatitjes së planit.

# 2. POLITIKAT, STRATEGJIA DHE KORNIZA LIGJORE KOMBËTARE

## 2.1 Baza ligjore dhe instrumentet juridik për menaxhim të mbeturinave

Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave (SRKMM 2013 – 2022) dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturina (PRKMM 2013-2017 referuar faës së parë sipas SRKMM) ka përcaktuar drejtimin e politikës së Qeverisë së Kosovës për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave deri në 2022, duke synuar minimizimin e mbeturinave që në burim si dhe zvogëlimin e rrezikshmërisë prej tyre, të zbatohet riciklimi dhe trajtimi (mekanik, biologjik, energjetik) deri te ripërdorimi dhe shfrytëzimi i mbeturinave. Me këtë strategji dhe planin e veprimit për mbeturina, synohet të përmirësohet gjendja aktuale e menaxhimit të mbeturinave duke ndërtuar konceptin e drejtë dhe modern për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

Kjo strategji është krijuar duke u mbështetur në angazhimin financiar të Qeverisë së Kosovës për të përmirësuar sektorin e mbeturinave në lidhje zbatimin e politikave për reduktimin e mbeturinave, riciklimin, kompostimin apo përpunimin e tyre për përfitim energjie. Në kuadër të Strategjigjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave janë vendosur objektiva, të cilët synojnë përmirësimin e mënyrës së menaxhimit të mbeturinave në Kosovë. Realizimi i synimeve dhe prioriteteve sipas kësaj strategjie janë përmbledhur sipas këtyre objektivave:

Objektivi 1: Masat e përgjithshme për forcimin e sistemit për menaxhimin dhe monitorimin e mbeturinave;
Objektivi 2: Investimi në zonat me probleme kritike dhe në infrastrukturën për mbeturina;
Objektivi 3: Rritja e shkallës së vetëdijësimit, ndërgjegjësimit dhe informimit

Strategjia Kombëtare e Mbeturinave përshkruan mekanizmat kyç për investimet në sektorin e mbeturinave dhe ka parashikuar nevojat për financim sipas dy fazave. Sipas planifikimeve të nivelit qëndror, në mënyrë që të arrihet përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian në fushën e mbeturinave, është llogaritur që një kosto investimesh prej 133.85 milion euro ku tregohet se jo më shumë së gjysma e fondeve të përgjithshme do të sigurohen nga të ardhurat publike, përderisa pjesa tjetër do të sigurohet nga burime tjera. Në mënyrë që të mirë menaxhohen mbeturinat në nivel nacional, vendi është ndarë në nivel strategjik në 7 regjione bazuar në kufijtë gjeografikë sipas regjioneve aktuale. Këto njësi janë parë si strukturë bazë, por nuk përjashtohet mundësia e bashkimit apo bashkëpunimit midis këtyre zonave për të përfituar nga ekonomia e shkallës (referuar LIGJI NR. 04/L-060 Për Mbeturina). Në vazhdim, çështjet e këtyre regjioneve të mbeturinave do të menaxhohen nga një strukturë apo grup i zonës së mbeturinave që përbëhet nga partnerë mjedisorë rajonal dhe lokalë.

Plani Kombëtar i Mbeturinave ka përmbledhur dhe sygjeruar disa masa dhe veprime për mirë menaxhimin e mbeturinave komunale dhe rrymave tjera (referuar vetëm planit për fazën e parë të SRKMM në planin kohor 2013-2017), nga teknologjitë e trajtimit të mbeturinave deri tek minimizimi dhe riciklimi e tyre.

## 2.2 Principet e menaxhimit të mbeturinave

Direktivat e BE-së dhe dokumentat strategjik, rekomandojnë që të gjithë planet në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal duhet të bazohen në parimet e përgjithshme të paraqitur më poshtë:




*Figure 1. Hierarkia e menaxhimit të mbeturinave*

- *Hierarkia e mbeturinave:* Hierarkia e mbeturinave përfaqëson një nga parimet kryesore udhëzuese në menaxhimin e mbeturinave në BE. Hierarkia përshkruan një set të metodave prioritare në menaxhimin e mbeturinave duke vendosur "parandalimin dhe ripërdorimin" në majë dhe depozitimin si alternativën më pak të favorshme.

- *Parimi reduktues:* Të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore, duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur gjenerimin e mbeturinave. Qëllimi kryesor në reduktimin e mbeturinave qëndron në domosdoshmërinë e ndërprerjes së lidhjes midis rritjes ekonomike dhe gjenerimit të tyre.
- *Parimi parandalues:* Të sigurojë reduktimin e impakteve nga mbeturinat në shëndetin e njerëzve dhe të mjedisit, veçanërisht të reduktojë substancat e rrezikshme tek mbeturinat.Ky parim mundëson vënien në lëvizje të mekanizmave institucional dhe kontrollues të cilët nëpërmjet monitorimeve të vazhdueshme arrijnë të adresojnë potencialet që vijnë nga mbeturinat e rrezikshme si edhe gjenerimin e tepruar të mbeturinave urbane.

- *Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë:* Parimi i afërsisë dhe vetëmjaftueshmërisë kërkon që Mbeturinat të menaxhohen më afër vendit ku prodhohet. Politika e BE-së rekomandon që shtetet anëtare të merren vetë me Mbeturinat e tyre, duke shmangur eksportin në vende të tjera.

- *Parimi i përgjegjësisë së prodhuesit apo ndotësit:* Prodhuesit, nga prodhimtaria e të cilëve krijohet mbeturina janë përgjegjës për zgjedhjen e teknikave më të përshtatshme dhe më të pranueshme për mjedisin. Prodhuesit e mbeturinave janë të detyruar të bartin koston e të gjitha masave parandaluese për ndotjen e mjedisit, trajtimin dhe asgjësimin e mbeturinave. Sipas parimit "Ndotësi paguan": Ata që ndotin mjedisin duhet të bartin koston totale të menaxhimit të mbeturinave, duke përfshirë për koston e masat parandaluese dhe eliminimin e dëmit të shkaktuar nga aktivitetet e tyre.

## 2.3 Kuadri ligjor në Kosovë mbi mbeturinat

Qeveria e Kosovës është e angazhuar në procesin e anëtarësimit në BE dhe për këtë qëllim Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit është duke punuar drejt përafrimit dhe adoptimit të legjislacionit të shtetit të Kosovës në përputhje me instrumentet legjislativë të BE-së.

Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë është pjesërisht e harmonizuar me Acquis të Bashkimit Europian (BE) për sektorin e mbeturinave. Aktualisht, Ministria e Ekonomisë dhe Ambjentit (MEA) është duke bërë përpjekje për harmonizim të plotë, ku qëllimi kryesor i kornizës aktuale ligjore për menaxhimin e mbeturinave është shmangja dhe reduktimi i gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i

elementeve të ripërdorshme të mbeturinave, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut; si dhe përfundimisht deponimi i mbeturinave në mënyrë miqësore ndaj mjedisit.

Ligji kryesor që rregullon sektorin e mbeturinave në Kosovë është Ligji nr. 04/L-060 për mbeturinat ("Ligji për mbeturinat"). Ky ligj është veçanërisht i rëndësishëm kur shpjegohet rregullimi i sektorit të mbeturinave në Kosovë në raport me ligjet e tjera, veçanërisht ato që adresojnë krijimin, menaxhimin dhe udhëheqjen e ndërmarrjeve publike (p.sh.harmonizimi me: Ligji për Ndërmarrjet Publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare).
Ligje të tjera që në një farë mënyre ndikojnë në rregullimin e sektorit të mbeturinave përfshijnë:

1. Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Ligji për Vetëqeverisjen Lokale");
2. Ligji Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar nga ligjet që ndryshojnë Ligjin për Ndërmarrjet Publike Ligji nr. 05/L-009 dhe Nr. 04/L-111 ("Ligji për NP");
3. Ligji Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, i ndryshuar dhe plotësuar nga Ligji Nr. 04/L-006 ("LSHT");
4. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar nga ligjet që ndryshojnë dhe plotësojnë Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës nr. 04/L-237 i vitit 2014, 05/L-068 i vitit 2016 dhe nr. 05/L-092 i vitit 2016 ("Ligji për PP");
5. Ligji Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko-Privat ("Ligji për PPP");
6. Ligji Nr. 04/L-024 për Ndihmën Shtetërore ("Ligji për Ndihmën Shtetërore");
7. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit ("Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit");
8. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinorë ("Ligji për Planifikim Hapësinorë");
9. Ligjet tjera që kanë ndikim të kufizuar në rregulloren e menaxhimit të mbeturinave përfshijnë:

Ligji për Ndërtim, Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Ligji mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligji për Ujëra, Ligji për Kimikatet, Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Ndotjes, Ligji për Produktet Biocide, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Veprimtarinë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjellësit, Kanalizimeve dhe Mbeturinave. Komponentët kryesorë të këtyre mbeturinave janë: guri, betoni, tulla, komponentë hekuri, komponentë plumbi, komponentë elektrik, etj.

## 2.4 Rolet dhe përgjegjësitë

Bazuar në politikën kombëtare për mbeturina, Pas miratimit të Ligjit për Mbeturinat, komunat kanë marrë përgjegjësi shtesë lidhur me menaxhimin dhe administrimin e mbeturinave, duke përfshirë obligime shtesë në lidhje me mbledhjen e tarifës së mbeturinave si dhe përzgjedhjen e modelit të operatorit në pajtim me Ligjin. Përveç kësaj, Ligji për Vetëqeverisjen Lokale përcaktoi menaxhimin e mbeturinave si kompetencë e plotë dhe ekskluzive e komunave. Bazuar në këto kompetenca, komunat kanë autorizimin ligjor për krijimin e strukturave, mekanizmave si dhe për parashikimin e një buxheti të ndarë për menaxhimin më të mirë dhe më efikas të sektorit të mbeturinave brënda territoreve të tyre administrative.

### 2.4.1 Pushteti lokal

Pushteti lokal, ose organi ekzekutiv në nivel lokal (Komuna), është përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikës lokale për menaxhimin e mbeturinave, e cila duhet të jetë në harmoni me Strategjinë Kombëtare dhe Planin Kombëtar të Menaxhimit të Mbeturinave. Konkretisht ato janë përgjegjëse për:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

### 2.4.2 Kompanitë rajonale/komunale të menaxhimit të mbeturinave

Në përgjithësi edhe pse dispozitat e Ligjit për Mbeturinat parashohin bazë ligjore për liberalizimin e sektorit të mbeturinave duke hapur tregun për operatorët privat në menaxhimin e mbeturinave, ende ky shërbim ofrohet prej ndërmarrjeve publike që operojnë dhe ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave për komunat. Të themeluara si Ndërmarrje Publike në bazë të Ligjit për NP-të dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, këto kompani kanë si aktivitet kryesor realizimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe bartjen e mbeturinave të grumbulluara në deponitë sanitare. Konkretisht, në Kosovë janë të regjistruara dhe veprojnë 8 Kompani publike që mbulojnë rajonë të caktuara administrative me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Kompanitë e tilla janë të regjistruara dhe veprojnë si Shoqëri Aksionare, ku një komunë e caktuar ose një numër komunash i zotërojnë aksionet në këto kompani. Këto kompani janë kompani publike përgjegjëse për kryerjen e shërbimeve të grumbullimit, bartjen nga vendbanimet dhe deri tek deponitë e mbeturinave. Kompanitë rajonale publike e ofrojnë shërbimin për disa komuna në një rajon të caktuar dhe komunat që mundësohen me shërbim nga këto kompani kanë përfaqësuesin e tyre në bordin e kompanisë.

Roli dhe përgjegjësia e këtyre kompanive është po aq e rëndësishme bazuar në kuadrin ligjor për mbeturinat dhe detyrimet për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave, marrin parasysh që detyrimet brënda kompanive të Komunave si aksionarë të këtyre kompanive.

### 2.4.3 Kompanitë e tjera

Kompanitë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK). Këto kompani janë kompani shtetërore dhe janë përgjegjëse për menaxhimin e deponive regjionale të mbeturinave të komunave.

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH. A.), është kompani e licencuar për menaxhimin e deponive sanitare regjionale të mbeturinave Komunale në Republikën e Kosovës, e koorporatizuar dhe e regjistruar si Shoqëri Aksionare konform Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare.

Kompanitë e licensuara, apo sektori privat, janë kompani të cilat licensohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ofrojnë shërbimet për grumbullimin, trajtimin, riciklimin, transportimin dhe deponimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave.

# 3. ASPEKTI INSTITUCIONAL

## 3.1 Organizimi në nivel qendror

Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organi legjislativ i vendit, është përgjegjës për pjesën e miratimit të ligjeve, në këtë rast në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe në monitorimin e zbatimit të tyre nga komisionet ligjore të formuara. Më konkretisht ai është përgjegjës për: 1) miratimin e ligjit për mjedisin, ligjit për mbeturinat dhe kuadrin ligjor relevant për fushën përkatëse; 2) nxjerrjen e strategjive për mbrojtjen e mjedisit; 3) dhënien e rekomandimeve dhe monitorimin e zbatimit të ligjeve nga komisionet e kuvendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, është organi përgjegjës për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave si dhe për nxjerrjen e udhëzimeve administrative qeveritare.
Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit (MEA) është organi, i cili propozon, harton dhe mbikqyrë zbatimin e kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të mbetjeve. Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit pranë kësaj ministrie, është organi përgjegjës për aspektet e politikës kombëtare dhe kuadrit ligjor dhe rregullator për menaxhimin e mbeturinave. Konkretisht detyrat e këtij deparatmenti janë:

- Propozon, harton dhe siguron bazën për krijimin e politikave për mbrojtjen e mjedisit;
- Harton dokumente Strategjike dhe legjislacionin për fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Propozon masa dhe projekte për rehabilitimin e zonave të “nxehta”;
- Përcakton dhe propozon investimet dhe financimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
- Kryen aktivitete administrative dhe profesionale për anëtarësim në Konventa, Traktate, Marrëveshje dhe Organizata ndërkombëtare, për mbrojtjen e mjedisit;
- Ofron mbështetje profesionale, për çështjet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e burimeve natyrore;
- Shqyrton dhe përgatit propozim vendim për kërkesat e palëve, për çështje të ndryshme mjedisore;
- Përgatit raporte të ndryshme për çështje mjedisore.

Ky departament në strukturën e tij ka katër divizione në varësi të tij: 1) Divizioni për Edukimin dhe Ndërgjegjësimin Mjedisor; 2) Divizioni për Mbrojtjen nga Ndotja Industriale; 3) Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate; Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Divizioni i cili është drejtëpërdrejtë përgjegjës për sektorin e mbeturinave është Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate.
Ky divizion ndër detyrat dhe përgjegjësitë më të rëndësishme ka:

- Hartimin e Strategjisë për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plan Veprimin për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Përgatitjen e programeve për monitorim dhe raportet për gjendjen ekzistuese të mbeturinave;
- Dhënien e licensave për menaxhimin e mbeturinave dhe dhënien e lejeve për eksport, import dhe tranzit të mbeturinave;
- Mbikqyrjen e zbatimit të kuadrit ligjor dhe menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme.

## 3.2 Organizimi i menaxhimit të mbeturinave në nivel komune

Bazuar në legjislacionin kombëtar, respektivisht LIGJI NR. 04 / L-060 Për Mbeturina, grumbullimi dhe trajtimi i mbeturinave dhe shërbimet e tjera të pastrimit i janë deleguar autoriteteve lokale, duke i bërë këto të fundit përgjegjëse për menaxhimin e tyre (Ligji nr. 03/l-040 “Për vetqeverisjen lokale“, 2008). Sipas Ligjit

për Mbeturina, autoritetet kompetente për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë janë Ministria dhe Komunat. Kompetencat e komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina përfshijnë:

- Krijimin e sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimin e planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave dhe krijimin e kushteve për zbatimin e tij;
- Përgjegjës për planin komunal për menaxhimin e mbeturinave dhe zbatimin e tij;
- Hartimin e raportit vjetor për menaxhimin e mbeturinave;
- Rregullimin e përgjegjësive dhe detyrimeve për kryerjen e shërbimeve për menaxhimin e mbeturinave, zbatimin e tyre, organizimin dhe menaxhimin e mbeturinave në territorin e tyre;
- Mirëmbajtjen dhe përkujdesjen për sistemin e informimit të publikut dhe raportimit për kryerjen e punëve të përcaktuara me këtë ligj, si dhe aktet tjera ligjore për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimin e procedurave të prokurimit, përzgjedhjen e personave të licencuar për mbledhjen, grumbullimin, magazinimin dhe transportin e mbeturinave: inerte, komunale, komerciale, të vëllimshme, dhe mbeturinat nga ndërtimet dhe demolimet e objekteve ndërtimore brënda territorit të tyre;
- Caktimin e tarifave dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale;
- Evidentimin e vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimin e projekteve për sanimin e tyre me shënimet për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve.

Përveç kësaj, në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat do të kenë kompetenca të plota dhe ekskluzive për ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike, duke përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimet dhe kanalizimet atmosferike, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugët lokale, transportin lokal dhe skemat e ngrohjes lokale. Në pajtim me Ligjin për Mbeturinat dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat nxjerrin akte nënligjore që rregullojnë.

Referuar ndarjes administrative-territoriale çdo lloj shërbimi që komuna ofron në territorin që administron dhe komunitetit banues planifikohen dhe financohen nga kjo komunë. Diagrami më poshtë ilustron strukturën e komunës në lidhje me organizimin e sektorit/departamentit për menaxhimin e mbeturinave:




Figure 222. Struktura organizative e Komunës së Vushtrrisë

Rolet dhe përgjegjësitë e organeve komunale në menaxhim të mbeturinave për komunën e Vushtrrisë janë të ndara sipas kompetencave dhe janë paraqitur si më poshtë:

- Komuna kontrakton operatorët (publik apo privat) për aktivitetet e Menaxhimit të Mbeturinave, duke u bazuar në ligjin përkatës.
- Drejtoria për Sherbime publike (DSHP) është përgjegjëse për menaxhimin e të gjitha punimeve në pronën publike dhe komunale, monitorimin e punëve të kompanive të angazhuara për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve dhe hapësirave tjera komunale.
- DSHP është përgjegjëse për caktimin e tarifave të shërbimeve te grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale nga ndërmarrjet për administrimin e mbeturinave
- Drejtoria e Financave është përgjegjës për propozimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale si dhe inkasimin e tyre.
- Drejtoria për Urbanizëm, është përgjegjëse për planifikimin e zhvillimit hapësinor dhe urbanistik të Komunës së Vushtrrisë, ndihmon në përgatitjen e rregullores lokale për kontroll të mbeturinave dhe hedhurinave brenda territorit të Komunës.
- Drejtoria për Punë Inspektuese, është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të rregulloreve komunale në lëmin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Mjedisit, Bujqësisë dhe Pylltarisë.
- Kompanija Regjionale “Uniteti” ofron shërbim sipas statutit të saj duke ushtruar kompetenca ekzekutive.

Në diagramin më poshtë ilustrohet struktura organizative në kompanine regjionale “Uniteti”, si operator publik komunal i cili është përgjegjës për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave komunale në komunën e Vushtrrisë.

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian




*Figure 3. Struktura organizative e KRM "UNITETI"*

Ndër të tjerash, ligji instrukton komunat të hartojnë dhe miratojnë kuadrin e nevojshëm rregullator lokal për mbeturina. Kuadri lokal përfshin rregulloret e ndryshme që përcaktojnë proceset e menaxhimit të mbeturinave, përshkruajnë indikatorët, specifikojnë kriteret dhe instruktojnë strukturat lokale në përmbushjen e detyrave dhe funksioneve si dhe në zgjidhjen e problemeve që mund të dalin në vijim. Kuadri rregullator lokal duhet të përfshijë:

• Rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave: është përgjegjësi e Komunës së Vushtrrisë të hartojë këtë rregullore e cila përcakton metodologjitë dhe rregullat për shërbimet e pastrimit të qytetit dhe menaxhimit të mbeturinave brënda territorit administrativ të ~~komunë;,~~komunës; të hartojë procedura për ankesat e banorëve, si dhe për aplikimin e sanksioneve. Rregullorja duhet të miratohet nga ~~Këshilli~~ Kuvendi Komunal.

• Rregulloren komunale për tarifat e mbeturinave: kjo rregullore ka për qëllim të krijojë një sistem efektiv për mbulimin e kostos së shërbimeve të manaxhimit të mbeturinave. Rregullorja e tarifave të mbeturinave përfaqëson një politikë komunale afatgjatë për mbulimin e kostos, nivelin e tarifave dhe sistemin e mbledhjes së tyre dhe vendos rregulla specifike për autoritetet lokale si dhe për komunitetin lokal dhe biznesin.

Komuna e Vushtrrisë posedon Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave (2016 - 2020) ku sipas këtij plani janë përcaktuar qëllimet dhe objektivat për menaxhimin e mbeturinave në komunë. Referuar objektivave të vendosura të komunës sipas PKMM, ato janë:

Qëllimi 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave

Qëllimi 2: Inicimi i procesit për ndarje të mbeturinave në burim duke synuar që të zvogëlohet sasia e mbeturinave që përfundojnë në deponi.

Qëllimi 3: Grumbullimi, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvogëlimit të sasisë që përfundon në deponi

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

Qëllimi 4: Reformat administrative

Qëllimi 5: Vetëdijësimi

Bazuar në objektivat e vendosura, një studim i detajuar i gjendjes mjedisore dhe sektorit të menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal adresojnë zhvillimin e programeve nxisin qëndrueshmërinë e sistemit primar të grumbulimit të mbeturinave dhe aplikimin e skemave për reduktim dhe ndarjen në burim për riciklim të tyre.

## 4. KONTEKSTI LOKAL, KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROFILI I KOMUNËS

## 4.1 Përshkrim i përgjithshëm i komunës

Komuna e Vushtrrisë gjendet në pjesën veriore të Kosovës. Komuna ka formë të zgjatur në drejtim të veriut (gjatësia max. afër 34 km) dhe është më tepër e zgjeruar në mes (gjerësia max. 23 km) dhe me një gjatësi të vijës kufitare prej afro 104,5 km.
Ka një pozitë të mirë gjeografike dhe kufizohet me pesë komuna të tjera: Komunën e Mitrovicës, të Skenderajt, Drenasit, Obiliqit dhe Besianës. Po ashtu, ka edhe një lidhje hekurudhore të rëndësishme me Fushë-Kosovën, si nyje hekurudhore dhe Mitrovicën. Territori i Komunës së Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 345 km² dhe zë një hapësirë rreth 3.5 % të territorit të Kosovës. Këtë sipërfaqe e përbën një reliev i ndryshëm, me terren malor, sipërfaqe fushore dhe të rrafshët me tokë pjellore. Pjesa qendrore shtrihet rreth lumit "Silnica" dhe lumit "Llap", ndërsa pjesët tjera të relievit në perëndim shkojnë duke u ngritur në kodra e lugina të malit Qyqavica dhe në lindje, po ashtu, në kodra e lugina të maleve të Shalës së Bajgorës.



*Figure 444. Harta e Pozitës gjeografike të Komunës së Vushtrrisë*

Komuna e Vushtrrisë ka një popullsi afërsisht 69 870 banorë (sipas të dhënave prej ASK-Agjensia e Statistikave të Kosovës)
Numri i ekonomive familjare raportohet të jetë 11 866 dhe në total në të gjithë territorin e komunës operojnë 1205 biznese dhe 164 institucione.

## 4.2 Vlerat natyrore dhe turistike

Rajoni ka potencial natyrorë dhe elemente shumë cilësore që ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit malorë, turizmit të gjuetisë, turizmit shëndetësorë dhe atij kulturorë. Sa i përket turizmit kulturorë Vushtrria me rrethinë, është lokalitet antikë në të cilin ndodhen disa objekte të kohës së vjetër të cilat me formën dhe përmbajtjen që kanë janë atraksion dhe i japin një dimension tjetër që ndikon në zhvillimin e turizmit. Malet

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

e Qyqavicës dhe të Shalës janë të njohura për bukuritë e tyre malore dhe ofrojnë mundësi të zhvillimit të turizmit malorë dhe dimërorë. Burimet termale dhe minerale po ashtu janë një potencial mjaft i mirë, për tu zhvilluar dhe do të mund të tërhiqnin numër të konsiderueshëm të vizitorëve. Gjithashtu ekzistojnë rezervatet për gjueti të cilat kanë pasur karakter ndërkombëtar, ku njerëzit të pasionuar me gjueti nga viset e ndryshme të Evropës i kanë vizituar këto treva, dhe në këtë mënyrë janë gjeneruar mjete të konsiderueshme. Momentalisht kjo lloj veprimtarie është e ndaluar, por shfrytëzohet vetëm nga banorët vendas të cilët në mënyrë ilegale marren me gjueti. Viset të cilat janë të njohura me potencial për gjueti janë: Akrashticë, Boshlan, Ceceli, Duboc, Kunovik, Kurillovë, Liqej-Jezerc, Ashlan, Pantinë, Samadrexhë, Sllakoc, Zhilivodë. Gjuetia duhet të kontrollohet në mënyrë të arsyeshme dhe institucionale, që njëherit i takon edhe shoqatës së gjuetarëve, e cila ekziston në komunën e Vushtrrisë.

## 4.3 Infrastruktura rrugore

Sipas informacioneve lokale, Komuna e Vushtrrisë ka gjithsej rreth 899 km, ku prej tyre 581.8 km shtruara dhe 317.2 km të pa-shtrura kryesisht në vendet rurale, ndërsa rrugët ndërkomunale të shtruara llogariten rreth 100 km.

## 4.4 Aspekti socio – ekonomik

Sipas të dhënave të Green Art Center – Prishtina përmes Software MYMAPS të vitit 2018, Vushtrria ka 15884 ekonomi familjare. Në tabelën në vijim jane paraqitur ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet në fshatrat e Vushtrrise.
Në tabelën më poshtë jepen të dhëna më të detajuara:

*Table ~~11~~1. Statistika për Komunën e Vushtrrisë*

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

| NJA | Nr.popullsisë sipas ASK | Nr. i Popullsisë Urbane | Nr. i Popullsë Rurale | Nr.Ek.familjare | Nr. B | Nr. Inst |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Total | 69,870 | 26,964 | 42,906 | 15,884 | 1205 | 164 |
| | | | | | | |

Formatted: Albanian

Shpërndarja e popullsise ne zonen urbane:

*Table 222. Shpërndarja e popullsise ne zonen urbane*

| | Ekonomite familjare rezidente në banime kolektive | Ekonomi Familjare rezidente ne Shtepi ne Zonen Qender | Ekonomi Familjare rezidente ne fshatra | Totali |
|---|---|---|---|---|
| | 1188 | 5048 | **9648** | **15884** |

| Lokacioni | Vushtrri_ZK | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Te dhena Kumulative / Gjendja me date | | | | | |
| Data | 06.01.2019 | | | | | |
| | Vushtrri_1 | Vushtrri_2 | Vushtrri_3 | Vushtrri_4 | Vushtrri_5 | Totali |
| 1. Në shërbim (ek.F) | 709 | 1469 | 824 | 1515 | 531 | 5048 |
| 2. Jashtë shërbimi (ek.F) | | | | | | 0 |
| 3. Jo rezident (nuk prodhon mbeturinë) | 115 | 314 | 105 | 376 | 64 | 974 |
| 4. Banime Kolektive në Shërbim | 44 | 3 | 32 | 1 | 4 | 84 |
| 5. Banime Kolektive Jo Rezident | 8 | | 18 | | 7 | 33 |
| 6. Në shërbim (Biznes) | 664 | 92 | 124 | 62 | 112 | 1054 |
| 7. Jashtë shërbimi (Biznes) | | | | 3 | | 3 |
| 8. Biznes Joaktiv | 188 | 65 | 77 | 46 | 103 | 479 |
| 9. Institucione në Shërbim | 22 | 4 | 13 | 2 | 6 | 47 |
| 10. Institucione Jashtë shërbimit | | | | | | 0 |
| 11. Grup i bizneseve (3 e me shumë) | 14 | | | | | 14 |
| Mbesin per identifikim edhe : | | | | | | 0 |
| Totali te IDENTIFIKUARA | 1765 | 1947 | 1197 | 2004 | 827 | 7740 |

*Table 333. Shpërndarja e popullsisë sipas Fshatrave*

| Nr. | Zona | Ek. F. Rezidente | Ek. F. Jo-rezidente | Biznese Aktive | Biznese jo-aktive | Institucione |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Akrashticë | 234 | 46 | | | 2 |
| 2 | Balincë | 66 | 7 | 1 | 1 | 1 |
| 3 | Banjskë | 247 | 52 | 4 | 1 | 5 |
| 4 | Beçiq | 33 | 27 | 1 | | 3 |
| 5 | Beçuk | 67 | 58 | 1 | | 2 |
| 6 | Begaj | 269 | 21 | 2 | 1 | |
| 7 | Bivolak | 115 | 50 | | | 1 |
| 8 | Boshlan | | 6 | | | |
| 9 | Brusnik | 83 | 11 | | | 1 |
| 10 | Bukosh | 243 | 21 | 3 | 1 | 4 |
| 11 | Ceceli | 61 | 31 | | | 3 |
| 12 | Dalak | 166 | 22 | 2 | | |
| 13 | Dobërlluk | 365 | 79 | 17 | 8 | 1 |
| 14 | Druar | 180 | 41 | 1 | 2 | 2 |
| 15 | Duboc | 73 | 55 | | | 2 |
| 16 | Dumnicë e Eperme | 30 | 38 | | | 1 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 17 | Dumnicë e Llugës | 129 | 20 | | 1 | 3 |
| 18 | Dumnicë e Poshtme | 243 | 42 | 7 | 2 | 2 |
| 19 | Galicë | 51 | 17 | | | 1 |
| 20 | Gllavatin | 81 | 14 | | | 3 |
| 21 | Gojbulë | 242 | 57 | 1 | 3 | 2 |
| 22 | Gracë | 213 | 11 | 8 | | 2 |
| 23 | Gumnishtë | 1 | 47 | | | |
| 24 | Hercegovë | 101 | 6 | | | |
| 25 | Karaqë | 23 | 15 | | | |
| 26 | Kollë | 84 | 25 | | | |
| 27 | Kunovikë | 1 | 3 | | | |
| 28 | Kurillovë | 2 | 9 | | 2 | 1 |
| 29 | Liqej | 72 | 4 | | | |
| 30 | Lumadh | 229 | 36 | 7 | 5 | 3 |
| 31 | Maxhunaj | 531 | 64 | 8 | 6 | 6 |
| 32 | Mihaliq | 285 | 19 | 2 | | |
| 33 | Miraqë | 1 | 4 | | | |
| 34 | Nedakovc | 53 | 9 | 3 | | |
| 35 | Novolan | 285 | 60 | 5 | | 3 |
| 36 | Oshlan | 116 | 16 | 1 | 1 | 1 |
| 37 | Pantinë | 314 | 52 | 2 | 1 | 5 |
| 38 | Pasomë | 140 | 26 | 2 | | 3 |
| 39 | Pestovë | 263 | 18 | 8 | 6 | 2 |
| 40 | Prelluzhë | 692 | 179 | 4 | 23 | 6 |
| 41 | Reznik | 266 | 75 | 3 | 3 | 2 |
| 42 | Ropicë | 144 | 12 | | | 1 |
| 43 | Samadrexhë | 297 | 47 | | 2 | 1 |
| 44 | Sfraçak i Poshtëm | 158 | 41 | 8 | 2 | 1 |
| 45 | Shalë | 85 | 30 | | 3 | 1 |
| 46 | Shlivovicë | 2 | 14 | | 1 | |
| 47 | Shtitaricë | 179 | 19 | 1 | | 2 |
| 48 | Skromë | 11 | 15 | 2 | | 3 |
| 49 | Sllakovcë | 41 | 12 | | 1 | |
| 50 | Sllatinë | 140 | 33 | | 1 | 1 |
| 51 | Smrekonicë | 384 | 59 | 3 | | 5 |
| 52 | Stanoc i Epërm | 559 | 51 | 21 | | 4 |
| 53 | Stanoc i Poshtëm | 365 | 63 | 19 | 13 | 2 |
| 54 | Stroc | 128 | 63 | 1 | | |
| 55 | Studime e Eperme | 62 | 18 | | | 2 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 56 | Studime e Poshtme | 169 | 34 | | | 2 |
| 57 | Taraxhë | 7 | 2 | | | |
| 58 | Tërllabuq | 10 | 17 | | | |
| 59 | Vermicë | 131 | 24 | | | 2 |
| 60 | Vesekovc | 2 | 10 | | | |
| 61 | Vilancë | 63 | 12 | 1 | | 1 |
| 62 | Zagorë | | 3 | | | |
| 63 | Zhilivodë | 61 | 48 | | | 1 |
| | Totali | 9648 | 2178 | 149 | 90 | 102 |

Gjatë viteve '70-të, pati disa lëvizje pozitive për sa i përket zhvillimit ekonomik, kur u ngritën disa kapacitete industriale, siç ishin: fabrika e llamarinës së zinkuar, fabrika e konfeksionit, ajo e bojërave dhe ilaçeve, etj. Në këtë periudhë funksiononin edhe tri ndërmarrje publike, si dhe një ndërtimore. Gjatë kësaj periudhe u vu në funksion edhe sistemi i ujitjes, i cili ishte përparësi e madhe për fermerët lokal. Më 1976 u aplikua masa e grupëzimit të tokave, që intensifikoi zhvillimin e bujqësisë së kësaj treve.
Ekonomia e Vushtrrisë u riaktivizua pas luftës, por në shkallë shumë të ulët. Sektori privat është bartësi kryesor i zhvillimit ekonomik. Gjithsej biznese të regjistruara në komunë janë 1739, ku dominojnë ndërmarrjet tregtare.
Numri i NVM-ve është në rritje, kryesisht mbi bazë të shfrytëzimit të mjeteve private të sipërmarrësve.
Tradicionalisht, sektorët më të zhvilluar janë: bujqësia (ekstensive), zejtaria,industria e tekstilit dhe përpunuese..

### 4.4.1 Industria

Industria pas konfliktit të fundit ka shënuar rënie të dukshme dhe kapacitetet e saj funksionojnë vetëm në masën 20%. Sektori i shërbimeve kryesisht përfaqësohet me dyqanet për riparimin e automjeteve, sallonet e bukurisë dhe rrobaqepësisë dhe me disa ndërmarrje ndërtimore. Këto shërbime mbulohen 85% nga sektori privat, ndërsa shërbimet publike dhe industriale ofrohen nga ndërmarrjet publike komunale, që janë në pronësi të shtetit dhe të cilat nuk arrijnë të plotësojnë më shumë se 50% të nevojave.

Vushtrria ka 3 fabrika të rëndësishme si: “Llamkos”, “Ekstra”, dhe “Vushteks”, të cilat janë në funksion me perjashtim te “vushteks” e cila ka nderruar veprimtarine pas privatizimit, e poashtu “Llamkos” eshte rpivatizuar me spinof special 2 apo 3 hera por per momentin eshte jashta prodhimit. “Llamkos” pret privatizimin, si edhe shumë objekte të tjëra në mbarë Kosovën. Xehetaria në këto anë ka gjurmë qe nga Dardania antike, ajo është e shprehur në lokalitetet Gjytet dhe Galicë (jometalet dhe magnezet). Në rrethinën e Vushtrrisë, në largësi prej 4 – 5 km në sipërfaqe prej 6 km², terreni përmban minerale “Tufi”, çka tregon që në bazë hulumtimeve gjeologjike është konstatuar se ky mineral në këtë regjion paraqitet në shumë lloje dhe mund të shfrytëzohet për prodhimin e çimentos.

## 4.5 Gjendja e përgjithshme mjedisore

Gjendja e përgjithshme mjedisore në Kosovë është jo e mirë si pasojë e ndërtimeve shpeshherë pa plan urbanistik, ndotjes nga trafiku, menaxhimi jo përkatës i mbeturinave dhe ujërave të zeza dhe aktivitetet ekonomike dhe industriale që krijojnë ndotje në mjedis. Problemet serioze mjedisore lidhen me shfrytëzimin

jo racional të burimeve natyrore të cilat pastaj shkaktojnë ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, prishin pejsazhin, kërcënojnë biodiversitetin dhe burimet natyrore.

Përkundër progresit të konsiderueshëm që është bërë në vitet e fundit si rezultat i shumë iniciativave dhe përmirësimeve, dëmtimet dhe degradimi i burimeve natyrore (pyjet, tokat bujqësore dhe ato pyjore, burimet ujore, flora dhe fauna) vazhdon.

Territori i Komunës ju nënshtrohet ndikimeve klimatike nga pellgu i Silnicës dhe ai i Ibrit. Ka mikroklimë me specifikat e veta në të cilën kanë ndikuar proceset kimiko-teknologjike, si rrjedhojë e zhvillimeve nga industria energjetike (KEK) ne jug dhe industria e rend metalurgjike (Trepça) ne veri. Territori ka një shkallë të lartë të lagështisë relative që varion nga 95 % - 47 %, përderisa kufijtë normal zakonisht janë prej 45-56 %.

Temperatura e ajrit është e ndryshueshme, ku vlera mesatare vjetore është 10.2°C, nga që muaji më i ftohët është Janari me -1.5°C, përderisa muaji më i nxehtë është Gushti me temperaturë mesatare vjetore në 20.5°C. Amplituda vjetore e temperaturës së ajrit është 21.9°C, ku me vlerat ekstreme dhe me elementet tjera krijojnë klimën e regjimit kalimtar në mes të klimës mesatare kontinentale të ashpër malore, kur vjeshta është më e nxehtë se pranvera për 1.5°C.

Në regjimin e reshjeve atmosferike të territorit dhe rrethinës, ndikim parësorë kanë aktivitetet ciklonike me prejardhje të ndryshme të cilat manifestohen gjatë rrugëtimit të masave ajrore me shkallë të lartë të lagështisë dhe të ftohta nga Atlantiku, ndërsa ato të nxehtat nga Jugu.
Në bujqësi, shumica e tokave janë të pjerrëta, nga të cilat shumë janë të zhveshura, kurse të tjerat shfrytëzohen për kullota dhe prodhimtari bujqësore. Vushtrria është prodhuesi më i madh i patates në Kosovë. Është në fazën përfundimtare vendosja e pajisjeve në fabrikën e re (të parë) të përpunimit të patates, e cila fillon me prodhim në fillim të muajit shkurt. Vushtrria posedon një tokë tejet cilësore, me rreth 15.879 ha, nga të cilët rreth 7000 ha janë nën sistemin e ujitjes.
Blegtoria dhe pemtaria janë degë të rëndësishme të zhvillimit ekonomik të komunës së Vushtrrisë, e cila, siq dihet ka një potencial dhe resurse të pasura me tokë. Vushtrria ka 16.954 hektarë toke bujqësore dhe 13.664 hektarë me pyje që e bëjnë atë të ketë potencial të madh të zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë. Rreth 7 mijë hektarë tokë bujqësore në komunën e Vushtrrisë ujiten nga sistemi "Ibër-Lepenci", por sipërfaqja e tokës që mund të ujitet nga ky sistem mund të rritet, pasi që është duke shkuar rivitalizimi i rrjetit dhe i sistemit të ujitjes.
Aktualisht kopshte të pemtarisë intensive në komunën e Vushtrrisë ka rreth 30 hektarë sipërfaqe, por ka rritje të vazhdueshme të sipërfaqeve.

# 5. KONTEKSTI LOKAL I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

## 5.1 Situata aktuale e shërbimi të grumbullimit të mbeturinave në komunë

Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në komunën e Vushtrrisë ofrohet në tërë teritorin e komunës. Kompania publike “Uniteti” deklaron që ofron shërbimin për 100% të popullsisë sipas

ekonomive familjare bazuar në të dhëna të regjistruar nga vet kompania në teren. Kjo kompani kryen faturimin dhe inkasimin e të hyrave nga tarifat e pastrimit nga, bizneset dhe institucioneve publike ndërsa komuna kryen inkasimin për amvisërit.

Nga të dhënat e mundësuara nga kompania publike dhe komuna, për vitin 2020 nga KRM Uniteti kryhet shërbim në 17.203 ekonomi familjare, biznese dhe institucione.
Gjithashtu shërbimi i grumbullimit të mbeturinave kryhet në të gjitha bisneset aktive dhe institucionet në tërësi territoriale.

*Table 444. Numri i klienteve në faturim (referuar të dhënave të ASK dhe të paraqitura nga KRU "Uniteti")*

| Komuna | Klientë gjithsej në zonën kadastrale | | | | Klientë të faturuar = shërbyer | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti/Fshat | *Ekonomi familjare* | *Biznese* | Institucione | Gjithësej | *Ekonomi familjare* | *Biznese* | Institucione | Gjithësej |
| Vushtrria | 15107 plus 1072 diaspore | 1205 | 164 | 17548 | 15107 plus 1072 diaspore | 860 | 164 | 17203 |

Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian

Kompania e cila është e licencuar për administrimin e mbeturinave dhe punon në bazë të rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina e miratuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2014. Si kompani publike punon sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit Nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregëtare.
Aspektet operacionale të menaxhimit të mbeturinave në Vushtrri udhëheqen nga KRU "Uniteti". Për të cilën aksionare me 23% është Komuna. KRU "Uniteti" është kompani publike, e cila operon me vetëfinancim. Kompania shërben tri kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët e ekonomive familjare, bizneset dhe instiucionet. Po ashtu kompania ofron shërbim në grumbullim të mbeturinave derë më derë. Kjo kompani shërbimin e saj e zhvillon duke u bazuar në Dy aktiviteteve: primar (grumbullimi dhe depozitimi I mbeturinave) dhe sekondar (me kontrata të veçanta si larje fshirje, mirëmbajtje hapësirash të gjelbra etj).

Kompania nuk e bën grumbullimin e mbeturinave të ngurta ndërtimore si dhe mbeturinat të hekurit, ndersa mbetjet shtazore grumbullohen me kërkesë nga Komuna dhe me procedurë dhe kontrata të vecanta dhe gjatë groposjes ato dezinfektohen përmes gëlqerosjes.
Aktivitetet e saj, kompania i realizon përmes departamenteve operative dhe shërbimit për konsumatorë, të cilat përbëjnë tërësinë e ndërmarrjes.

Lidhur me krahasimin e të dhënave dhe raporteve mbulueshmëria e territorit të Komunës së Vushtrrisë me ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave është 100%, zvogëlimin e shkallës së hedhjes ilegale në 90% (referuar raporteve të deponive ilegale sipas krahasimit të viteve referente 2019 dhe 2018). Referuar PKMM këto të dhëna do të përkojnë me përmbushjen e Qëllimit 1: Rritja e qëndrueshmërisë së sistemit të grumbullimit të mbeturinave; Qëllimi 4: Reformat administrative(50%); Qëllimi 5: Vetëdijësimi (80% shërbimin primar të grumbullimit).

## 5.2 Mbuleshmëria me shërbimin e menaxhimit të mbeturinave

Formatted: Albanian

Shërbimi në Komunën e Vushtrrisë është i ndarë në tri kategori (A, B dhe C). Kategoria A karakterizohet nga grumbullimi kolektiv (zona qendrër e qytetit), ndërsa kategoria B karakterizohet në grumbullim derë më

derë në zonat urbane dhe rurale. Në kategorinën C ka edhe disa zona ku shërbimi ofrohet në sajë të kontratave që nënshkruhen prej bizneseve apo institucioneve me Kompanin ”Uniteti”.
Përsa i përket zonës Qendër në banimet kolektive shërbimi bëhet një herë gjatë 24 orëve në 5 ditë të javës. Sa I përket zonën rurale automjetet e grumbullimit gjatë ditëve te punes do të kenë në shërbim te gjitha fshatrat e Vushtrrisë dhe shërbimi do të bëhet gjatë 5 diteve te pune nga e hëna deri të premten.
Në tabelën më poshtë tregohet se si janë të shpërndarë në territorin e komunës sistemet e grumbullimit të mbeturinave referuar kapacitetit teknik dhe zonave të grumbullimit:

*Table 555. Itinerari i grumbullimit te mbeturinave në fshatra*

| E Hene | E Marte | E Merkure | E Enjte | E Premte |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| Sllatine | Karaqa | Akrashtice | Maxhunaj | Balinc |
| Smrekonice | Svaraqak i Eperm | Shtitarice | Dumnic e Eperme | Liqej |
| Doberlluke | Svaraqak i Ulët | Druar | Dumnic e Mesme | Vernic |
| Pasome | Pantin | Shallc | Dumnic e Ulet | Resnik |
| Tërllabuq | Oshlan | Koll | Studime e Eperme | Bukosh |
| Banjske | Mihaliq | Prelluzh | Studime e Ult | Stanovc I Eperm |
| Gojbule | Bequk | Zhilivod | Stanovc I eperm | Stanovc I Ult |
| Strovc | Nadakovc | Bivolak | Grac | Lumi I Madh |
| Galic | Gllavoti | | Sllakovc | Bruznik |
| Beqiq | | | Ceceli | Taragj |
| Dubovc | | | Ropic | Pestov |
| | | | Vilanc | Dolak |
| | | | Samadrexh | Novolan |
| | | | | Bukosh |

Sipas të dhënave të ofruara, shërbimi ofrohet për 15.870 ekonomi familjare rezidente apo jorezidente (përfshirë mërgimtarë), për 1205 bisnese active dhe joaktive dhe 164 institucione në komunë. Sasia vjetore e grumbulluar e mbeturinave llogaritet të ketë qenë (viti 2019) rreth 220513 ton mbeturinë ne vit.

## 5.3 Forma e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave urbane

Shërbimi i mbledhjes dhe grumbullimit të mbeturinave konsiston në mbledhjen e mbeturinave urbane të depozituara nga qytetarët, bizneset dhe institucionet brënda kontenierëve publikë dhe atyre individualë si dhe rreth tyre, dezifektimi i kontenierëve dhe vendit përreth, transportimi i mbeturinave urbane me makinën teknologjike deri në pikën përfundimtare të depozitimit.
Ky shërbim që ofrohet gjatë gjithë vitit përfshin gjithë zonën e administrimit komunal (100%).

Sistemi aktual i pikave të grumbullimit mbeturinave (PGM) përbëhet nga kontenierë metalik me rrota me volum 1.1m³, të pozicionuar në anë të rrugëve në pika të përbashkëta publike të miratuara paraprakisht nga autoritet komunale sipas planit për riorganizimin e zonës qendër në komunën e Vushtrrisë. Largësitë mesatare midis PGM variojnë sipas dendësise së popullsise me frekuencë 100-150 m distancë, në zonën e

qëndrës ku është e përqendruar pjesa më e madhe e bizneseve, institucioneve dhe banorëve si dhe zonat e tjera të qytetit të Vushtrrisë, në 200-400ml.

## 5.4 Orari i operimit (referent 2019-2020)

Njëkohësisht ekzistojnë dhe lokacione të përbashkëta individuale/kolektive ku kontenierët janë të pozicionuar brënda
territoreve të institucioneve apo subjekteve private.
Gjëndja aktuale PGM paraqitet e mirë, megjithëse ekziston një seri problemesh si: përsa i përket dëmtimeve të kontenierëve dhe higjenës si pasojë e sjelljes qytetare. Në zonën urbane ky shërbim kryhet në nivel të kënaqshëm dhe vërehet që PGM janë të pastra dhe desinfektuara pothuajse rregullisht nga ndërmarrja e pastrimit.

Kompania KRU "Uniteti" ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për ekonomitë familjare (amvisëritë) dhe për institucionet e bizneset e komunës. Konkretisht kompania zhvillon këtë sistem të grumbullimit të mbetjeve sipas kategorizimeve:
Grumbullimi i mbeturinave në ekonomitë familjare (amvisëritë) duke përdorur dy sisteme për grumbullimin e mbeturinave:

A.Sistemi derë më derë, i cili aplikohet në amvisëritë me banim individual, ku mbeturinat hidhen në konteinerë plastikë me kapacitet 120-240litra, dhe grumbullohen 1 herë në javë nga kompania;

B.Sistemi i grumbullimit të mbeturinave me kontenier 1.1 m3, i cili aplikohet në ato njësi ekonomike familjare me banim kolektiv (ndërtesa shumëkatëshe) apo në koncentrime të institucioneve publike, apo bizneseve të vogla, ku shërbimi ofrohet nga kompania dhe realizohet një herë në ditë në banesa kolektive në zonën qendër, nëpër institucione shërbimi kryhet varësisht zbrazjeve me frekuencë 1 herë në javë.

Kryesisht gjendja fizike e kontenierëve është e mirë dhe vendlokacionet e pikave të grumbullimit janë të organizuara mirë dhe me rrethojat estetike (gjithsej 18 lokacione te grumbullimit të mbeturinave me prezencë prej 2- 5 kontenierë 1.1m3).
Aktualisht shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbetjeve ofrohet në 66 fshtatra të komunës së Vushtrrisë (100%) Në këto fshatra shërbimi është i plotë dhe kryhet 4 herë në muaj.

## 5.5 Përmbledhje e gjetjeve në menaxhim mbeturinash

Në tabelën e mëposhtme do të përmblidhen të dhëna të ëprgjithshme të mjedisit që lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin e mbeturinave në Komunë.

*Table 666. Të dhëna mbi çështjet mjedisore lidhur me menaxhimin e mbeturinave*

| TE DHENA TE PERGJITHSHME | KOMUNA VUSHTRRI |
|---|---|
| MATJE MBI PËRBËRJEN E MBETURINAVE? | JO |
| PIKA TË DEPONIVE ILEGALE TË GRUMBULLIMIT TË MBETJEVE | 11 |
| VENDE TË AUTORIZUARA TË DEPOZITIMIT TË MBETURINAVE (PGM) | 18 |
| VENDE TË PA AUTORIZUARA PËR DEPOZITIMIN E MBETURINAVE | 20 |

**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian

## 5.6 Riciklimi i mbeturinave

Sektori i riciklimit në Kosovë është në hapat fillestarë të zhvillimit. Aktualisht kjo industri është e lokalizuar në bisnese të vogla që kryesisht merren me sortimin e materialit të riciklueshëm dhe shitjen e tij për tregun vendor apo të jashtëm. Tregu i shitjes së materialit të riciklueshëm kryesisht është i fokususar ne materialet e riciklueshme si: metali/alumini, plastika sipas disa llojeve të plastikës, letra dhe kartoni. Cmimi i shitjes varion në treg sipas bursës internacionale dhe ku cmimet kryesisht shkojnë sipas fraksioneve: lëtra 3-4-cent/kg; plastika 20-26cent/kg, alumini/hekuri deri ne 70cent/kg. Për momentin aktiviteti i grumbullimit realizohet prej veprimtarisë joformale në shkallë të ulët përderisa ai i paketimit dhe presimit prej bisneseve të vogla lokale. Kjo veprimtari joformale nuk monitorohen prej komunës apo organeve tjera përgjegjëse.
Përpos fraksioneve të lartpërmendura, në rajonet përreth komunës së Vushtrrisë ka iniciativa prej bisneseve të vogla tjera për grumbullimin e materialit qelq dhe përpunimin e tij, megjithatë janë në shkallë fillestare. Në çdo rrethanë, komuna duhet të hartojë politika që adresojnë ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave si pjesë e objektivave pëe menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të depozituara në deponinë rajonale të Mitrovices.
Në komunen e vushtrrisë janë shpërndare 1350 shporta për riciklim të verdha 120l dhe 240l, ne amvisëri, shkolla dhe institucione. Ballimi bëhet në  Ndermarrjen Sociale në  fshatin Bukosh.

*Table 777. Shpërndarja e shportave për riciklim me kapacitet 120 l dhe 240 l*

Qendër për grumbullim e  mbeturinave të ndara.

| Prezentim hartografik (Ortofoto etj) | Emri i vendbanimit ku gjendet pika e grumbullimit dhe adresa | Numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim | foto e lokacionit |
|---|---|---|---|
| a | b | c | dh |
|  | zona ish varrezat e qytetit | 600 ekonomi familjare te furnizuara me 600 shporta 240 dhe 120 litershe |  |
| | zona Mustafa Venhari | 300 ekonomi familjare te furnizuara me300 shporta 240 litershe | |
| | lagja Bekim Berisha Abeja | 100 ekonomi familjare te furnizuara me 100 shporta 240 litershe | |
| | lagja Bahri Kuqi | 150 ekonomi familjare te furnizuara me 150 shporta 240 litershe | |
| | **36 institucione te arsimit** | **200 copa 240 l** | |

Shpjegim (dh): Te regjistrohet numri i ekonomive familjare qe jane brenda rrezes 250 m nga një pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme, plus numrin e ekonomive familjare që janë pajisë me komposter plus numrin e ekonomive familjare në rreze 5 km nga një qendër për grumbullim e  mbeturinave të ndara.

## 5.7 Kompostimi

Në Komunën e Vushtrrisë raportohen nisma për kompostim edhe pse potenciali parashikohet të jetë shumë i lartë pasi kjo komunë posedon një pjesë e konsiderueshme të popullsisë që jetojnë në zona rurale të cilët gjenerojnë sasi të vogla të mbetjeve inorganike dhe sasi të mëdha të mbetjeve organike që lidhet me veprimtarinë prodhuese të tyre. Vlen për tu përmendur fakti që edhe pse në këtë komunë ka potencial të lartë të gjenerimit të mbetjeve organike apo lëndë drusore si pasojë e hapësirave të gjelbra që posedon, aktualisht ka aktivitet për kompostim ne fshatin Bukosh ku jane shpernda 150 komposter.

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

## 5.8 Administrimi i mbeturinave të vëllimshme dhe rrymave tjera

Një faktor tjetër që ndikon në aspektin estetik dhe shëndetsor për qytetarët e komunës së Vushtrrisë është edhe hedhja pa kriter e mbeturinave voluminoze, kryesisht inerte, mbeturinave të vëllimshmë, të papranueshme për sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Mbeturinat nga prishja e ndërtimeve apo të ashtu quajturat mbetje të ngurta janë mbetje si gurë, dhe, beton, tulla, etj., që mbeten nga veprimtaritë e ndërtimit, rindërtimit, riparimit dhe prishjes së ndërtesave,shtëpiave dhe strukturave të tjera. Shpesh këto mbetje hidhen të përziera me mbetje urbane duke impaktuar cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve apo edhe hidhen në mënyrë të pakontrolluar duke krijuar prezencë të deponive të egra ilegale të dëmshme për mjedis dhe shëndetin e banorëve. Momentalisht ka sistem të instaluar prej kompanisë "Uniteti" për grumbullimin e tyre të veçantë (mbeturinat e vëllimshme). Komuna së fundmi ka përcaktuar një lokacion për dërgimin e mbeturinave inerte prej gjeneruesve të mbeturinave megjithatë zbatimi i rregullores për hedhje të kontrolluar të kësaj kategorie të mbeturinave nuk gjen zbatim tek prodhuesit e këtij fraksioni të mbeturinave (shaku largësia e deponise ne fshatin Stroc 16 km nga qendra).
Referuar organizimit të veçantë të grumbullimit për mbetjet prej eshtrave, sipas informatave nuk posedohet një organizim I veçantë apo trajtim I kësaj kategorie të mbetjeve të rrezikshme.
Mbetjet tjera të rrezikshme duke përfshirë mbetje spitalore prej klinikave të mjekësive familjave bashkohen me rrymën e mbeturinave të përgjithshme dhe dërgohën në deponi pa trajtim të veçantë. Krijimi I sistemeve të integruara të mbeturinave dhe organizimi iI shërbimit referuar llojit të mbeturinave të gjeneruara kërkon angazhim të të gjithë akterëve në proçes me rëndësi të veçantë edhe inspektoriatin. Komuna në planët e saj parasheh trajtimin e mbeturinave referuar rrymës që I përkasin si dhe krijimin e qendrave të ndarjes në njësi komunale duke I bashkërenduar me zhvillimin e fushatave të informimit për qytetarë.

## 5.9 Deponimi i mbeturinave

Shërbimi i deponimit të mbeturinave për komunën e Vushtrrisë ofrohet nga kompania regjionale "Uniteti", përmes deponisë rajonale të Mitrovicës, e cila gjendet në fshatin Gërmovë në distancë prej 20 km në njërin drejtim. Mungesa e aseteve transportuese adekuate dhe trafiku rrugor parashihen si problematikë gjatë bartjes dhe deponimit të mbeturinave në deponi.Kostoja e deponimit ngarkon tarifën prej 6 Euro për çdo ton të mbeturinave komunale të deponuara, tarifë kjo sa gjysma e tarifës së aplikuar nga Kompania për Menagjimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK).Mungesa e aktiviteteve të riciklimit e cila synon reduktimin e sasisë dhe volumit, si rrjedhojë reduktimin e kostove të transportit, adreson kërkesën e ngarkesës shtesë me kosto financiare referuar kosto të transportit,amortizimit të pajisjeve dhe eficiencës në kohë.

**Formatted:** Albanian




*Figure 666. Deponia në Gërmovë, Mitrovicë*

## 5.10 Shërbimet e pastrimit të rrugëve dhe shërbime tjera mirëmbajtjeje

Përpos organizimit të sistemit efikas për menaxhim të mbeturinave,impakt në aspektin mjedisor,estetik dhe shëndetsor të një komunë kanë edhe shërbimet e mirëmbajtjes së hapësirave publike.Referuar të dhënave, kompania regjionale “Uniteti” njësia në Vushtrri përmes aktivitetit sekondar të kompanisë publike që bazohet në kontrata të veqanta me komunën e Vushtrrisë është përgjegjëse sipas kushteve kontraktuale për:
• Menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pastrimit të rrugëve.

## 5.11 Mjetet për ofrimin e shërbimit

Mjetet për ofrimin e shërbimit sipas të dhënave do të përmblidhen në:

Kontenierë për grumbullim
Të dhënat paraqesin se, Komuna e Vushtrrisë ka të shpërndarë në territorin e saj kontenierë sipas shërbimit dërë më derë 82000 shporta 120l apo nëpër pika të përbashkëta grumbullimi 220 Konteneire 1.1 m3. E gjithë kjo infrastrukturë është në pronësi të komunës dhe në shfrytëzim të kompanisë regjionale.
Në tabelën më poshtë jepet lloji dhe numri i konteinerëve që operojnë në Komunën e Vushtrrisë:

*Table 888. Logjistika e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave*

| NR. | LLOJI I KONTEJNERËVE | KAPACITETIT | NR. KONTEJNERËVE 2020 | VITI I FILLIMIT TË PËRDORIMIT | GJENDJA E TYRE |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Plastik | 240 litra | 1350 | 2017-2019 | E mire |
| 2 | Plastik | 120 litra | 8200 | 2016-2019 | E mire |
| 3 | Plastik | 1.1 m³ | 203 | 2018 | E mire |
| 4 | Metalik | 1.1m³ | 60 | 2018 | E mire |
| 5 | Metalik (arkë) | 7m³ | 7 | / | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kamioni Nr. 10 | ULT 160 C ngarkues | | | |
| | Autofshis mini | | | |
| Kamioni nr. 11 | IVECO K3 Kompaktor | 8 m3 | 2001 | 02-520-DQ |
| Kamioni nr. 12 | MERCEDES K3 kompaktor | 8 m3 | 2000 | 02-667-DO |
| MAZDA Automjet | | | | |
| Mercedes | | | 1999 | 02-427-DO |
| Fiat itachi | Ngarkues - eskavator | | 2003 | |
| Traktorë për grumbullim | | | | |
| Traktori Nr. 1 | | | 2001 | |
| Traktori me lug Nr. 2 | | | 2001 | |
| Lloji I aseteve të (QPPRA) Qendrës për paketim të mbetjeve të riciklueshme | | | | |
| Kamioni Nr. 1 | ISUZI KOMPAKTOR | 8.1 M3 | 2015 | |
| Kamioneta Nr. 2 | Citroen | 2.1 Ccm | | |
| Presa hidraulike 1 | HMTO - 6040 | 5.5 kë | 2015 | |
| Presa hidraulike 1 | HMTO - 6040 | 5.5 kë | 2015 | |
| Presa hidraulike 2 | HMTO - 6040 | 5.5 kë | 2015 | |
| Presa hidraulike 3 | HMTO - 6040 | 5.5 kë | 2015 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Presa hidraulike 5 | ASD - 250 | 5.5 kë | 2015 | |
| Vinci motorik | 300 | 3000 kg | 2015 | |
| Vinci manual | | 1000 kg | 2015 | |
| Mulliri per bluarje te plastikes | | 7.5 kë | 2017 | |

**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian
**Formatted:** Albanian

## 5.12 Financat dhe të hyrat financiare

Aktualisht Komuna në Vushtrri realizon inkasimin apo vjeljen e tarifës së shërbimit. Aplikimi I tarifave të përcaktuara në Rregulloren komunale për mbeturina ndahet sipas kategorive të klientëve ku tarifat e aplikuara janë:

- Në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë aplikohet tarifa fikse 4.40 euro në muaj;
- Në kategorinë e konsumatorëve komercialë tarifa varion prej 5.4 për subjektet e vogla shërbyese në 13.10 euro në subjektet të mesme dhe të mëdha komerciale (për zbrazje të kontenierit 1.1m3). Tarifa e përcaktuar për zbrasje të kontenierëve 7m3 është e përcaktuar në vlerë 36.8 euro/muaj.

Të dhënat mbi aspektet financiare të shërbimit të menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrisë janë paraqitur në dy tabelat në vijim, të cilat grupojnë përkatësisht (i) çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues dhe (i) të kostos së dhënies së shërbimit e buxhetimit të tij.

### 5.12.1 Çështje të tarifës, faturimit dhe mbledhjes së të ardhurave nga subjektet pagues

Së pari, të dhënat e mbledhura tregojnë një diferencë të theksuar midis numrit të subjekteve të cilëve ju faturohet tarifa e shërbimit dhe kanë ~~kanë~~ realizuar pagësen e faturës, diferencë kjo e cila reflekton buxhetin e komunës për realizimin e këtij shërbimi (inkasimi për amvisëri 56 %, mbulimi me shërbim 100%).

Sipas të dhënave të ofruara prej komunës dhe kompanisë inkasimi prej vitit 2018 është në rritje si efekt i~~I~~ shtrirjes së shërbimit në nivel territorial dhe referuar të dhënave të ofruara për vitin 2019 vlerësuar me numrin e bisneseve në faturim të kostos së dhënies së shërbimit në vitin 2018 dhe inkasimit të tij.

**Formatted:** Albanian

*Table 101010. Të dhëna lidhur me inkasimin për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, Komuna dhe KRU "Uniteti"*

| Viti raportues 1 janar - 31 dhjetor 2019 | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i operatorit | Kategoritë e klientëve të shërbyer | Faturimi (të hyrat) | | Arkëtimi | | |
| | | Vlera € | Nr. i faturave të lëshuara | Vlera € | Nr. i faturave të arkëtuara | |
| a | b | c | ç | d | dh | |
| KRM UNITETI | Amvisëritë | 626,524.80 | 47,464 | 419,777.63 | 31,801 | |
| | Bizneset | 58,750.00 | 10,812 | 51,329 | 9,446 | |
| | Institucionet | 186,063.54 | 624 | 159,184.10 | 533 | |
| | Shërbimet e kontraktuara | | | | | |
| Operatori 2 | Amvisëritë | | | | | |
| | Bizneset | | | | | |
| | Institucionet | | | | | |
| | Shërbimet e kontraktuara | | | | | |

*Numri ekonomive familjare sipas të dhënave nga komuna

Shuma potenciale e të ardhurave nga niveli aktual i shërbimit, sipas tarifave që zbatohen aktualisht për subjektet pagues është përllogaritur në bazë të numrit të familjeve që marrin shërbim të rregullt të menaxhimit të mbetjeve, numrit gjithsej të bizneseve, si dhe numrit gjithsej të institucioneve në Komunën e Vushtrrisë.

Sipas të dhënave të raportuara inkasimi për vitin referent 2020 sipas shërbimit vetëm në klientët ku ofrohet shërbimi grumbullimit të mbeturinave është rreth 56% për amvisëri residente, sipas raportimit krahasues Arkëtimi për shërbim për të gjitha kategoritë (vitin 2019) të hyrat janë rreth 402.090,83 ndërkohë në 2020 është 470.966,79 euro, e cila tregon një përqindje të mirë të rritjes së shkallës së inkasimit. Njëherësh komuna sipas kontratave të ndryshme për aktivitetet sekondarë që ofrohen prej kompanisë publikë ofron pagësë konform buxhetit (viti 2019) sipas kontratës menaxhimi dhe mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve për nje vit 68.000,00 €.

Shpenzimet e deklaruara nga Kompania Regjionale "UNITETI" ne Mitrovice per Njesin ne Vushtrri per vitin 2020 jane:

Shpenzimet per paga te punetoreve: 356,682.00 bruto

Shpenzimet per derivate: 82,458.00 pa tvsh

Shpenzime tjera (administrate, mirembajtje, borgje te keqija, byfeja tatim ne prone, energji elektrike etj): 93,207.54

## 5.13 Përmbledhje e gjetjeve kryesore nga vlerësimi i gjendjes fillestare

Duke kKonsideruar si bazë reference vitin 2019-2020. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve në Komunën e Vushtrrise ka një kosto gjithsej prej mbi 600.000 euro/vit pa llogaritur kostot kapitale.
o Shërbimi ofrohet përafërsisht për 100% të popullsisë.

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

o Shpeshtësia (frekuenca) e mbledhjes së mbetjeve urbane është cdo ditë / javë për zonën urbane të qendrës së qytetit dhe 1 herë në javë për zonat rurale ku përfshihen të gjitha njësitë e tjera administrative.
o Me riorganizimin territorial të shërbimit referuar efektivitetit dhe eficiencës objektivi strategjik i komunës për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve është plotësimi me infrastrukturë të grumbullimit për 2% amvisëri në territorin e saj referuar politikave të mëparshme të komunës për pajisje dhe unifikim të mjeteve të kryerjes së shërbimit.
o Me shtritjen e shërbimit në komplet territorin dhe referuar mjeteve motorike të vjetëruara komuna duhet të adresojë ceshtjen për përmirësimin e kapaciteteve të operimit për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
o Deri me tani, kKomuna ka përmbushur objektivën e saj strategjike për shtrirje të shërbimit në njësi territoriale të tërritorit komunal.

Formatted: Albanian

## 5.14 Nevojat dhe prioritetet

Gjenerimi i mbetjeve në territorin e komunës ka efekt të drejtpërdrejte në zhvillimin e turizmit dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, i cili është prioriteti kryesor i komunës Vushtrrisë nga pikëpamja ekonomike si dhe në integritetin e zonave të mbrojtura mjedisore.
Nevojat të cilat duhen marrë parasysh në zbatimin e planit në harmoni dhe me planin komunal për menaxhim të mbeturinave të komunës janë renditur si me poshtë:

- Rehabilitimi i zonave me ndotje prej deponive të ilegale dhe revitalizimi I tyre duke i kthyer në zone të gjelbra me vlere rekreative për qytetin, të tjerat në përputhje me normat e sigurisë;
- Inventarizimi dhe diagnostikimi i vend-depozitimeve, si dhe përcaktimi i prioriteteve, planifikimi dhe raportimi;
- Zhvillimi i infrastrukturës se përshtatshme për menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave;
- Aprovimi i një buxheti të mjaftueshëm për menaxhimin e mbeturinave referuar planeve dhe objektivave;
- Hartimi i programeve për ndarje në burim të mbeturinave;
- Krijimi i kushteve të duhura për donatoret ndërkombëtare për të financuar infrastrukturat e nevojshme;
- Forcimi i mekanizmave për mbledhje më të mirë të tarifave dhe zbatimi i sanksioneve dhe monitorimi i shërbimit në përgjithësi.

Sipas qëllimeve të vendosura në planin për menaxhim të mbeturinave komunale, objektivat primare në menaxhim të mbeturinave komunale janë fokusuar në marrjen e masave emergjente për të ndryshuar situatën, përmirësimin e performancës komunale për mbledhjen, transportin dhe depozitimin e sigurtë të mbeturinave komunale si dhe rritjen e efiçiencës dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.

Kjo do të përfshijë zbatimin e skemave për shtrirjen e shërbimit bazik në nivel të komplet territorit dhe popullsisë së shërbyer dhe aktivitete tjera që rrisin përformacën për ofrimin e shërbimeve bazike, zbatimin e programeve të minimizimit të mbeturinave përfshirë ndarjen në burim për riciklim dhe kompostimin për të reduktuar në mënyrë progresive sasinë e mbeturinat për deponim final në deponi (20220-20262) si dhe trajtimin adekuat të mbeturinave me qëllim zvogëlimin e rrezikut që shkaktojnë në mjedis. Në të njëjtën kohë do të synojë rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe përmirësimin e financave komunale për menaxhimin e mbeturinave.
Objektivat janë strukturuar duke marrë parasysh qëllimet e përcaktuara prej Kkomunës së Vushtrrisë në planin komunal për menaxhim të mbeturinave 20167-20202, duke analizuar objektivat e vendosura dhe duke analizuar gjendjen ekzistuese të shërbimit të menaxhimit të mbeturinave në komunë. Krahas saj, vlerësimi I gjendjes ekzistuese të sektorit rishikojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuara në plan dhe nevojën për plotësime shtesë apo rishikimin e tyre.

Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian

Përsa i përket vendosjes së objektivave sipas PKMM 20221-2026, në mënyrë të përmbledhur ato në disa qëllime dhe do të konsistojnë në:

Formatted: Albanian

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eleminimin e të gjtha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar të tyre për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

*Objektivi kryesor i planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, Komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale.*

Në harmoni me këto politika, Komuna e Vushtrrise do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Ngritjen e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim) pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi e sistemit aktual, zgjërimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi I kapaciteteve për deponimin e mbeturinave).
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave;

# 6. PLANI KOMUNAL PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

## 6.1 Planifikimi strategjik dhe vizioni

Politikat e nivelit qëndror dhe lokal në Kosovë në menaxhim të mbeturinave parashtrojnë si domosdoshmëri zhvillimin e alternativave të qëndrueshme përmes praktikave të trajtimit të mbeturinave sipas llojit të tyre.Vazhdimi i sistemit aktual të deponimit të mbeturinave nuk konsiderohet të jetë një opsion i qëndrueshëm si rezultat i zvogëlimit të kapacitetit të deponive vijuar me politikat sociale, ekonomike dhe mjedisore.
Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturina kanë përcaktuar 2 periudha të rëndësishme kohore: faza e parë dhe e dytë (2013-2017 dhe 2017-2022) ku synohet përparimi drejt standardeve të BE dhe arritja e standardeve dhe objektivave të BE. Në këtë kuadër, politikat nacionale synojnë progresin gradual drejt përmirësimit të situatës aktuale drejt standardeve kombëtare e ndërkombëtare.

Referuar politikave të nivelit local, zhvillimi i Planit Komunal për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave synon të adresojë zgjidhje efikase dhe me kosto efektive për të zvogëluar sasinë e mbeturinave të deponuara, për të menaxhuar në mënyrë efektive mbetjet e ngurta dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Vizioni i planit lokal të menaxhimit të integruar të mbeturinave të komunës së Vushtrrisë mori formë si një proces i analizimit të situatës aktuale dhe mundësive për hartimin e objektivave që synojnë menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave komunale.
Në fund, duke iu referuar statusit aktual të menaxhimit të mbeturinave, prioriteteve të përgjithshme si dhe pritshmërive për zhvillimin e këtij sektori, vlerave dhe normave qytetare, nevojës për ndryshim, u përcaktua vizioni i komunës I cili synon të jetë:

*“Komuna e Vushtrrisë një zonë me mjedis të pastër për rritjen e cilësisë së jetës si dhe drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik”*

Objektivi kryesor i~~I~~ planit bazohet në objektivat kombëtare për menaxhim të mbeturinave lidhur me ndërmarrjen e masave përmes së cilave, Komuna do të duhej të zvogëlojë sasinë e mbeturinave që aktualisht krijohen me qëllim ngritjen e sistemit të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale:
Në harmoni me këto politika, Komuna e Vushtrrisë do të planifikojë objektiva specifike duke u fokusuar në:

- Zvogëlimin e krijimit të sasisë së mbeturinave në burim si dhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që duhet të deponohen;
- Përmirësimin e infrastrukturës për ndërtimin e sistemit të integruar në menaxhimin e mbeturinave (Zvogëlim – Ripërdorim - Riciklim) pra për të krijuar kushtet për funksionim më efektiv të sistemit;
- Zvogëlimin e rrezikut nga mbeturinat;
- Kontributin për ngritjen e punësimit në vend;
- Ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave
- Përmirësimi i shërbimit për mbledhjen e mbeturinave komunale (përmirësimi e sistemit aktual, zgjërimi/plotësimi i zonave të grumbullimit, ekzamenimi dhe harmonizimi I kapaciteteve për deponimin e mbeturinave).
- Edukimin e publikut, ngritja e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit
- Rishqyrtimin e rregulloreve për menaxhimin e mbeturinave;

Në këtë kontekst, objektivat e PMIM për Komunën e Vushtrrisë janë:

1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në mënyrë të unifikuar në nivel territorial.
2. Të sigurojë grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara dhe të garantojë eleminimin e të gjtha depozitimeve të përkohëshme të pakontrolluara brënda territorit të komunës.
3. Të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare të reduktimit dhe ripërdorimit të mbeturinave.
4. Të sigurojë reduktimin e mbetjeve të destinuara për destinacionin final si shkak i aktivitetit të riciklimit dhe kompostimit.
5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës duke marrë në konsideratë mundësitë dhe vullnetin e banorëve, bizneseve dhe institucioneve për të paguar.

Zbatimi i këtij Plani do të shtrihet në planin kohor 5 vjeçar 2022~~0~~ – 2026~~5~~. Treguesit dhe buxheti i zbatimit të Planit monitorohen dhe rishikohen cdo vit në kuadër të procesit të përgatitjes së pakëtës fiskale dhe buxhetit vjetor të komunës.

## 6.2 Objektivat dhe Rezultatet e PKMM

Përcaktimi i objektivave shërben për të përcaktuar dhe menduar se çfarë do të jetë më e rëndësishme për Komunën e Vushtrrise, si dhe për të marrë një vendim përfundimtar mbi zhvillimin e shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe trajtimit të mbeturinave. Paraqitja e rezultateve ndihmon për të bërë zgjedhjet e duhura me fokus në përmirësimin e shërbimit dhe monitorimin e përformancës së komunës së sektor..
Për të përmbushur objektivat e këtij plani, Komuna e Vushtrrise ka vendosur këto tregues për objektivat që do të realizohen nga zbatimi i Planit.

**Objektivi 1**: Reforma administrative – krijimi i mekanizmit institucional/ligjor.

Sipas objektives se parë~~w~~ duhet:

- Themelimi i~~I~~ sektorit pë~~w~~r MM;

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

- Plotë~~w~~simi me~~w~~ numë~~w~~r të~~w~~ stafit;
- Ngritja e kapacitetit të~~w~~ sektorit;
- Rishikimi i~~I~~ rregullores pë~~w~~r MM.

*Table 1~~1111~~. Objektivi 1 sipas PKMM*

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Objektivi 1: Reforma administrative – krijimi i mekanizmit institucional/ligjor. | | | | | | | |
| Komuna Vushtrri | | | | | | | |
| Rezultati | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| Totali | Komuna | | | | | | |

**Objektivi 2**: Ndarja e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit:

a) Zgjerimi i skemes se ndarjes se mbeturinave te riciklueshme:
1. Plotesimi i skemes se ndarjes se mbeturinave te riciklueshme ne zonen e qytetit;
2. Pajisja me shporta rrjete ne banimet kolektive – zona urbane (15 cope);
3. Pajisja me shporta rrjete ne zonen rurale (15 cope);

b) Zbatimi i skemes per kompostim te mbeturinave organike:
1. Pilotimi i kopmpostimit shtepiak ne zonen urbane per shtepi individuale (1000 amviseri);

Në këtë drejtim kjo objektivë e caktuar synon të sigurojë në mënyrë graduale infrastrukturën dhe zbatimin e skemës optimale të nevojshme për ndarjen e mbetjeve në burim dhe grumbullimin e diferencuar për të përmbushur objektivat kombëtare për reduktimin e mbetjeve.

Për të arritur këtë objektiv, Komuna e Vushtrrise do të synojë ofrimin e këtij shërbimi në dy standarde sipas ndarjes territoriale në dy zonat e shërbimit.

Tabela e rezultateve dhe tregueseve të indikatorëve për Objektivin 2 paraqitet në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

| |
|---|
| Objektivi 2: Ndarja e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit. |

# 7. VLERËSIMI DHE ANALIZA E PËRBËRJES SË MBETURINAVE KOMUNALE

## 7.1 Kriteret për planifikim

Në bazë të legjislacionit ekzistues, Plani Komunal për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave do të fokusohet në planifikimin e programeve për minimizim dhe trajtim të sigurtë të mbeturinave sipas potencialit gjenerues të fraksioneve të mbeturinave komunale të gjeneruara, për të cilën Komuna e Vushtrrisë është drejtpërdrejtë përgjegjëse. Përgjegjësia e komunës duke u referuar kompetencave të komunave në pajtim me Ligjin për Mbeturina do të bazohet ndër të tjerash në:

- Hartimin dhe miratimin e planeve lokale për menaxhimin e mbeturinave;
- Përcaktimet e lokacioneve, bazuar tek plani hapësinor, sipas nevojave përkatëse për menaxhimin e mbeturinave komunale;
- Përcaktimin e tarifave për shërbimet e grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave komunale;
- Caktimin dhe mbikqyrjen e zbatimit të standardeve të shërbimit për ndërmarrjet e kontraktuara për grumbullimin e mbetjeve.

Krahas saj, një planifikim I programeve efikase të komunës në menaxhim të mbeturinave do të bazohet në kapacitetin gjenerues dhe të mbeturinave komunale, sipas përbërjes dhe mënyrës së menaxhimit të mbeturinave, mbeturinat komunale do të klasifikohen në:

- Mbeturina urbane (mbeturina të amvisërisë),
- Mbeturina të veçanta urbane (mbetje inerte e ndërtimore, mbeturina të vëllimshme: pajisje elektrike dhe mobiljesh, etj.) që prodhohen nga familjet apo njësitë tregtare;
- Mbeturina të rrezikshme që prodhohen brënda territorit të komunës.

Në lidhje me burimet e gjenerimit të mbeturinave, Mbeturinat urbane ndahen në dy rryma, sipas burimit të origjinës: (MF) Mbeturinat e prodhuara nga familjet; (MB) Mbeturinat e prodhuara nga bizneset dhe industritë, ku përbërja e mbeturinave nuk ndryshon nga karakteristikat e mbeturinave urbane. Ndërkohë, rryma të tjera të mbeturinave do të klasifikohen si mbeturina masive, mbeturina të ngurta (inerte) që prodhohen në familje dhe që do ti trajtojmë si 'mbeturina të veçanta' për të cilat Komuna duhet t'i ofrojë alternativa të përshtatshme për grumbullimin dhe transportin e tyre, megjithëse largimi i tyre është përgjegjësi direkte e prodhuesit.

Një element kryesor i planifikimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave është "identifikimi dhe shqyrtimi i alternativave" të qëndrueshmë duke ju referuar analizës së potencialit të gjenerimit të mbeturinave sipas fraksioneve dhe planifikimin e programeve për trajtimin e tyre. Planifikimi I programeve do të shqyrtojë mundësitë e ndryshme teknike dhe strategjike për menaxhimin e mbeturinave sipas planit të objektivave , vlerësimit të shkallës së zbatimit të tyre, avantazheve dhe disavantazheve ekonomike, ligjore, mjedisore, sociale si dhe teknologjive në dispozicion për këto alternativa.

## 7.2 Gjenerimi i mbeturinave

Për të parashikuar se si do të menaxhohen mbeturinat në të ardhmen për Komunën e Vushtrrisë, duhet të vlerësohet gjenerimi aktual i mbeturinave që të parashikojmë ecurinë e tyre për një periudhë afatmesme (3-5 vite). Të dhëna të sakta për gjenerimin e mbeturinave nevojiten për planifikimin e një shërbimi të ri apo ndryshime në shërbimin ekzistues të grumbullimit të mbeturinave, për projektimin e tarifave lokale për konsumatorët, për hartimin e planit (për vlerësimin e gjendjes ekzistuese dhe përcaktimin e objektivave mbi fraksionet e mbeturinave) si dhe për procesin e monitorimit të zbatimit të planeve. Gjithashtu, ka rëndësi të përcaktohen cilat fraksione të mbeturinave janë nën përgjegjësinë e komunave dhe cilat jo, të klasifikohen mbeturinat sipas burimit të origjinës dhe të jepen zgjidhje për trajtimin e tyre, ku sipas burimit të klasifikohen nëse janë të dëmshme (të rrezikshme) apo jo dhe në lidhje me kushtet e trajtimit/përpunimit të mbeturinave dhe metodat për tu aplikuar që disponohen apo do duhet të sigurohen në të ardhmen prej komunës së Vushtrrisë.
Një nga pengesat kryesore në komuna në Kosovë është mungesa e të dhënave statistikore lidhur me sasinë dhe llojet e mbeturinave të gjeneruara në burim për nivel territorial sipas komunave ku përgatitet planifikimi. Me qëllim parashikimin e administrimit të mbeturinave në të ardhmen në Komunën e Vushtrrisë, është e rëndësishme llogaritja e prodhimit aktual të mbeturinave si dhe parashikimi për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë i shkallës së rritjes së tyre, në varësi me trendet e sjelljes konsumatore.

Këto të dhëna janë të rëndësishme për hartimin e planeve të sakta dhe mundësojnë llogaritjen e situatës aktuale dhe përcaktimin e objektivave si dhe procesin e monitorimit në periudhë kalimtare apo të vazhdueshme. Në mungesë të këtij informacioni, komuna rekomandohet që gjatë përgatitjes së planeve strategjike t'i referohen normave dhe të dhënave kombëtare sipas Strategjisë të Republikës së Kosovës për Mbeturinat dhe Planit të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave ku përllogaritet gjenerimi 0.9 kg/banorë/ditë për zonat urbane dhe gjenerim 0.4 kg/banorë/ditë për zonat rurale, apo mesatarisht 0.78 kg/banorë/ditë ; si edhe njëherësh t'i referohen raporteve mbi sasinë totale të deponimit të mbeturinave.
Gjatë periudhës 2019- 2020, prej zyrtarëve të kompanisë regjionale "Uniteti" u grumbulluan të dhënat të nevojshme lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara në nivel komunal. Në bazë të këtyre të dhënave, duke iu referuar matjeve sipas metodave përkatëse dhe studimeve sipas raporteve të grumbulluara për këtë Komunë janë gjeneruar rezultate të besueshme për të ndërtuar strategjitë e ardhshme për menaxhimin e mbeturinave sipas rrymave të fraksionit të tyre.

Sipas të dhënave të grumbulluara, sasia totale e mbeturinave të grumbulluara për përiudhë 1 vjeqare prej janar-dhjetor 2019 janë depozituar rreth 21,528 ton mbeturina në deponinë e Mitrovicës prej kompanisë regjionale "Uniteti".Shprehur në muaj rreth 1794 ton në muaj janë grumbulluar prej shërbimit në komunën e Vushtrrisë apo 68-70 ton në ditë mbeturina janë gjeneruar prej banorëve në komunë.
Duke marrë në konsideratë që grumbullimi I mbeturinave kryhet në shtrirje 100% mbulueshmëri shërbimi si edhe duke konstatuar prej informatave të kompanisë ku 70% e sasisë së mbeturinave të deponuara janë mbeturina të amvisërisë ( edhe pse nuk ka ndonjë matje të saktë, andaj në konsideratë do të merret sasia totale dhe banorët resident në këtë periudhë të matjes), kryesisht prej amvisërive residente (15870 ekonomi familjare apo 69700 banorë) referuar situates do të konsiderojmë që, përafrojmë që rreth 0.64 kg në ditë është norma mesatare e gjenerimit për kokë banori në Komunën e Vushtrrisë.
Përllogaritja e normës së gjenerimit të mbeturinave për kokë banori është variabël I ndryshueshëm që varet prej sjelljes së konsumatorit dhe faktorë të tjerë andaj rekomandohet komuna që analizën e gjenerimit të mbeturinave ta zhvillojë në kampionë të caktuar në ekonomi familjare, bisnese apo institucione në zona urbane dhe zona rurale.

Analiza e saktë e gjenerimit të mbeturinave për kokë banorë është indikatori përcjellës i të gjitha analizave të rrymave sipas fraksioneve në planin e menaxhimit të integruar të mbeturinave komunale.

*Table 14~~1417~~. Gjenerimi i mbeturinave për banor në komunë të Vushtrrisë referuar sasisë së deponimit (periudhë gjashtë mujore)*

| Numri i amvisërive totale ASK | Numri i popullsisë ASK 2011 | Numri i amvisërive të shërbyera residente | Numri i përafërt banorëve në ekonomi familjare residente të shërbyer | Sasia totale e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione Periudha e llogaritur është 6 mujore (ton) | Sasia mesatare e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ditë kg/ditë | Muaj kg/muaj | Vit kg/muaj |
| 11867 | 69870 | | | | 0.64 kg | 19.2 kg | 233.6 |

*Table 15~~1518~~. Gjenerimi i mbeturinave për periudhë 1 vjeçare në komunën e Vushtrrisë*

| Numri i amvisërive të shërbyera | Numri i banorëve në ekonomi familjare të shërbyer | Sasia e mbeturinave: amvisëri, biznese dhe institucione X kg/ditë për banorë | Sasia mesatare e gjeneruar mbeturinave në nivel komunal | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | Ditë ton/ditë | Muaj ton /muaj | Vit ton /vit |
| **14690** | 69870 | 0.64 kg | 55.6 | 1692.06 | 20 304,81 |

Referuar këtyre të dhënave sasia e mbeturinave të gjeneruara për kokë banori në muaj për vitin 2020 është 19.2 kg, ndërsa për ditë është rreth 0.64 kg. Krahasimi I këtyre rezultateve me normën mesatare të përllogaritjes të ofruar prej nivelit qëndror sa i përket shkallës së gjenerimit të mbeturinave për tërë Kosovën (mesatarja e llogaritur sipas agjensionit 0.78 kg mbeturinë/ditë/banorë, zona rurale 0.4 kg në ditë) ka dallim duke marrë në konsideratë karakterin gjysëm urban të komunës duke gjeneruar 0.14 kg me pak mbeturinë në ditë për kokë banori.

Kjo përllogaritje merr në konsideratë vetëm llojin e mbeturinave të amvisërisë të grumbulluara dhe raportuara prej kompanisë regjionale "Uniteti", grumbullimi i së cilës konsiston vetëm për rrymën e mbetjeve të amvisërisë (jo rryma tjera të mbeturinave si psh mbetje voluminoze,prishjeve etj).

## 7.3 Përbërja e mbeturinave në komunën e Vushtrrisë

Analiza e përbërjes së mbeturinave (analiza mercologjike/analiza e fraksioneve) komunale shërben kryesisht për të përcaktuar përbërjen e mbeturinave komunale dhe më konkretisht duke përcaktuar sasinë (peshën ose %) e fraksioneve të mbeturinave të riciklueshme, të kompostueshme apo mbeturinave të llojeve të tjera që gjenden brenda rrymës së mbeturinave komunale.

Përmes këtyre të dhënave do të mund të përcaktohet potenciali i mbeturinave komunale që mund të reduktohet, ripërdoret, kompostohet apo të trajtohet me teknika të tjera për përfitim energjie sipas skenarëve dhe opsioneve praktike, ekonomike për trajtimin dhe menaxhimin e mbeturinave të ngurta urbane sipas objektivave zhvilllimore.

Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 9 pt
Formatted: Font: 9 pt, Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Font: 10 pt
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian

Aktualisht nuk ka asnjë matje të rrymave të mbeturinave sipas llojit që gjenerohen në territorin kësaj komune. Studime të mëparshme të kryera në zona3 me tipologji të përafërt mund të na japin një pamje të përafërt të gjenerimit të këtyre rrymave edhe për Komunën e Vushtrrisë.

Sipas analogjisë, Vlerësimi i sasisë së mbeturinave në përgjithësi dhe sasisë sipas fraksioneve, të cilat gjenerohen është bazuar mbi të dhënat e Komunës së Vushtrrisë si dhe rezultatet e matjeve dhe të analizës së mbeturinave që janë organizuar nga GIZ në vitin referent 2012 në komunën e Prishtinës. Gjatë studimit të përbërjes së mbeturinave të marrura në burim, kampionët e analizuar të mbeturinave janë marrë në zona të caktuara dhe kohë të caktuar.




*Figure ???. Diagrama e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2012/ AMMK 2014)*

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

Duke u bazuar në rozen e përbërjes së mbeturinave (raporti GIZ 2011), përbërja mercologjike e mbetjeve është paraqitur në tabelën që vijon:

*Table 16~~16~~19. Përbërja e mbeturinave në komunën e Vushtrrisë sipas gjenerimit*

| Mbeturina | % | Sasia ditore sipas fraksionit | Sasia ditore | Sasia vjetore Komuna Vushtrri |
|---|---|---|---|---|
| | | ~ | Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë ) | (ton/vit/2020) |
| Totali mbeturina | 100.00% | 0.64 kg/ditë | kg/muaj | |
| Te njoma | 40.87% | ~ 0.41 | kg | |
| Të riciklueshme[1] | 33.24% | ~ 0.33 | kg | |
| Te tjera | 25.89% | ~ 0.26 | kg | |

Sasia e biodegradueshme organike është në përqindje më të lartë duke çuar drejt mundësisë së prezantimit të skemave të kompostimit të mbeturinave, kryesisht në zonat me shtëpi private apo në zonat rurale me kapacitet më të lartë për kompostim.Duhet të marrim në konsideratë që ky fraksion I mbeturinave (mbeturina organike) duke përfshirë edhe mbeturinat e gjelbra dhe të kafta prej hapësirave të gjelbëruara mund të variojë prej 41-70 % të përbërjes së mbeturinave totale komunale që gjenerohen në vit.

*Table 17~~17~~20. Përbërja e mbeturinave të fraksionit të thata/të riciklueshme*

| Mbeturina | % | Sasia ditore sipas fraksionit | Sasia ditore | Sasia vjetore Komuna Vushtrri |
|---|---|---|---|---|
| | | ~ | Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë ) | (ton/vit/2020) |
| Totali mbeturina | 100.00% | 0.64 kg/ditë | ~19 kg/muaj | |
| Të riciklueshme[2] | 33.24% | ~ 0.33 | kg | |
| Leter / Karton | 12.83% | 0.13 | kg | |
| Plastike | 14.78% | 0.15 | kg | |
| Qelq | 4.45% | 0.04 | kg | |
| Metale | 1.18% | 0.01 | kg | |

Për sa i takon mbeturinave të riciklueshme, letra, karton, plastika, qelqi përfaqësojnë një përqindje të konsiderueshme duke krijuar mundësinë e prezantimit dhe aplikimit të skemave për grumbullimin e ndarë të tyrë dhe konsolidimin e një pikë të sortimit të mbetjeve të riciklueshme në komunën e Vushtrrisë.

Formatted: Albanian

Gjithësesi lind nevoja që periodikisht (1-2 herë në vit) këto matje të ribëhen për të pasur një pasqyrim më të qartë dhe të përditësuar të gjenerimit në përqindje të rrymave të mbeturinave, veçanërisht për të konstatuar Mbeturinat e rrezikshme, si Mbeturinat spitalore apo industriale që hyjnë në rrjedhën e mbeturinave në nivel lokal, me qëllim trajtimin e çështjes nga autoritetet lokale dhe qëndrore.
Lidhur me mbeturinat inerte, nuk posedohet ndonjë matje sasiore e saktë për përllogaritjen e tyre, andaj kjo sasi nuk merret në konsideratë në përllogaritjet e mësipërme. Referuar raportimit vjetor të komunës së Vushtrrisë pranë AMMK, Komuna e Vushtrrisë ka eliminuar në vitin referent 2019 rreth 40 deponi ilegale të dimensioneve të ndryshme,megjithatë prezente janë 21 deponi ekzistuese prej 2017 (periudha referente e verifikimit të deponive ilegale).Kryesisht sasia e deponive ilegale varion sipas madhësisë dhe do të ndahet në :

*Table 18~~1821~~. Karakteristikat e përbërjes së deponive ilegale në komunën e Vushtrrisë*

| Karakteristikat e deponive | Sasia në numër | Sasia në përqindje |
|---|---|---|
| Mbeturina të amvisërisë (A) | - | - |
| Mbeturina inerte / ndërtimore (N) | 11 | 52% |
| Mbeturina industriale dhe të rrezikshme (R) | - | - |
| Mbeturina të vëllimshme (V) | - | - |
| Mbeturina të përziera (A, N, R, V) | 10 | 48% |
| Totali: | 21 | 100.00 % |

## 7.4 Projeksioni i rritjes së mbeturinave 2021 – 2026

Parashikimi i prodhimit të mbeturinave në të ardhmen lidhet ngushtë me rritjen e numrit të popullsisë në të shkuarën (Norma vjetore e rritjes në të shkuarën e llogaritur duke iu referuar tendencës së rritjes së popullsisë) si dhe prirjet për prodhimin e mbeturinave në të ardhmen.

*Table 19~~1922~~. Projeksioni i Rritjes së popullisë*

| Viti | | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Projeksioni i rritjes se popullsise | Nr popull sisë | 6970 0 | | | | | | | | |

Bazuar në dokumentet zyrtare të Republikës së Kosovës, indeksi i rritjes së popullsië parashikohet të jetë afërsisht 1% ku merret parasysh rritja e natyrshme por edhe migrimi dhe emigrimi. Në tabelën më poshtë parashikohet një trend i rritjes së popullisë dhe sasisë së mbeturinave komunale në Komunën e Vushtrrisë gjatë 10 viteve të ardhshme.

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted:** Albanian

**Formatted Table**

**Formatted:** Albanian

*Table 222225. Llojet e mbeturinave vjetore të gjeneruara në Komunën e Vushtrrisë*

| | | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Projeksioni i rritjes se popullsise<br>Nr popullsisë | Vlera referente | | | | | | |
| Potenciali I gjenerimit te sasisë totale të mbeturinave ton/vit | | | | | | | |
| Koeficienti I gjenerimit të mbeturinave për koke banori | | | | | | | |
| Fraksioni Organik | ~ 0.41 | | | | | | |
| Fraksioni të thata | ~ 0.33 | | | | | | |
| Fraksioni të tjera | ~ 0.26 | | | | | | |




*Figure 888. Rritja e sasisë së mbeturinave deri 2026 sipas fraksioneve të gjeneruara në Komunën e Vushtrrisë*[4]

Të paraqitura në diagram vërejmë tendecën e rritjes së sasisë së mbeturinave të riciklueshme sipas fraksioneve, dhe potencialin përbërës së mbeturinave totale që munden të ofrojnë në industrinë e riciklimit.

| Kontenierë për grumbullim të mbetjeve organikë 3-5 ton | | | | Me qëllim të furnizimit të njësisë për kompostim me material organik prej mbetjeve të fruta perimeve, komuna parasheh vendosjen e kontenierëve të mëdhenj në tregun e fruta perimeve apo në bisnes që ka gjenerim të kësaj kategorie të mbeturinës. Kjo ndihmon në aktivitetin e kompostimit dhe përfitimit të plehut cilësor si produkt final. | O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi<br>O.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave organike për kompostim - fraksioni organike |
| Pajisje qendrën e riciklimit dhe optimizim shërbimi | | | | Plotësimi me pajisje për zhvillimin e aktivitetit të riciklimit në qendër do të konsistojë në blerjen e shiritit asortues,pajisje për ballim, larje dhe grimcim të mbetjeve të riciklueshme sipas llojit. Kjo qendër paraprin planeve afatgjata për zgjerim të skemës së ndarjes në nivel territori komunal si potencial edhe për bashkëpunim me komunë tjetër e interesuar të zbatojë politika të ngjajshme.aktiviteti i riciklimit në shkallë të gjerë përpos se redukton kostot e transportit dhe deponimit krijon mundësinë për gjenerim të të hyrave për ndërmarjen komunale. | O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi<br>Grumbullimi dhe transportimi i veçantë i mbeturinave të vëllimshme<br>Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave të riciklueshme-fraksioni të thata |

**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%
**Formatted:** No widow/orphan control
**Formatted:** Right: 0.13", No widow/orphan control
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%
**Formatted:** Right: 0.13", No widow/orphan control
**Formatted:** Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%, Not Expanded by / Condensed by
**Formatted** ...
**Formatted:** Right: 0.13", No widow/orphan control
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...
**Formatted** ...

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Pajisje për përpunim të mbetjeve inerte | | Cmime sipas njësive të kostove | 143 000 | Plotësimi me infrastrukturë operative në deponinë për inerte ku do të bëhet trajtimi i materialit inert me qëllim rishfrytëzimin e materialeve ndërtimore dhe uljen e impaktit mjedisor prej deponimit. Në këtë qendër KRM Uniteti do të zhvillojë aktivitetin e selektimit dhe presimit të mbetjeve të riciklueshme.kjo kosto përfshin vetëm kosto të pajisjeve për zhvillim të aktivitetit në deponi. | O4: Të realizojë grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi. O.4.3 : Menaxhim i qendrueshëm i mbeturinave ndërtimore~~O.4.6 Grumbullimi dhe trajtim i veçantë i mbeturinave~~ |
| Programi per vetedijesim dhe ngritje te kapaciteteve | | | 15 000 | | |
| TotaliKostoInvestivenë202~~6~~5 | | | | | |

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: Right: 0.13", No widow/orphan control

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%, Not Expanded by / Condensed by

Formatted: No widow/orphan control

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Right: 0.13", No widow/orphan control

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: No widow/orphan control

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%, Not Expanded by / Condensed by

Formatted: No widow/orphan control

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian, Character scale: 100%

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Font: (Default) Roboto Light, 10 pt, Albanian

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

# 9. PLANIFIKIMI I MBULIMIT TË KOSTOVE

Qëndrueshmëria financiare e shërbimit të menaxhimit të mbeturinave do të mbështetet në faktorët e mëposhtëm:

1. Efektivitetin e organizimit të shërbimit,
2. Eficiencën e kostos së shërbimit,
3. Efektivitetin e monitorimit të shërbimit,
4. Sistemin e tarifimit nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit,
5. Efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e shërbimit.

Secili prej tyre është faktor kyç për të gjithë ciklin e menaxhimit financiar të shërbimit; kjo do të thotë se mbarëvajtja në lidhje me njërin mund të ndihmojë të gjithë ciklin, sikurse mos përmbushja e tij mund ta pengojë operimin e rregullt të kompanisë.

Të katër faktorët të cilët përcaktohen nga efektiviteti dhe eficiencëa, janë parime udhëheqëse të planifikimit të shërbimit të kryer në Komunën e Vushtrrisëës për vitet në vijim; kjo do të thotë se sistemi i organizimit të shërbimit, monitorimit të tij dhe i mbledhjes së të ardhurave në këtë plan janë parashikuar të sigurojnë efektivitet të ciklit të plotë të shërbimit dhe eficiencën të kostos së tij. Gjithashtu, qëndrueshmëria financiare do të varet nga aftësia e burimeve njerëzore për përmbushjen e këtyre faktorëve.

Sa i përket faktorit të katërt, një sistem tarifimi nëpërmjet të cilit mbulohet kosto e plotë e shërbimit, lidhur me këtë komuna e ka hartuar rregulloren lidhur me tarifat e aplikuara I cili mbulon vlerën e kostos së shërbimit.

Megjithatë meqënese inkasimi realizohet prej Komunës dhe Kompanisë aftësia e burimeve njërezore të kompanisë për të funksionalizuar në mënyrë efikase sistemin e tarifimit është përcaktuese për qëndrueshmërinë financiarë të shërbimit. Sipas të dhënave të ofruara shkalla e inkasimit në amviseri mundet të ndikojë në qëndrueshmërinë e shërbimit në të ardhmen.Atëherë politikë për tu adresuar për Komunen mbetet rritja e inkasimit në amviseri përmes gjenerimit të faturës dhe permbarimit te fatures sipas listës së amviserive në komunë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të dhënat e nevojshme për përllogaritjen e të hyrave në vite për subjektet pagues për shërbimin e menaxhimit të mbeturinave.

Si vit referent do të merret planifikimi ~~2019~~ 2020 dhe do të bëhen përllogaritjet sipas të dhënave të ofruara prej komunës dhe KRM Uniteti sipas numrit të amvisërive residente dhe jo residente si dhe bizneseve active në komunë dhe të hyrave të planifikuara prej shërbimit të menaxhimit të mbeturinave.

*Table 27~~2730~~. Projeksioni i të hyrave të shërbimit prej MM*

| Komuna | Klientë të faturuar = shërbyer | Klientë të shërbyer |
|---|---|---|

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

| Qyteti/Fshati | Amviseri | Bisnese | Insitucione | | Ek familjare joresidend | Bisnese Vogla-mesme-medha | | | Insituc i one | Totali në shërbim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Vushtrrisë | x | x | 164 | | x | V | M | M/I | 164 | |
| Të hyra të inkasuara prej shërbimit(vjetore) | | xx inkasim | x € | | | x | | | x | |
| Të hyra të planifikuara prej shërbimit 100% (vjetore) | x € | | x € | | x € | | | | x € | |
| % e inkasimit të tarifës së sherbimit ~~2019~~2020 | x € | x€ | x € | | | | | | | |

*Përllogaritja prej bisneseve është bërë me marzhe racionale duke llogaritur shkallën e inkasimit më shkallën e faturimit

*Table 28~~2831~~. Projeksioni i të hyrave të shërbimit/Inkasimi*

| Komuna | | | Kliente totale (te dhena prej komunes) | | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|
| Qyteti/FSHATI | | Ekonomi familjaree | Bisnese. | Insitucione | |
| VUSHTRRI | | 6x | x (referent 1x% faturim) | 195 | |
| | | x € | x*€ | x€ | |
| Të hyrat e KRM Uniteti (vjetore dhjetor 2019) | 2019 | x€ | x€ | x€ | |
| Të hyrat e KRM Uniteti | 2020 | x<br>70% | x€<br>% | x€ | |
| Të hyrat e KRM Uniteti | 2021 | x<br>80 % | x<br>85 % | x€<br>100 % | |
| Të hyrat e KRM Uniteti | 2022 | x<br>85 % | x<br>90 % | x 100% | |
| Të hyrat e KRM Uniteti | 2023 | x<br>95% | x<br>90 | x€ | |
| Të hyrat e KRM Uniteti | 2024 | x<br>95% | x<br>95% | x€ | |

Në tabelën më sipër janë paraqitur vlerat e të ardhurave të planifikuara për t'u realizuar nga tarifat e përllogaritura dhe sipas numrit të familjeve, bizneseve dhe institucioneve të vendosura në komunën e Vushtrrisë.

Referuar planifikimeve vetëm prej shërbimit të grumbullimit të mbeturinave të hyrat prej shërbimit prej vitit 201~~2~~0 do të mund të mbulojnë koston e shërbimit të grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave dhe prej vitit 2022~~1~~-~~2026~~ 2026~~5~~ KRM Uniteti siguron kapacitet me të hyra vetanake për investime capital për përmirësim të eficiencës së shërbimit. Në këtë llogaritje nuk përfshihen aktivitetet sekondare të kompanisë të cilat balancojnë financiarisht koston e shpenzimeve dhe investimeve prej kompanisë. Sistemi tarifor i aplikuar sipas rregullores komunale mundëson mbulimin e kostos së shërbimit në masën 100 % me të ardhurat nga tarifa, duke filluar që në vitin 2021~~0~~. Në fund të çdo viti, buxheti financiar i shërbimit duhet të rezultojë i balancuar, tërësisht me burime të të ardhurave prej inkasimit dhë kontrata tjera të kompanisë.

Krahas të hyrave prej tarifës së shërbimit, aplikimi I sisteme të trajtimit të mbeturinave në vitet në vijim do të synojë të zvogëlojë kostot operative të kompanisë dhe të gjenerojë të hyra përmes aktivitetit të sortimit dhe riciklimit apo kompostimit në të ardhmen. Gjithashtu vlen të ceket që drejtimi I pollitikës komunalë në menaxhim të mbeturinave do të harmonizohet me objektivat e përcaktuara prej nivelit qëndror përmes Strategjisë Kombëtare për Menaxhim të Integruar të Mbeturinave që përkojnë me reduktimin e mbeturinave sipas parimit të hiearkisë dhe zvogëlimit të ndotjes. Kjo do të nënkuptojë që kostoja e investimit do të bazohet në politikat dhe mundësitë për investim prej komunës përmes mjeteve vetanake, nivelit qëndror dhe donatorëve të huaj. Mundësitë e zhvillimit të projekteve për menaxhim të integruar të mbeturinave në nivel Rajonal do të mund të jenë favorizuese për Komunën e Vushtrrise duke synuar përmbushjen e objektivave sipas Strategjisë Kombëtare referuar politikave për reduktim dhe riciklim të mbeturinave.

Mëgjithatë, në një projeksion të përllogaritjes së gjenerimit të të ardhurave prej aktivitetit të riciklimit në nivel territorial kjo do të nënkuptonte:

*Table 29~~2932~~. Projeksioni i të ardhurave prej skemës së ndarjes në burim në nivel territorial*

| Projeksioni i rritjes se popullsise<br>Nr popullsisë | Vlera referente | x | | | | | | Cmimi referent 2019* |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Potenciali I gjenerimit te sasisë totale të mbeturinave ton/vit | | x | | | | | | |

Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted: Albanian
Formatted Table
Formatted: Albanian

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Koeficienti I gjenerimit të mbeturinave për koke banori | | x | | | | | | | |
| Fraksioni Organik | ~ 0.41 | x | | | | | | | |
| Fraksioni të thata | ~ 0.33 | x | | | | | | | |
| VLERA E SHITJES | | x | | | | | | | |

Cmimet e shitjes së materialeve të riciklueshme variojnë prej bursës ndërkombëtare sipas kërkesës së tregut. Në një përllogaritje me çmimet referente të vitit 2019 do të mund të llogaririsim çmimin për materialin plastikë (-120 euro/ton), letër ( 40 euro/ton), alumin (180 euro/ton).Sipas përbërjes në një vlerë mesatare për këtë fraksion nënkuptojmë se:

*Table 303033. Kosto referente sipas tregut të shitjes të materialit të riciklueshëm*

| Mbeturina | % | Sasia ditore sipas fraksionit | Sasia ditore | Sasia vjetore Komuna Vushtrrise | Kost o shitje Euro |
|---|---|---|---|---|---|
| | | ~ | Gjenerimi i mbeturinave për (muaj /banorë ) | (ton/vit/2020) | |
| Totali mbeturina | 100.00% | 0.83 kg/ditë | ~x kg/muaj | | |
| Organike | 40.87% | ~ 0.41 | x kg | | |
| Të riciklueshme7 | 33.24% | ~ 0.33 | x kg | | |
| Leter / Karton | 12.83% | 0.13 | x kg | | |
| Plastike | 14.78% | 0.15 | x kg | | |
| Qelq | 4.45% | 0.04 | x kg | | |
| Metale | 1.18% | 0.01 | 0xx kg | | x* |
| Te tjera | 25.89% | ~ 0.26 | ~x kg | | |

Cmimi refert i shitjes (2019) për plastikë 120 euro/ton, letër ( 40 euro/ton), alumin (180 euro/ton).

# 10. KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

## 10.1 Rregullorja komunale

Komuna e Vushtrriës posedon rregulloren komunale për menaxhimin e mbeturinave, ku përcaktohet qartë roli dhe përgjegjësia e prodhuesve dhe operatorëve të mbeturinave, me qëllim administrimin e suksesshëm të tyre brenda territorit të saj administrativ. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për administrimin vendor të mbeturinave, procedurat për trajtimin e ankesave të qytetarëve si dhe gamën e sanksioneve ndaj palëve për mosrespektim të rregullave.

Më konkretisht, meqënëse komuna synon të zhvillojë planë për administrimin e qëndrueshëm të mbeturinave dhë të funksionalizojë qendra për trajtimin e rrymave të veçanta, kjo rregullore udhëzohet që të përfshijë:

a. Standardet lokale të punës dhe cilësisë, metodologjitë dhe teknologjitë, rregullat e sigurisë dhe të shëndetit për shërbimet e pastrimit dhe të administrimit të mbeturinave;
b. Rregullat dhe detyrimet e prodhuesve të mbeturinave;
c. Sanksione në raste të dëmtimit të kontenierëve të veçantë sipas programeve për reduktim dhe riciklim, të ndryshimit të funksionit apo vendodhjes së PGM apo kontenierëve;
j. Përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të administruesve të mbeturinave sipas programëve për reduktim dhe riciklim të aplikuar prej komunës (kompania publike apo operatorë të tjerë të mbeturinave, industria e mbeturinave)

- Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorë të liçencuar;
- Përdorimi i makinerive dhe kontenierëve të përshtatshëm sipas planit për ndarje në burim;
- Përdorim i vendeve të licensuara të depozitimit dhe rregullat për depozitim;
- Regjistrimi i konsumatorëve që përfitojnë shërbime pastrimi;
- Regjistrimi I konsumatorëve që aplikojnë masa për reduktimin dhe riciklimin e mbeturinave;
- Mbajtja e të dhënave historike për mbeturina prej operatorit publik në vendlokacionet e depozitimit apo shkarkimit dhe pranimit të përkohshëm të mbetjeve të riciklueshme, vellimshme, inerte;

## 10.2 Zbatimi i rregullores dhe sanksionet

Rregullorja lokale për menaxhim të mbeturinave shoqërohet me një sërë gjobash dhe sanksionet që duhet të caktohen dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Niveli i gjobave dhe sanksioneve duhet të bazohen në shërbimin e ofruar dhe në parimin "ndotësi paguan", ku shkelësi duhet të ndëshkohet me qëllim që të merren parasysh kostot e pastrimit apo mbledhjes së mbeturinave, kostot mjedisore dhe për më tepër të krijohet një sistem i drejtë për shkurajimin dhe parandalimin e ndotësve.

Gjobat lokale duhet të vendosen nga inspektorët komunalë që janë nën juridiksionin e komunës. Përgjegjësia kryesore e këtyre inspektorëve është të vendosin sanksione për personat fizikë apo juridikë që shkelin kushtet ligjore në lidhje me mbledhjen, largimin dhe transportin e mbeturinave.

## 10.3 Licencimi mjedisor

Zbatimi me sukses i kuadrit ligjor në nivel vendi do të kërkojë përmirësime në sistemin e licencimit mjedisor, i cili përbën mekanizmin kryesor të kontrollit. Sipas legjislacionit kombëtar:

• Komunat duhet të bashkëpunojnë me nivelin qëndror kur miratojnë të ushtrojnë veprimtari apo projekt për administrimin e mbeturinave;
• Komuna duhet të marrë miratimin prej nivelit qëndror për vendet e depozitimit të mbeturinave të rrezikshme për qëllime të marrjes së lejeve mjedisore;
• Të kontrollohet vazhdimisht përmbushja e detyrimeve ligjore në veprimtaritë e administrimit të mbeturinave (përfshirë jo vetëm mbetjet urbane por edhe mbetje ndërtimore dhe të tjera jo-urbane).

## 10.4 Pjesëmarrja e sektorit privat

Ekzistojnë një sërë përfitimesh dhe avantazhesh lidhur me përfshirjen e sektorit privat në sektorin e manaxhimit të mbeturinave, sipas parimeve ku:

• Sektori privat zotëron një ekspertizë më të mirë teknike dhe akses më të madh ndaj kapitaleve financiare;
• Skemat e minimizimit të mbeturinave që kërkojnë financime në teknologji (makineri dhe kontenierë) mund të jenë shumë të përshtatshme për një bashkpunimim PPP;
• Aty ku sektori privat mund të realizojë shërbimet me standarde të njëjta apo më të mira dhe me kosto më të ulët për njësi, dhënia me kontratë e shërbimeve është një mundësi mjaft e mirë për të përmirësuar performancën e përgjithshme të shërbimeve të komunës;

Kontraktimi i shërbimeve të largimit të mbeturinave voluminoze, mbeturinave të riciklueshme apo dhënia me koncension e impianteve apo aktiviteteve për trajtimin mbeturinave, duhet të shihet si një mundësi për të tërhequr investime nga sektori privat në infrastrukturën e mbeturinave. Përfshirja e sektorit privat me anë të koncesionit apo partneritetit publik-privat duhet të nxitet si një mekanizëm për të ofruar një zgjidhje më të mirë ekonomike dhe që mund të jetë e pranueshme nga pikëpamja mjedisore.Në të gjitha situatat komuna duhet të vendosë standarte të ofrimit të shërbimit, të monitorojë performancën periodike të shërbimit të ofruar duke pasur autoritetin e plotë të penalizimit konform kontratave.

Sektori privat mund të marrë pjesë në secilën nga veprimtaritë e administrimit të mbeturinave të ngurta, siç jepet edhe më poshtë:

- Ofrimi i kamionëve apo makinerive të rënda për trajtim të mbetjeve inerte apo mbetje tjera të vëllimshme.– me qira ose marrëveshje qiraje me pronarët e pajisjeve
- Pastrimi I akseve rrugore dhe zonave pyjore për zhvillimin e aktiviteteve të trajtimit të këtyre mbetjeve – me kontratë shërbimi
- Ofrimi i kontenierëve të posaçëm për skemat e minimizimit të mbeturinave
- Funksionalizimi i qendrës së Riciklimit– me kontratë shërbimi me KRM ose koncesion

## 10.5 Mbështetja politike

Manaxhimi i mbeturinave dhe pastërtia e qytetit duhet të konsiderohen të një rëndësie të veçantë për qytetin dhe banorët e tij dhe do të kërkojë një mbështetje dhe inkurajim të fortë nga Kuvendi Komunal për të arritur objektivat e tij. Në këtë kuadër, nga njëra anë kuvendi komunal duhet të shikojë me prioritet mbështetjen e

projekteve, iniciativave lokale për modernizimin e këtij sektori, përmirësimin e buxhetit, investimet, dhe nga ana tjetër komuna duhet të sigurojë transparencën maksimale ndaj kuvendit dhe publikut për të gjitha veprimet që ajo ndërmerr.

Kjo marrëdhënie reciproke do të mundësojë paanësinë politike për çështjet që lidhen me mjedisin dhe pastërtinë e qytetit. Mbetet detyrë e stafit të komunës sipas kompetencave të drejtorisë dhe sektoreve tjerë që këtë çështje t'ia argumentojë dhe adresojë në mënyrë profesionale kuvendit komunal me qëllim marrjen e dakordësisë në miratimin e zbatimit të planeve të menaxhimit të qëndrueshëm të mbeturinave si dhe buxhetin përkatës për zbatimin e tij.

## 11. NDËRGJEGJËSIMI PUBLIK

Për të siguruar mirëfunksionimin e sistemit të manaxhimit të mbeturinave, rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve si dhe sigurimin e pastërtisë në qytet, është shumë i domosdoshëm përfshirja dhe ndërgjegjësimi i komunitetit. Komuniteti jo vetëm duhet të kuptojë fuksionimin e sistemit, por duhet ta mbështesë atë. Suksesi i çdo skeme riciklimi bazohet plotësisht nga mbështetja e qytetarëve. Konsumatorët si : familjet, bizneset apo institucionet, në sajë të një fushate të të vazhdueshme ndërgjegjësimi mund të ndikojnë në përmirësimin e sistemit të mbledhjes, duke zbatuar kërkesat të hedhjes dhe ndarjes së mbeturinave dhe duke penguar materialet e padëshirueshme (psh. mbetjet e rrezikshme), të

hyjnë në rrjedhën e mbeturinave të mbledhura. Ndërgjegjësimi publik ndaj çështjeve të mbeturinave dhe pastërtisë së qytetit, konsiderohet si një prioritet dhe objektiv primar krahas objektivave të tjerë që lidhen me infrastrukturën apo me depozitimin e sigurtë të mbeturinave.

Ka disa mënyra për të rritur ndërgjegjësimin publik për çështjet e mbeturinave dhe për të dhënë informacion se si mund të trajtohen ato, me një kosto relativisht të ulët, por mjaft efektive për arritjen e objektivit. Kjo mund të arrihet duke hartuar një plan ndërgjegjësimi i cili do të mundësojë: i) ofrimin e një informacioni të përgjithshëm dhe të veçantë për publikun në lidhje me nismat e komunës të mbledhjes, riciklimit të mbeturinave, pastërtisë së qytetit dhe kostos së shërbimit të menaxhimit të mbeturinave; ii) ndërgjegjësimin e publikut për detyrimet ligjore, rregullat dhe detyrimet vendore; ii) nxitjen e qëndrimit miqësor ndaj mjedisit.

## 11.1 Metoda për komunikim dhe informim

Metodat më të përdorura të komunikimit të informacionit janë broshurat, artikujt në gazeta, njoftimet, dhe reklamat në TV dhe radio lokale, dhe fletëpalosje që shpërndahen në shkolla. Një zhvillim të lartë sot në vend ka edhe teknologjia e informacionit si edhe aksesi në internet. Kjo teknologji si edhe tërheqja pas rrjeteve sociale të komunitetit (kryesisht atij në moshë të re) mund te jetë një mundësi e mirë për komunikimin dhe informimin e publikut për shkak edhe te kostos së ulët si edhe shpejtësisë që ofron. Gjithashtu mund te shfrytëzohen dhe evente të karaktereve të ndryshme (festa, tubime, koncerte), ku ka grumbullime të mëdha njerëzish dhe ku informi dhe komunikimi me publikun bëhet më i lehtë.

Në programet e riciklimit apo minimizimit të mbeturinave metoda më e mirë është ajo "derë më derë". Kjo metodë fton konsumatorët në nismat e riciklimit dhe kompostimit, për të përmirësuar qëndrimin e tyre ndaj ndarjes së mbeturinave në burim, për të zbatuar rregullat dhe respektuar oraret. Banorëve dhe bizneseve iu shpërndahen fletë informative për llojet e mbeturinave që mund të riciklohen, kompostohen dhe mënyrën se si ato duhet të veprojnë për t'u bërë pjesë e procesit.

Përdorimi i kompatatorëve apo makinave të tjera që shërbejnë për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave apo kontenierët për informim mbetet një detaj tjetër I cili përmban impact vizuel për qytetarë. Tek të gjithë makinat dhe nëse është e mundur tek kontenierët e mbeturinave duhet të shkruhet qartë dhe lehtësisht e lexueshme një slogan domethënës për të mbajtur pastër zonën, numrin e telefonit të ofruesit të shërbimit si dhe numrin e telefonit falas që caktohet nga autoritetet vendore, sipas një formati të miratuar paraprakisht.

## 11.2 Pjesëmarrje qytetare

Një çështje tjetër e rëndësishme është krijimi i mekanizmave për marrjen e mendimeve dhe reagimit të qytetarëve: si mund të ftohet publiku t'i japë institucioneve komunale mendime apo opinione ose komente për shërbimin e mbeturinave.

Dy metodat kryesore për të marrë mendimin e publikut janë:

Mundësia e publikut për t'u ankuar: komuna apo operatori i shërbimit duhet të ketë zyrën e kontaktit/informacionit për të marrë ankesat. Numri i ankesave dhe zgjidhja e tyre është një nga parametrat e matjes së performancës së institucionit lidhur me menaxhimin e mbeturinave.

Vlerësimi i kërkesës dhe sondazhi/studimi i "vullnetit për të paguar": Për të vlerësuar kërkesën, vullnetin dhe mundësinë për të paguar, është e nëvojshme të komunikohet me përfituesit e mundshëm të

shërbimit lidhur me alternativat e shërbimit, kostot, buxhetin dhe tarifat. Për secilën zonë të komunitetit apo zonë për t'u përfshirë në sondazh, mostra që duhet të realizohet është midis 100 dhe 200 të intervistuar. Kjo praktikë duhet të kryhet në periodikisht nga komuna, ose sa herë ajo e shikon të arsyeshme për të marrë opinionin e publikut në lidhje me vlerësimin e performancës të shërbimit.

## 12. PLANI I VEPRIMIT

Formatted: Font: Not Bold, Albanian

Formatted: Albanian

| Objektivi Strategjik | Veprimet e parapara | Përgjegjesitë | Afatet kohore | Implikime financiare |
|---|---|---|---|---|
| 1. Të optimizojë shërbimin e grumbullimit dhe largimit të mbetjeve në mënyrë të unifikuar që garanton optimizimin e kostove dhe shërbimit në komunën e Vushtrrisë. | 1.1. Sigurimi i kontejnerve për 1500 amviseri rezidente në zonat urbane dhe rurale | Komuna Vushtrri, Kuvendi komunal | 2022~~1~~ | 27,000 € |
| | 1.2. Përgaditja e listave të amvisërive për furnizimin me kontejner | Kompania Uniteti | | |
| | 1.3. Informimi publik i amvisërive për furnizimin me infrastrukturë | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | | |
| | 1.4. Shpërndarja e kontejnerëve nëpër amvisëri | Kompania Uniteti | | |
| 2. Ndarjen e mbetjeve në burim për grumbullimin e diferencuar dhe reduktimi i mbetjeve nëpërmjet riciklimit dhe kompostimit | 2.1. Sigurimi i kontejnerëve për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme | Komuna Vushtrri, Kuvendi komunal | 2022~~1~~ | 17,000 € |
| | 2.2. Caktimi i zonës pilot me 300 amvisëri për nisjen e ndarjes së mbeturinave të riciklueshme në burim | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | | |
| | 2.3 Përfshirja e të gjitha institucioneve shkollore në procesin e ndarjes.<br>2.3.1 Krijimi i klubeve ekologjike në shkolla | Komuna Vushtrri | | |
| | 2.4 Zhvillimi i kampanjes së vetëdijesimit dhe inrmimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | | |
| | 2.5 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim<br>2.5.1 Monitorimi i procesit të riciklimit | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | | |
| | 2.6 Sigurimi i kamionit të vecant për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2023~~1~~ | 30,000 € |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2.7 Përcaktimi i lokacionit për deponim dhe trajtim të mbeturinave të riciklueshme<br>2.8 Zgjidhja e formes dhe sigurimi i tregut për shitje të mbetjeve të riciklueshme | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2022~~1~~ | |
| | 2.9 Rregullimi i lokacionit për trajtimin e mbetjeve te riciklueshme<br>2.9.1 Sigurimi i pajisjes për paketimin e mbetjeve te riciklueshme<br>2.9.2 Sigurimi i shiritit për selektimin e mbetjeve te riciklueshme | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2022~~0~~-2025~~3~~ | 30~~45~~0,000 € |
| | 2.10 Përcaktimi i zonës së dytë për zgjerim në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme<br>2.10.1 Zhvillimi i kampanjes së vetëdijesimit dhe inrmimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim<br>2.10.2 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim<br>2.10.3 Monitorimi i procesit të riciklimit | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2022 | 20,000 € |
| | 2.11 Përcaktimi i zonës së dytë për zgjerim në ndarjen e mbeturinave të riciklueshme<br>2.11.1 Zhvillimi i kampanjes së vetëdijesimit dhe inrmimit për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në burim<br>2.11.2 Shpërndarja e kontejnerëve për riciklim | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2023-2025 | 78,400 € |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2.11.3 Monitorimi i procesit të riciklimit | | | |
| 3. Të garantoje grumbullimin në masën maksimale të sasisë se mbetjeve të gjeneruara brenda territorit të komunës | 3.1 Caktimi i zonës pilot për nisjen e ndarjes së mbeturinave organiike në burim<br>3.1.1 Zhvillimi i kampanjes së vetëdijesimit dhe inrmimit për ndarjen e mbeturinave organike në burim<br>3.1.2 Shpërndarja e komposterëve<br>3.1.3 Monitorimi i procesit të kompostimit | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2023 | 25,000 € |
| | 3.2 Zgjerimi i zonës për kompostim | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2024-2025 | 48,550 € |
| | 3.3 | | | |
| | | | | |
| 4. Të realizojë Grumbullimin, transportimi dhe ndarja e mbeturinave të veçanta me qëllim të eliminimit të rrezikut nga to, trajtimit të veçantë dhe zvoglimit të sasisë që përfundon në deponi | 4.1 Rethimi i lokacionit për mbetje inerte | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2023~~1~~ | 121,000 € |
| | 4.2 Rregullimi i rruges për qasje në deponine inerte | | | |
| | 4.3 Eleminimi i mbetjeve inerte sipas raportit 2019-2020 | | | |
| | 4.4. Sigurimi i infrastruktures për përpunimin e mbetjeve inerte | Komuna Vushtrri, Kompania Uniteti | 2022-2023 | 293,000 € |
| | 4.5 Mirëmbajtja e lokacionit | Kompania uniteti | | |
| | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 5. Të realizojë në mënyrë graduale dhe në përputhje me parimin “ndotësi paguan” mbulimin e kostos së shërbimit nga të ardhurat prej tarifës<br>5.1 Mbulimi i kostos nga të ardhurat prej tarifës së shërbimit<br>5.2 Rritja e mbledhjes së të ardhurat prej tarifës së shërbimit | | | | |
| | | | | |
| | | | | |

Komuna Vushtrri

2021

# PROCESVERBAL

Mbajtur nga takimi – diskutimi publik i PKMM me kryetarët e këshillave të fshatrave dhe akterët tjerë të interesit më datë **11.2.2022** nga ora **10:00-11:00** në sallën e kuvendit komunal të Komunës së Vushtrrisë.

**Rendi i ditës**: Plani 5-vjeçar për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.
Në takim morën pjesë: Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike- Benjamin Shala dhe anëtarët e grupit punues Mentor Jashari dhe Islam Latifi.

Takimin e hapi drejtori i DSHP-së Benjamin Shala duke theksuar se do ta shpalosim planin 5-vjeçar për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

**z. Islam Latifi kryesues i grupit punues**: Përshëndetje për të gjithë dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen:
Ju informoj se grupi punues thuajse në këtë përbërje para 5 viteve ka prezantuar Planin Komunal Pesëvjeçar, ndërsa është ballafaquar me skepticizëm për realizimin e këtij plani ambicioz, duke ngritur dilema për shkak të mungesës së kontejnerëve familjar dhe për pamundësinë e shtrirjes së shërbimit në të gjithë territorin e komunës. Mirëpo edhe pas shumë vështirësive që kemi pasur gjatë procesit të implementimit të reformës mendoj që kemi arritur një sukses të mirë, duke implementuar suksesshëm Planin Operativ të ndërmarrjes.
Me kryetarët e këshillave të fshatrave arritëm të shpërndajmë kontejnerët nëpër të gjitha ekonomitë familjare dhe gjithashtu kemi arritur që nga plani i kaluar (2016-2021) rreth 1300 ekonomi familjare të pajisim me kontejnerë për ndarjen e mbeturinave të cilat mbeturina dërgohen në qendrën për paketim e cila gjendet në fshatin Bukosh.
Me planin e ri komunal PKMM 2022-2026 synojmë të arrijmë zvogëlimin e sasisë së mbeturinave që deponohen në mënyrë që rrisim afatin e deponis, dhe kjo do të bëhet e mundur me ndarjen e mbetjeve të riciklueshme dhe riciklimin e tyre.
Mbulushmëria me shërbim ka mundësuar eliminimin e deponive ilegale ku nga 70 deponi ilegale sa ishin në 5 vitet e kaluara, kemi arritur që me suksese ti eliminojmë shumicën prej tyre dhe aktualisht kemi më pak se dhjetë deponi ku dy prej tyre janë me koncentrim të një sasie të madhe të mbetjeve të deponuara me vite.

**Ismail Haziri - Kalaja**: Ky plan është i pranueshëm dhe ju falënderoj për punën të cilën e keni bërë, kërkojë që me vigjilencë të mirëfilltë që të mos ketë probleme dhe të inspektohet i gjithë ky projekt.
Mendoj se duhet të ketë me shume gjoba ndaj atyre të cilëve nuk i respektojnë ligjin për mbeturina.
Problematik tjetër që duhet të veçohet është edhe mos marrja e Hirit, si dhe mbetjet inerte.
Po ashtu edhe inspektoret duhet të jenë më të angazhuar në parandalimin e deponive ilegale.
**Shemsi Uka**: Përshëndet të pranishmit, në krahasim me qytetet tjera mund të them se jemi shumë mirë në menaxhimin e mbeturinave.

Që shërbimi të jetë në nivelin e duhur edhe ne si përfaqësues të fshatrave dhe bashkësive lokale duhet ta ndihmojmë këtë proces apo reformë.
Në fshatin nga vi unë Akrashticë jemi të kënaqur me punën e bërë nga Komuna e Vushtrrisë për grumbullimin e mbeturinave.
Skepticizmi i fillimit ka rezultuar i pasaktë, jemi të kënaqur me efikasitetin dhe punën që është bërë dhe vazhdon të bëhet.
Kërkoj gjithashtu që personat me aftësi të kufizuar të lirohen nga pagesat.

**Rrahim Ajeti**: Përshëndet të pranishmit, vërejtje për grupin, materiali është dashur të shpërndahet më herët, grumbullimi i mbeturinave është bërë në mënyrë shumë të mirë, nuk kemi ankesa, bashkëpunimi duhet të jetë edhe më i mirë në mes policisë, komunës dhe qytetarit. Kërkesa që punëtorët e Unitetit të marrin shpërblim nga Komuna e Vushtrrisë për punën që bëjnë, ata janë heronj.

**Zekri Muzaqi**: Propozoj që të gjitha xhamitë të furnizohen me kontejnerë.

**Ali Zeqiri:** Në bazë të ligjit dhe kuotës për Hendikos të rritet numri i punëtorëve për pastrimin e qyteteve dhe punonjësi të jetë nga shoqata Hendikos - Vushtrri.

-Përgjigjet në pyetjet dhe çështjet e ngritura nga të pranishmit i japi udhëheqësi i grupit punues Islam Latifi.

Mbajtësi i procesverbalit:
**Qemail Hasani**

_________________

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova-Republik of Kosovo
**Komuna e Vushtrrisë**
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri

**Drejtoria per Sherbime Publike**

Datë: 11.02.2022

**Regjistri i Pjesëmarrësve**

| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Vendi | Nr. i telefonit | Nënshkrimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ismail Haziri | Vushtrri | 044960363 | |
| 2 | Behar Duraku | Stroc | 049630868 | |
| 3 | Ramiz Maxhuni | Beqic | 044 - 891 . 911 | |
| 4 | Sefet Ahmeti | Unitet - Vushtrri | 044 1213 286 | |
| 5 | Muhtar Kastrati | Unitet - Vushtrri | 044 312 160 | |
| 6 | Rrahim Ajeti | Stanoc i Poshtëm | 044-503 000 | |
| 7 | Zekri Muzaqi | Brusnik | 044-559-457 | |
| 8 | Ali Zeqiri | Fsh: Vërnicë | 044 - 979 526 | |
| 9 | Bajram Bajgini | Vushtrri | 044 - 196 814 | |
| 10 | Malig Ferizi | Pestovë | 049 - 115 - 554 | |
| 11 | Shemsi Ukaj | Akrashticë | 044 - 192 - 350 | |
| 12 | Sevdaim Sadiku | Bukosh | 049 - 618 712 | |
| 13 | Remzi Hasani | Smrekovnicë | 045 361 207 | |
| 14 | | | | |
| 15 | | | | |
| 16 | | | | |
| 17 | | | | |
| 18 | | | | |
| 19 | | | | |
| 20 | | | | |

Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

| | |
|---|---|
| **Datë:** | **14 shkurt 2022** |
| **Për:** | **KPF Dhe KK** |
| **Nga:** | **Dr. Nexhmedin Rashica** ____________<br>**Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale** |
| **Lënda:** | **Informatë** |

Të nderuar,

Bashkangjitur e gjeni raportin e punës për periudhën Janar-Dhjetor 2021, për të gjitha shërbimet e ofruara nga Q.K.M.F-ja Vushtrri.

Faleminderit për bashkëpunim!

QKMF GKMP MFIH
"Dr. Safet Idrizi"
Nr. 176
Data 14.02.2022

**_Komuna e Vushtrrisë_** **_Q.K.M.F Vushtrri_**

| | |
|---|---|
| ***Data/Date/Datum*** | ***Shkurt 2022*** |
| ***Për/To/Za*** | ***Dr.Nexhmedin Rashica – Drejtor i DSHPS-së*** |
| ***Nga /From/Od*** | ***Dr.spec.Abdullah Vojvoda Kryes i Punës Drejtor i QKMF-Vushtrri*** |
| ***Lënda/Subjekt/Tema*** | ***Raport pune për vitin 2021 Janar- Dhjetor*** |

# QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE '' DR.SAFET IDRIZI '' NË VUSHTRRI

# (QKMF)-VUSHTRRI

I nderuar drejtor i DSHPS-së,

Dr.Nexmedin Rashica

Shëndetësia në Republikën e Kosovës është e organizuar në tri nivele, Kujdesi parësorë, Dytësorë dhe Tretësor.

Kujdesi Parësorë Shëndetësor është realizuar konform dispozitave Ligjore të ligjeve në fuqi.

Në fillim të vitit 2020 është paraqitë virusi Covid 19 në Wuhan të Kinës dhe i rezikëshëm për shëndetin e popollatës e sidomos për grup moshat më të mëdha që kanë sëmundje të rënda dhe shoqëruese, pacientët me imunitet të dobët etj. Tani pas zbulimit të vaksinës ky virus ka filluar të vihet nën kontrollë.

Në Kosovë rasti i parë paraqitet më datë 13.03.20 ndërsa në komunën e Vushtrrisë rasti i parë është paraqitë më datë 24.03.20, si komunë jemi atakuar nga virusi që nga fillimi i Pandemisë në Kosovë.

Gjendja ishte e rëndë për ne si staf shëndetësor edhe menaxhues pasi që ishte virus krejt i panjohur për ne dhe më gjërë, e kjo na shkaktoi shumë vështirësi sidomos në fillimin e

Pandemisë. Jemi përpjekë si menaxhment që nga fillimi i vitit 2021 në bashkëpunim me DSHPS-në dhe IRSHPK Mitrovicë kemi njoftimet zyrtare se duhet të jemi gati për përballje me virusni me infeksionin që e shkaktonë si dhe udhëzimet nga IKSHPK dhe M.SH që ikishin siguruar nga OBSH dhe dinamika u zhvillue në formën “tu pa, tu Ba”.Në krejtë këtë përpjekje kemi pasë përkrahje nga Kryetari i Komunës dhe DSHPS për nevojat e Institucion Shëndetësor pasi do ishim në ballë të kësaj Sfide të panjohur. Për fat asnjëherë nuk kemi pasë shumë vështërsi për paisje mbrojtëse si veshmbathje, maska, dorza, dezinfektues për duar dhe hapësirën ku punojm e ofrojm shërbime shëndetësore. Plotësimi këtyre nevojave ose kushteve ju ka mundësuar personelit shëndetësor më shumë siguri në ofrim të shërbimeve ndërësa për pacientët siguri në marrjen e shërbimeve në institucion. Ministria e Shëndetësisë na ka ndihmuar me udhëzues klinik, çarkore informative, material tjetë informues, si dhe me pastaj me material dhe paisje mbrojtëse siç janë veshmbathje, maska, dorza, dezinfektues etj. Po ashtu jemi ndihmuar me staf shtesë mjek |infermier nga M.Shëndetësisë pasi që më herët i kemi njoftuar me kërkesë zyrtare se kemi mungesë stafi edhe për kushte normale e jo më edhe gjatë Pandemisë. Stafi shëndetësor dhe ndihëmës nën organizimin e përkushtuar të menaxhmentit ka bërë punë të mirë edhe pse ka pasë shumë vështirësi herë pas here kur kemi pasë infeksion të stafit dhe është dashtë që të vetizolohen, në këto raste kemi pasë ngarkesa për stafin që ka qenë në punë, e ndojë rast ka mund të jetë abuzim apo neglizhencë e stafit me të cilën jemi marë dhe e kemi sanuar. Duke i dhënë rëndësi gjendjes së përgjithëshme dhe duke dashur të shifet se si respektohen udhëzimet menaxher si udhëheqës i qendrës i kam dhënë rëndësi që vet të dalë në qendrat shëndetësore të jap udhëzimet dhe më pas të monitoroj sa aplikohen këto rekomandime.

QKMF së gjithësejt janë vetëm 205 punëtor. Për fat të mirë shumica e stafit e ka kaluar pa shumë vështirësi këtë infeksionin, një numer i vogël i tyre ka pasë një gjendje më të rëndë shëndetësore, dhe për fat të keq njëri nga kolegët tanë nuk ja doli që të kaloi këtë infeksion. Shëndetësia e Vushtërrisë humbi nga Covid 19, një profesionist të shkëlqyer siç ishte dr.Safet Idrizi.

Në në QKMF Vushtrri kemi qenë për fat të mirë nga fillimi i Pandemisë të përgaditun me material mbrojtës për stafin shëndetësor si veshmbathje, maska e dorza, material dezinfektues, kishim një donacion me herët në të cilin ka pasë material shpenzues mbrojtës për fillim deri sa filluan furnizimet nga M.Sh. Poashtu kemi bërë shumë blerje nga buxheti i QMF-së për nevoja të institucionit dhe sa i përketë mbrojtjes së personelit nuk e kemi pasë këtë shqetësim për dallim me disa komuna tjera. Gjatë vitit 2021 kishim njohuri për virusin dhe ishim të përgaditur për një Pandemi të tillë. Personeli shëndetësor dhe ai ndihmës ka qenë i angazhuar dhe ka dhënë një kontribut të qmueshëm në kryerjen e shërbimeve të qytetarve për gjithëçka që patën nevojë, si për transportin e tyre në kl.infektive dhe anasjelltas, vizita në shtëpi, për fillim edhe terapi simptomatike që mjeku e ka ordinuar gjatë vizitave dhe shërbime mjekësore në shtëpitë e pacientëve.

## GJENDJA SHËNDETËSORE E POPULLATËS

Komuna e Vushtrrisë është një komunë me një popullatë relativisht të re dhe të shëndoshë. Kujdesit Parësor Shëndetësor (KPSH) implementohet përmes konceptit të Mjekësisë Familjare, që është shtyllë e sistemit shëndetësor ofron shërbime të qasëshme dhe cilësore për qytetarët e komunës, këto shërbime shëndetesore janë gjithë përfshirëse për qytetarë pa dallim feje, etnie, gjinie, race etj. Promovon edukim shëndetësor përmes fushatave parandaluese në komunitet, vizita mjekësore dhe shërbime të shumta shëndetësore që dalin nga këto vizita. Imunizim dhe vaksinim të rregullt për fëmijët dhe nxënësit, vaksinim për të moshuarit dhe të tjerët që kanë nevojë, kujdesë dhe edukim për nënën e fëmijën deri në moshën 3 vjeç, vizita shtëpiake për pacientët me sëmundje te rënda dhe ata në gjendje terminale i cili ofrohet përmes një bashkpunimi Komunë – Islamik Relief. Një bashkpunim i mirë e funksional që e ka ndihmuar shumë pacientin me vizita në shtëpi dhe familjet e tyre shpresojmë të vazhdoi si projekt sepse është shumë kosto efektiv për familjen dhe shoqërinë. QKMF Vushtrri ofron edhe shumë shërbime tjera si transporti i pacientëve për të bërë Dializën në Mitrovicë, transportimi i pacientëve të palevizëshem në rast fatkeqësie apo të ngjashëm deri në kujdesin sekondar/terciar shëndetësor e që e ndihmon pacientin dhe familjen e tijë - komunitetin në përgjithësi.

Edhe për kundër që viti 2021 ishte vit i vështirësive me Pandeminë SARS COV 2 si institucion kemi ofruar të gjitha shërbimet që i kemi ofruar edhe më herët, por me një redukim të ndjeshëm për t'i mbrojtur pacientët nga ekspozimi në virusin Covid 19.

### Shërbimet shëndetësore të ofruara në QKMF Vushtrri gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitin 2021 në të gjitha institucionet shëndetësore të KPSH e që implementohen nga QKMF Vushtrri jane vizituar gjithësejt 232.462 pacientë dhe janë dhënë 1052716 shërbime. Nga numëri i përgjithëshëm i pacientëve që kanë mar shërbime te ne kanë qenë të referuar në kujdesin e specializuar dytësor dhe tretësor 7.856 pacient.

Gjatë vitit 2021 janë dhënë 1052716 shërbime shëndetësore për qytetarët tanë dhe më gjërë, shërbime të cilat kanë ndihmuar në përmirësimin e gjendjes shëndetësore pacientëve të sëmur.

Gjatë këtijë viti janë realizuar të hyra vjetore 57188.50 €uro e në krahasim me vitin paraprak 2020 kemi rritje prej 28743.50 €uro. Në shërbimin shëndetësor Publik ka gjithashtu shumë kategori të pacientëve që lirohen nga bashkpagesa sipas UA/2007, të gjitha këto kanë ndikim në

të hyrat tona . Me gjithatë jemi shumë të kënaqyr me shërbimet që janë ofruar nga institucioni yn për pacientët e sëmur të të gjitha kategorive pa dallim.

Të sëmurët kronik që janë vizituar në QKMF gjatë vitit 2021 gjithësejt janë 14.385, vizita shërbimet shëndetësor në shtëpi përmes ekipeve të terenit që është bashkpunim Komunë/Islamik Reliev. Pacient me sëmundje malinje, sëmundje kronike mbi 65 vjeç, lehonat, shtatëzanat gjatë vitit 2021 janë vizituar dhe kanë marë shërbime 26551 pacient,shumica nga ta përmes ekipeve së terenit që ka funksionuar mirë dhe i ka ndihmuar shumë qytetarët gjatë Pandemisë- pacientët dhe familjarët e tyre janë shumë falenderues.

KPSH (Kujdesi Parësor Shëndetësor) ofrohet përmes QKMF-së e cila ka për detyrë të implementoi konceptin e mjekësisë familjare në komunën e Vushtrrisë, ky koncept duhet të implementohet nga menaxhmentit i QKMF-së, stafi shëndetësor e me ndihmën e DSHPS dhe komunitetit. Implementimi i konceptit të mjekësisë familare nuk është i lehtë nevoitet angazhim i të gjithëve sepse deri sa të bëhet implementimi i plotë i këtijë koncepti ka sfida të shumta, e që për komunitetin nuk janë fillimisht të pëlqyeshme dhe shpesh hasim në rezistencë pasi që reformat gjithëmonë hasin në vështërësi. Pasi që në vazhdimësi kemi përmirësim të infrastrukturës së objekteve shëndetësor do jetë më i lehtë implementimi i këtijë koncepti. Pacientit që kërkon shërbime shëndetësore në QKMF duhet që të i sigurohet qasje sa më e lehtë në këto shërbime dhe duke pasë parasysh gjithmonë cilësinë e shërbimeve shëndetësore për pacientin. Implementimi i konceptit të M.F është shumë i rëndësishëm për pacientin pasi mere shërbime në afërësi të vendbanimit të tijë e të garantura me ligj dhe të specifikuara UA për KPSH 04/2020 i hartuar nga grupet punuese në M.SH. Shërbimet shëndetësore që ofrohen në QKMF duhet të jenë gjithëpërfshirëse pa dallim race, etnie, gjinije, moshe, feje dhe për grupet e cënushëme.

QKMF ka në përbërjen e sajë këto Departamente;

- D. Mjekësisë Familjare
- D. Administratës ,
- Barnatorja Qëndrore

- Departamenti i Mjekësisë familjare

Në QKMF ofrohen vizita dhe shërbime mjekësore si : tretmani, infuzionet, lidhëtorja, këndi i inahlimit dhe i rehidrimit, vaksinimi, vizita dhe edukim shëndetësor në teren për nënën dhe fëmijën deri në 3 vjet, vizita dhe shërbime stomatologjike bazike dhe shërbime tjera që janë në kuadër të KPSH . Përshkak të pandemisë numëri i pacientëve që kanë kërkuar vizita dhe shërbime gjatë këtijë viti ka qenë më i vogël në në të gjitha qendrat shëndetësore. Kjo mund të jetë si pasojë e frigës nga infeksioni, respektimi i udhëzimeve që pacientët të paraqiten tek mjeku vetëm kur e kanë shumë të nevojshme apo edhe respektimi i udhëzimeve që dalin nga IKSHPK-Prishtinë siqë janë mbajtja e maskës, hixhenës së duarve dhe distancës fizike.

Në QKMF dhe QMF 1 punohet nga ora 07 $^{h}$deri në ora 20$^{h}$ cdo ditë pune , ndërsa dita e shtunë dhe e dielë mbulohet nga mjeku kujdestar, kujdestaria është 12 orëshe nga ora 07 në mëngjes e deri në ora 19 në mbrëmje.

Në QMF 1 kemi edhe tri ordinanca që ofrojn shërbime vetëm për pacientët Covid + të cilët vizitohen nga mjeku apo shërbime të ordinura nga mjekët gjatë vizitave të tyre në institucionin tonë apo diku tjeter . Këto Vizita dhe shërbime ofrohen ndaras nga pjesa tjetër e pacientëve të zakonshëm.

Në QMF 2 dhe QMF 3 punohet nga ora 07 deri në ora 14 çdo ditë pune ofrohen shërbimet shëndetësore sipas udhëzimit për QMF nga M.SH..

Në disa nga QMF-të që funksionojn në viset rurale kemi ofruar vetëm këshllim për pacientët nga infermierja e cila ka qenë prezente çdo ditë pune. Ndërësa stafi mjekësor ka qenë i involvuar në punë në QKMF dhe QMF 1, mbështetje për stafin mjekësor që ka ofruar vizita dhe shërbime për pacientët e dyshuarit apo të infektuar me Covid 19.. Në qendrat shëndetësore me numër të madh të pacientëve ka punuar edhe mjeku që ka kryer vizita dhe shërbime si në QMF Lummadh, QMF Smrekonicë dhe QMF Pantinë.

Në AMF –të cilat gjenden në viset më të thella rurale ka punuar vetëm infermierja e cila ka këshilluar pacientët se si të mbrohen nga Covid 19 ,dhe nëse kanë nevojë që të vizitohen nga mjeku janë udhëzuar në njërën nga QMF –të më të afërme .

Shërbimi i Urgjencës- Gjatë vitit 2021 në këtë shërbim janë vizituar gjithësejtë 34134 pacient dhe janë dhënë 166.867 shërbime shëndetësore, edhe në Urgjencë vizitat e shërbimeve si rezultat i Pandemisë COVID 19. Urgjenca punon $24^{h}$ pa ndërprerë me katër ekipe që punojn me ndërrime $12^{h}$ orëshe. Në këto ekipe janë të angazhuar 5 mjek dhe 17 infermier. Aty realizohen vizita dhe shërbime mjekësore gjatë këtijë viti shërbimi të gjithë punëtorët e QKMF.

Shërbimi i shëndetit Oral- Gjatë vitit 2021 në stomatologji janë vizituar gjithësejt 9.015 pacient dhe janë dhënë 42.542 shërbime. Punohet nga ora $07^{h}$ deri në ora $20^{h}$ në QKMF dhe në QMF1. Ndrësa në QMF2- 2 herë në javë ( e martë e enjëte) nga ora $7^{h}$ deri $14^{h}$ dhe çdo ditë pune në QMF 3 nga ora $07^{h}$ deri në ora $14^{h}$, në QMF Pantinë, dhe në QMF Lum madh dy herë në javë nga ora $07\text{-}14^{h.}$.

Kujdestaria javore mbahet në QMF 1 ditën e shtunë nga ora $07^{h}$ deri në ora $19^{h}$ , përshkak të kosto-efektivitetit nuk ofrohen shërbime stomatologjike $24^{h}$, pasi që gjatë orarit të kujdestarisë mund vetëm që të ndalim dhimbjen e jo ndonjë shërbim tjetër.

RTG e dhëmbit – QKMF nga ora $07^{h}$ në ora $13^{h.}$ çdo ditë pune, gjatë vitit 2021 në këtë shërbim janë vizituar 838 vizita dhe janë dhënë 1779 shërbime për pacientët që kanë pasë nevojë për imazhe imazherike dhe me to janë drejtuar tek stomatologu.

Sektori i Shëndetit Publik – është përgjegjës për imunizimin dhe vaksinimin e qytetarëve dhe për Sistemin Informativ Shëndetësor në QKMF . Ky sektor e përcjell gjëndjen epidemiologjike të popullatës në bazë të raporteve të personelit shëndetësor që raportohen në IRSHP Mitrovicë dhe pas një analize të këyre raporteve, ato kthehen tek ne me rekomandime. Në rast të dyshimit për epidemi apo ndonjë sëmundje infektive që bartë pasoja të rënda për qytetarët në bashkpunim me institutin regjional të Mitrovicës dalin në teren për ta hetuar gjendjen dhe marin masa konform situatës. Pandemia COVID 19 është menaxhuar nga IRSHP Mitrovicë bashk me QKMF dhe është udhëzuar dhe mbikqyrë nga IKSHPK Prishtinë.Në QKMF Vushtrri përkundër Pandemisë nuk kemi pasë ngecje në vaksinimin e rregullt e as në vaksinimin sezonal, me një organizim të mirë të stafit të vaksinimit dhe ndihmës nga pjesa tjetër e mjekësisë familjare e me mbështetje të menaxhmentit duke siguruar transportin me kohë dhe mbështetje tjetër në organizim, është arritë që të vaksinohen të gjithë ata që kanë qenë të planifikuar për vitin 2020 përkundër që ishim në Pandemi e edhe kjo na dallon nga komunat tjera që kanë mbet pas në vaksinim. Gajtë vitit 2020

përshkak të Pandemisë dhe mësimit ONL. Nuk kemi mund ti realizojm vizitat sistematike që janë bërë cdo vit nga viti 2015, shpresojm që të kthehemi në gjendje zakonshme dhe të i kryejm edhe vizitat sistematike si vitet më përpara edhe pse do jetë hendikep mungesa e dr.Safetit i cili që në fillim ishte përgjegjës për organizimin e vizitave sistematike për nxënës.

Vaksinimi në QKMF -Vushtrri është ndër më të mirët në Kosovë dhe ka një përqindje të realizimit prej 95.0 % të planit vjetor. Imunizimi është një bazë e mirë për preventivën e sëmundjeve që më herët kanë qenë prezente në Kosovë e rajon dhe të cilat kanë shkaktuar ndërlikime që mund dërgojn në invaliditet apo vdekje fëmijët e prekur nga infeksionet virale dhe bakteriale. Rol të rëndësishëm ka promovimi shëndetësor,edukimi dhe vetdijësimi i popullatës për rolin vaksinimit për familjen dhe shoqërinë në përgjithësi. Ashtu si tani edhe më herët ka pasë konspiracione për vaksinat , për këtë arsye një pjesë e prindëve hezitojn por për fat është numër i vogël i tyre.Të gjitha rastet kur prindin nuk lejon vaksinimin e fëmijës raportohen në IRSHP Mitrovicë dhe në IKSHP Prishtinë.

QKMF në Vushtrri ka caktue vendet ku do të vaksinohen qytetarët me vaksinën kundër virusit Covid-19 gjë që nga muaji Mars 2021 deri më 31.12.2021 janë vaksinuar me dozë të parë 35591 pacient, me dozë të dytë 32152 pacient dhe me dozë të tretë janë vaksinuar 1135 pacient, në total janë dhënë 68878 doza të vaksinave.

Janë dhënë 2384 doza të vaksinave të gripit sezonal.

Njësia e SISH-it nuk funksionon kënaqëshëm pasi që platformat e zgjedhura nga qeveria shpesh nuk janë adekuate dhe ka vështërësi në implementim. Për momentin jemi duke u përpjekur bashkë me M.SH implementimin në të gjitha institucionet "WEB App" platformën e cila ka fillue si pilot projekt nëtë gjitha QKMF-të e Kosovës. Në shumicën e qendrave shëndetësore punohet me fletëza kompjuterike gjë që na e vështirson punën për shkak të ngadalësisë në vendosje të të dhënave në SISH e shkaktar edhe nga mungesa e stafit ose operatorëve që vendosin këto të dhëna në SISH. Shpresojmë që të implementohet sistemi informativ shëndetësor i ri e jo si herë tjera të ja nisim prap nga fillimi.

Laboratori dhe Rentgeni bëjnë pjesë në sektorin e diagnostikës kanë të rëndësishëm për mjekun dhe pacientin pasi që mundësojn diagnostifikim apo vërtetimin e sëmundjes. Gjatë periudhës Janar-dhjetor të vitit 2021 në Laborator ka pasë gjithësejtë kanë 20482 pacient dhe 228338

shërbime analiza të ndryshme laboratorike, ka qenë i furnizuar mirë me reagensa, kemi pasë vështirësi pasi që kemi pasë defekte të herëpasherëshme në aparaturë dhe vonesa në servisim të aparaturës edhe pse kemi kontratë me një operator për servisim të rregullt të këtyre aparaturave. Rentgeni që është mëtodë diagnostike nga muaji Janari deri në Dhjetor të vitit 2021 ka pasë gjithësejt 5612 pacient dhe janë dhënë 22.948 shërbime imazherike, të gjithë pacientët që kanë kërkuar shërbime në RTG i kanë marë ato me kohë dhe pa termine. Material për punë kanë pasë mjaftueshëm filma të rtg dhe CD, kërkesat për material shpenzues janë bërë me kohë nga ana e përgjegjësit të RTG. Punohet cdo ditë pune nga ora $07^h$ deri në ora $13^h$ .

*Barnatorja Qëndrore –Shefi i barnatorës qëndrore bashk me përgjegjësat e sektoreve bëjë planifikimin e medikamenteve dhe materialit tjetër shpenzues që nevojitet për punë, grumbullimin dhe distribuimin e terapisë në të gjitha barnatoret në qendrat shëndetësore si në QKMF, QMF dhe AMF. Për periudhën janar –dhjetor të vitit 2021 :

**Janar**: Nuk ka pasur furnizim me barna dhe material shpenzues. Furnizim vetëm me insulin (të gjitha llojet)
**Vlera totale e furnizimit 16,022.70 €**

**Shkurt**: Nga 141 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 49 produkte, 92 ishin munges. Munges e plotë einsulines Novomix, ndersa frunizim i pjesshem me insulin Novorapid dhe Levemir.
**Vlera totale e furnizimit 4,299.30 euro**

**Mars**: Nga 142 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 50 produkte, 92 ishin munges. Munges e plotë vetem e insulines Levemir, Poashtu gjatë këtij muaji eshte pranuar kerkes emergjente per luftimin e COVID-19.
**Vlera totale e furnizimit 18,231.02 euro**

**Prill**: Nga 142 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 41 produkte, 101 ishin munges. Furnizim vetem e insulines Novomix, tjerat mungojnë. Poashtu gjatë këtij muaji eshte pranuar kerkes emergjente per luftimin e COVID-19.
**Vlera totale e furnizimit 17,467.58 euro**

**Maj**: Nga 141 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 36 produkte, 105 ishin munges. Furnizim i plotë vetem e insulines Levemir, të gjitha tjerat mungojnë. Poashtu gjatë këtij muaji eshte pranuar kerkes emergjente (15 copë Anti-tetanus immunoglobulin dhe 30 copë amp. Morfin)

**Vlera totale e furnizimit 3,921.92 euro**

**Qershor**: Nga 141 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 24 produkte, 117 ishin munges. Furnizim i plotë vetem e insulines Levemir, të gjitha tjerat mungojnë. Poashtu gjatë këtij muaji eshte pranuar kerkes emergjente
**Vlera totale e furnizimit 5,170.55 euro**

**Korrik**: Nga 103 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 11 produkte, 92 ishin munges. Ne korrik kemi furnizim te plote me insulin.

| | |
|---|---|
| **Vlera totale e furnizimit:** | **707.90 euro** |
| **Furnizimi me insulina** | **15314.90 euro** |

**Gusht**: Nga 103 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 12 produkte, 91 ishin munges. Ne Gusht kemi furnizim te plote me insulin.

| | |
|---|---|
| **Vlera totale e furnizimit:** | **707.90 euro** |
| Furnizim me Clinitest per Covid-19, 2400 cope vlera: | **9936.00 euro** |
| Furizim me insulin : | **13.559.10 euro** |

**Shtator**: Nga 103 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 40 produkte,63 ishin munges. Ne Shtator kemi furnizim te plote me insulin

| | |
|---|---|
| **Vlera totale e furnizimit:** | **2650.54 euro** |
| Furnizim me insulin: | **15412.40 euro** |

**Tetor**: Nga 104 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 49 produkte,55 ishin munges. Ne Tetor kemi furnizim te plote me insulin

| | |
|---|---|
| **Vlera totale e furnizimit:** | **3437.22 euro** |
| Furnizim me insulin: | **15412.40 euro** |

**Nentor**: Nga 103 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 51 produkte, 52 ishin munges. Ne Nentor nuk kemi furnizim me insulin

| | |
|---|---|
| **Vlera totale e furnizimit:** | **4041.04 euro** |
| Teste rapid per Covid-19 (13.900 cope) | **23,630.00 €** |
| Furnizim me PPM (rroba mbrojtese per Covid) | **52,235.00 €** |

**Dhjetor**: Nga 103 produkte te planifikuar per furnizim, te aprovuar janë 49 produkte,54 ishin munges. Ne Dhjetor kemi furnizim te plote me insulin

**Vlera totale e furnizimit: 4184.57 euro**
**porosi emergjente gjendja e renduar nga gripi sezonal: 3,438.50 €**
**Furnizim me insulin: 15,356.20 euro**

Furnizim me material shpenzues medicinal, barëra, insulina nga lista esenciale e MSH për periudhën kohore 12 mujore janar – dhjetor 2021 në vlerë totale **245,136.67 Euro**

Per shkak te mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shendetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës së Vushtrrisë të ndarë për blerjet e produkteve medicinale dhe material shpenzues, permes korniz konrates me furnizuesin “Agani Ltd ShPK” me datat :

| Nr. | Numri i Fatures | Data e fatures | Vlera e fatures € |
|---|---|---|---|
| 2 | 1-4590-4842-4843 | 28.12.2020 | 4,530.00 |
| 3 | 1-523-606-722-804-974-1047-1096-1202-1534-1535 | 21.04.2021 | 7,842.50 |
| 4 | FR-15/1-2075 | 03.06.2021 | 3,810.00 |
| 5 | 1-2904-2905-3057-3103 | 26.08.2021 | 7,618.10 |
| 6 | 1-4579-4673 | 16.12.2021 | 2,990.50 |
| **Gjithsej** | | | **26,791.10** |

ZHVP- Zhvillimi i Vazhdueshem Profesional- per mjekët dhe infermier është komponent me rëndësi të vecantë për për ngritje profesionale të punëtorëve dhe kjo rritë cilësinë e shërbimit. Që nga muaji mars janë ndërpre trajnimët nga ZHVP me kërkesë nga odat profesionale që të mos rrezikohet personeli i QMF së . Ndërësa ka pasë trajnime ONL. që janë organizuar nga shoqatat jo qeveritare të ndryshme si AQH, UNDPA, AMC, UNCEF dhe të mbështetura nga M.SH .

ZHVP për infermier- ka mbajtur ligjiratat e përmuajshëme për infermier dhe ëahtë vazhduar me ligjërata ONL duke respektuar masat anti Covid të rekomandura nga IKSHPK në mbrojtje nga virusi. Gjithashtu janë mbajt Ligjirata në komunitet nga specialistët e mjekësisë familjare për sëmundjet kronike si HTA dhe Diabeti projekt i përkrahur nga AQH dhe ishin ligjirata vetdijësuese të cila u mbajt në ambient të hapur.

QEV- Qendra e Edukimit të Vazhdueshëm profesional ka një aktivitet të caktuara nga M. SH dhe përmes QEV Regjional Mitrovicë organizon kursin dy javorë të ngritjes profesionale e që vazhduan në pjesën e dytë të vitit me trajnime në grupe të vogla. Trajneret e infermiereve gjatë

Pandemisë i kam lutë që përveq punëve të planifikura të bëjnë trajnime për stafin infermieror të trajnoj edhe stafitn teknik të hixhenës, për mënyrën se si të mbahet hixhena gjatë Pandemisë dhe të sigurohet mbroja për profesionistët dhe pacientët që i frekuentojn këto qendra për shërbime.

Këshillimorja për Edukim dhe Motivim Shëndetësor për semundje kronike jo infektive më të shpeshta si Hipertensioni dhe Diabeti e përkrahur dhe e monitoruar nga AQH, e që në vazhdimësi organizojn trajnime për mjek dhe infermier, na furnizojn me material edukus broshura për edukim dhe vetdijësim të komunitetit në mënyrë që të parandalohen këto sëmundje apo edhe nëse vijen deri te sëmundja të menaxhohet më lehtë. Gjatë vitit 2021 në këtë këshillimore janë vizituar 1551 pacient dhe janë dhënë shumë shërbime shëndetësore gjithësejt 6.068 pacient.

Shërbimi i Dializes – ka tre vozitës që punojnë në dy ndërrime grupi pacientëve që ka nevojë të transportohen për Dialize dy herë në javë dhe grupi tjetër që bartet për Dializë tri herë në javë. Pacientët janë të kënaqur me shërbimin dhe komoditetin e transportit që e ofron QKMF-ja dhe shërbimin që e merr në repartin e Dializës.

Vizitat shtëpiake- Për nënën edhe foshnjën dhe kanë rezultuar shumë të suksesëshme, nga UNCEFF AMC janë trajnuar një numër i madh infermiereve që vetëm disa kanë kryer vizita përshkak të obligimeve tjera në QKMF e që ëahtë dashtë të kryhen dhe janë rezultat i të Pandemië, nuk janë të zakonshme në situatë normale të punës. megjithatë gjatë këtijë viti janë realizuar 3374 vizita dhe janë dhënë 35275 shërbime, poashtu janë dhënë shumë këshillim për nënën dhe fëmijën përmes telefonit. Familjarët janë të knaqyr me këto vizita dhe këshillime për nanën dhe foshnjën. Edhe në këtë shërbim vërehet mungesa e stafit për punë në në teren, ndërësa transporti që më hërët ishte problem nuk është më. Ndërësa janë pranuar donacione nga UNICEF pako hixhenike për nanën dhe foshnjën, dhe janë dhuruar në familjet që kishin më shumë nevojë dhe i janë dokumentuar donatorit. Poashtu në fund vit i është dhënë një donacion i madhë QKMF-së nga UNICEFI pako të shumta higjenike për të përzgjedhura nga donatori. Po ashtu kemi marrë donacion një automjet terreni për vizitat për Lehona dhe gra shtatëzane.

AQH njeri nga donatorwt më të madhenjw e që na mbështet nga viti 2015, është donator që na ka mbështet dhe vazhdon edhe 4 vite tjera ne tri komponenta : Komponentën profesionale, menaxheriale dhe komponenta e edukimit dhe vetdijësimit të komunitet për shërbimet

shëndetësore dhe preventivën nga sëmundjet e rënda kronike. Jemi ndihmuar me paisje të shumta mjekësore, aparaturë, inventar dhe së fundemi me paisje për laborator që do të ralizohet në pjesën e parë të vitit 2021 , dy minilaboratore në dy QMF që do u lehtësonin qytetarëve qasjen në shërbimet tona dhe do të ndikojn nw rritje tw cilësisë së shërbimeve shëndetësore. AQH është donator shumë serioz e që përveç mbështetjes e monitoron inplementimin e projekteve. Ne si QKMF jemi pafundësisht falenderues ndaj shoqatës joqeveritare AQH- dhe donatorve tjerë që na kanë mbështet me trajnime si UNICEF/UNDPA/ AMC dhe IRW, etj.

Komuna Vushtrri në bashkëpunim me Islamik Relief ralizon projektin për vizita në teren për pacientët me sëmundje të rënda kronike dhe në stadet terminale. Gjatë këtijë viti janë vizituar 26551 vizita tek pacientët dhe janë dhënë 70.634 shërbime në teren. Qytetarët janë shumë të kënaqur me këto vizita dhe shërbime të ofruara në shtëpinët e tyre, pacientit i është lehtësuar marrja e shërbimeve shëndetësore dhe familjes i është lehtësuar përkujdesja për pacientin. Gjatë këtijë viti të Pandemisë rëndësia e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në teren ka qenë edhe më e madhe përshkak të rrezikut nga infeksioni për pacientët me sëmundje kronike gjatë marrjes të shërbimeve në qendrat shëndetësore, pacientët do ishin të rrezikuar nga infeksion dhe me imunitet të kompromituar. Këto shërbime në teren i kanë ndihmuar pacientët me sëmundje kronike dhe me sëmundje terminale që të marrinë shërbime në shtëpitë e tyre në ambient të sigurt dhe optimal për ta dhe ne si profesionist kemi qenw mw tw lehtësuar. Po ashtu është siguruar terapia e nevojshme që mos të kenë kosoto të shpenzimeve pacientët.

Ekipi funskion me dy ekipe 27/7 ditë prej prës 07:00h deri në ora 20:00h, 13 orë pune, ekipi është i përbërë nga 1 doktor dhe dy infermier dhe funksionin çdo ditë me dy ekipe njëri në vise urbane kurse tjetri në vise rurale.

Si menaxher të institucionit kemi monitioruar të gjitha qendrat shëndetësore dhe stafin e tyre sa i respektojn udhëzimet nga M.SH, apo edhe rekomandimet që janë dhënë nga IKSHPK për mbrojtje nga SARS COV 2 dhe sa respektohen këto masa. Monitorimi ka qenw i shpeshtë dhe i vazhdueshëm, poashtu edhe stafi tjetër përgjegjës në mënyrë periodike ka monitoruar dhe ka dhënë rekomandime të cilat gjatë monitorimit të radhës tjetër kanë qenë të realizura.

Gjatë vitit 2021 kemi pasë shumë pushime mjekësore nga punëtorët tanë të cilët janë arsytuar me raporte të specialistëve të lëmive specifike shëndetësore.

Inspektoriati i Ministrisë së Shëndetësisë gjatë inspektimeve në qendrat shëndetësore na ka vlerësuar mirë,si në mbajtje të hixhenës në hapësirat e punës ,respektimi i masave anti Covid nga institucioni dhe punëtorët shëndetësor.

## Departamenti i Administratës

Departamenti i administratës është i ngarkuar me punë e me theks të veçantë shefi i shërbimit të personelit i cili përveç punëve dhe detyrave të tijë si shef i resurseve humane në përpilimin e kontratave dhe mbajtjen e rregullt të dosjeve etj. ai kryen edhe punë tjera si kërkesa dhe specifikime për shumë pasisje dhe aparaturë mjekësore, inventar etj., inicim të procedurave, buxhetin, në konkurse, në komisione etj. Sfidë e veçantë për ne është prokurimi pasi që ne si njësi buxhetore kemi nevoja të mëdha e që kemi nevojë për zhvillim me kohë të projekteve e jo vonesa apo edhe pamundësi të realizimit tyre përshkak të punëve të shumta që ka prokurimi komunal.

QKMF Vushtrri sipas legjistlacioni ka të lejuar 205 punëtor, prej tyre kemi 12 Doktor Specialist të Mjekësisë Familjare, 19 Doktor të mjekësisë së përgjithshme, specialist biokimisë klinke 1, stomatolog 9, 1 farmacistë, 129 infermier/teknik medicinal 29 staf administrativ dhe mbështetës.

Jemi në faza rekrutuese të 2 doktor specialist mjekësisë familjare, 1 stomatolog, 1 referent për arhivë, 1 punëtor në ngrohtore.

|Gjatë vitit 2021 kanë mbetë të pa realizura këto projekteve.........

Furnizimi me inventar për QKMF, Teknilogjia informative Furnizimi me pajisje mjekësore, Shtrimi i kockave në QKMF, Ndërtimi i recepsionit ne QKMF e re, Izolimi i RTG-së në objektin e QKMF Ndertimi i kendeve të vaksinimit etj. si rezultat i vonesave e që gjatë këtijë viti ka mund të ndikoj edhe Pandemia pasi që kërkesat dhe specifikimet nga institucioni është bërë me kohë ndërësa kanë mbetë projektet e paralizura. QKMF në Vushtrri ka inicuar aktivitete në kohë:

**Projektet e pa realizuara ( dështuara ) të QKMF për vitin 2021**

| PËRSHKRIMI I ARTIKUJVE | VLERA në € |
|---|---|
| Teknologji informative | 20000.00 |
| Pajisje mjekësore | 850927.00 |
| Furnizim me inventar | 32186.62 |

| | |
|---|---|
| Ndërtimi I recepsionit në objektin e ri të QKMF | 4000.00 |
| Rehabilitimi dhe izolimi I rengenit dhe ventilimi për ojketin e ri të QKMF-së | 43523.00 |
| Rehabilitimi dhe adaptimi I laboratorit në QMF-3 | 4000.00 |
| Rregullimi i oborrit të objektit të ri të QKMF-së | 30589.23 |
| **TOTALI:** | **217,112.23** |

Andaj realizimi i këtyre projekteve mbetet sfidë e vitit 2022 që ti realizojmi pasi që ne duhet të bartemi në objektin e ri të QKMF-së.

Gjatë punës ka mbizotruar konstruktiviteti ndërkolegial dhe kjo ka mundësuar të kryhen punët e planifikuara. Përveç punëve të zakonshme e të planifikuara janë kryer edhe shumë punë tjerat rëndësishëme për punëtorët shëndetësor dhe tjerët që punojn në QKMF dhe për herë të dytë janë paguar pagat Jubilare në varësi nga vitet e punës,

Përgjegjësi i zyrës ligjore ka kryer punë të cilat janë të përshkruara në detyrat e punës së tijë ,vendime, urdhënesa, pergjegje të ndryshme zyrtare, përpilimi i vendimeve të komisionit Disiplinor dhe punë tjera që e autorizon drejtori .

Gjate vitit 2021 ka pasë edhe neglizhencë e mangësi në punë nga disa punëtor shëndetësor të cilët nga përgjegjësat e drejtëpërdrejtë kanë bërë fletëparaqitje për komision disiplinor. Komisioni Disciplinor pas shqyrtimit të ketyre rasteve ka nxjerr vendime në varësi nga shkeljet e gjetura. Në rastet kur kemi pas shkelje të lehta përgjegjesi i drejtëpërdrejtë në konsultim me zyrën ligjore ka shqiptuar vrejtje verbale sipas kodit disciplinor të QKMF-së. Ndërësa rastet më të rënda janë dërguar në Komisionin Disciplinor ku janë shqyrtuar dhe është dhënë verdikti në bazë të të gjeturave..

Gjatë këtijë viti janë kryer punët në infrastrukturë që kanë mbetë të pa kryera dhe lirisht mund të themi se institucionet shëndetësore që janë në kuadër të QKMF tani kanë kushte optimale pune për personelin dhe për ofrimin e shërbime për qytetarët, kjo ndikon në rritëjen e kënaqëshmërisë së pacientëve pasi që ka ndikim të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Gjate vitit 2021 në të gjitha institucionet shëndetësore është instaluar uji i ngrohtë dhe që ka qenë edhe kërkesë e vazhushme nga ispektoriati Shendetësor dhe është pa si mangësi e madhe e për fat të mirë edhe ky projekt është realizuar, përveç në QKMF pasi që do të kalojm në objektin e ri në në pjesëne dytë të vitit 2022 dhe nuk e kemi pa të arsyeshme që panevojë të bëjm shpenzime.

Falenderim të sinqertë për të gjithë punëtorët shëndetësor dhe ata ndihëmës në QKMF, për kontributin e dhënë në ofrimin e vizitave dhe shërbimeve shëndetësore pa menduar për rrezikimin e jetës së tyre dhe familjes. Kjo na e ka bërë më të lehtë punën edhe neve si menaxhment edhe përkundër vështërësive që u paraqiten në punën tonë dhe ndryshoi gjithçka gjatë Pandemisë që nga muaji i mars i vitit 2021 e në vazhdim, kjo ndikoj në në ndryshim radikal të sjelljes tonë karshi nevojave që u paraqitën . Ndryshuam stilin e punës dhe jetës në përgjithësi kuptohet u bë më vështir në transport,në punë dhe poashtu edhe me kujdesë maximmal në familje ,maska ,higjena e duarve dhe distanca fizike na u ba mënyrë jetese. Kemi bërë shumë përpjekje që t'i përshtatemi rrethanave të reja dhe me gjithë vështërësit që u paraitën për për ne dhe gjithë njerzimin ja dolëm të mësohemi me këtë gjendje dhe të vazhdojm me punët tona të përditëshme .

Falenderiojm shtabin emergjent komunal Anti Covid- 19 në Vushtrri pë mbështetjen e ofruar gjatë kohës së Pandemisë, drejtorin e DSHPS , për përkrahje morale gjatë kësaj sfide të quajtur Pandemi virale e shkaktuar nga virusi SARS COV 2, e cila ndryshoi jetën e të gjithëve dhe afektoi edhe në jetën e punën tonë si punëtor shëndetësor. Më 17 qershor në ditën e çlirimit të qytetit punëtorët shëndetësor të QKMF së Vushtrri u nderuan për punën e tyre me mirënjohje

Sfidat;Numri i stafit shëndetësor është i vogël në krahasim me numrin e banorëve të komunës të cilët kamë nevojë për shërbime shëndetësore dhe ne e paraqesim në çdo takim si me Ministrinë e Shëndetësisë/financave, duke i njoftuar se numri i personelit shëndetësor në krahasim me numrin e qytetarëve që ju shërbejn është në disproporcon, dhe kjo mund të jetë pengesë për mos realizimin e qasjes së mirë të komunitetit në shërbimet tona dhe shërbimet të jenë cilësore.

Falemnderit !!!

Me respekt,

Kryes i Punës Drejtori të QKMF Vushtrri

Dr.spec.Abdullah Vojvoda

Ju paraqesim në formë statistikave vizitat, shërbimet dhe krahasimet:

**Do paraqesim në formë tabelave në QKMF, QMF dhe AMF në Vushtrri për vizitat mjekësore për vitin 2021**

| Nr. | Emri i institucionit | Totali I vizitave | Totali I shërbimeve | Të hyrat vetanake |
|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 232462 | 1052716 | |
| | Gjithsejt | 232,462 | 1052716 | 57188.50 €uro |

**Do paraqesim në formë tabelave në QKMF në Vushtrri për vizitat mjekësore për vitin 2021**

| Nr. | Emri i sherbimit | Totali | Meshkuj | Femra | Participim | Sherbim | Referime | Malinje | Kronike | Te vizituar me kartele |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 65784 | 30753 | 35031 | 10795 | 225052 | 7856 | 27 | 3260 | 718 |
| 2 | Urgjenca | 34134 | 15572 | 18562 | 2776 | 166867 | 4083 | 291 | 5550 | 1 |
| 3 | Laboratori | 20482 | 8051 | 12431 | 4322 | 228338 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 4 | Stomatologjia | 9015 | 4003 | 5012 | 965 | 42542 | 222 | 0 | 0 | 1052 |
| 5 | RTG | 5612 | 2554 | 3058 | 1160 | 22948 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 6 | Rtg e dhembit | 838 | 363 | 475 | 127 | 1779 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 7 | Vaksinimi | 4750 | 2593 | 2157 | 0 | 19546 | 0 | 0 | 0 | 3922 |
| 8 | QMF-1 | 57142 | 26618 | 30524 | 11734 | 151735 | 8110 | 36 | 2421 | 711 |
| 9 | QMF-2 | 5845 | 2610 | 3235 | 809 | 35262 | 624 | 0 | 199 | 163 |
| 10 | QMF-3 | 6940 | 3024 | 3916 | 1092 | 48030 | 60 | 0 | 1097 | 681 |
| 11 | QMF-AMF | 16995 | 7341 | 9654 | 2367 | 69274 | 4356 | 5 | 1646 | 1737 |
| 12 | V.SHTEPIAKE | 3374 | 1533 | 1841 | 0 | 35275 | 2 | 0 | 0 | 0 |
| 13 | KshillimoreAQH | 1551 | 704 | 847 | 0 | 6068 | 0 | 0 | 212 | 0 |
| | Gjithsejt | 232,462 | 105,719 | 126,743 | 36,147 | 1,052,716 | 25,313 | 359 | 14,385 | 8,985 |

## Krahasimi i raporteve vjetore 2017,2018,2019,2020,2021 në QKMF Vushtrri

*Forma tabelore dhe grafike e pacientëve është shprehura më poshtë :*

2017

| Nr. | Emri I Shërbimit | Gjithsejtë | M | F | Participim | Shërbim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 62616 | 29133 | 33483 | 10289 | 102100 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Urgjenca | 36785 | 17238 | 19547 | 4884 | 152408 |
| 3 | Stomatologji | 9068 | 4200 | 4868 | 1154 | 37555 |
| 4 | Laborator | 14497 | 4931 | 9566 | 3115 | 94506 |
| 5 | RTG | 5421 | 2572 | 2849 | 1279 | 15384 |
| 6 | RTG E Dhëmbit | 853 | 378 | 475 | 114 | 1964 |
| 7 | QMF-1 | 52791 | 23909 | 28882 | 10161 | 75817 |
| 8 | QMF-2 | 5302 | 2257 | 3045 | 684 | 8241 |
| 9 | QMF-3 | 5302 | 2257 | 3045 | 684 | 8241 |
| 10 | QMF dhe Amf | 17046 | 7723 | 9623 | 1802 | 24845 |
| 11 | Vaksinimi | 4935 | 2702 | 2233 | 110 | 15366 |
| | | | | | | |
| | ***Gjithsejtë*** | ***214616*** | ***97300*** | ***117616*** | ***34276*** | ***536427*** |

***Forma grafike janë te shprehura në vite dhe në përqindje .***


Pacienta
214616
220961
220961
157113
232462
2017
2018
2019
2020
2021


PACIENTA TE SHPREHUR NE PERQINDJE
2017
21%
2018
21%
2019
21%
2020
15%
2021
22%

***Forma tabelore dhe grafike e pacientëve është shprehura më poshtë :***

2018

| Nr. | Emri i Shërbimit | Gjithsejtë | M | F | Participim | Shërbime |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 60657 | 28453 | 32204 | 10164 | 95806 |
| 2 | Urgjenca | 32161 | 14838 | 17323 | 4434 | 160729 |
| 3 | Stomatologji | 9861 | 4560 | 5301 | 1216 | 37197 |
| 4 | Laborator | 16103 | 5660 | 10443 | 4281 | 177065 |
| 5 | RTG | 5763 | 2745 | 3018 | 1376 | 17404 |
| 6 | RTG E Dhëmbit | 794 | 356 | 438 | 110 | 855 |
| 7 | QMF-1 | 61208 | 27971 | 33237 | 19954 | 91556 |
| 8 | QMF-2 | 6573 | 2951 | 3622 | 914 | 9428 |
| 9 | QMF-3 | 4880 | 2048 | 2832 | 988 | 7142 |
| 10 | QMF dhe AMF | 18313 | 7791 | 10545 | 2456 | 27561 |
| 11 | Vaksinimi | 4648 | 2496 | 2152 | 59 | 15294 |
| | *Gjithsejtë* | *220961* | *99869* | *121115* | *45952* | *640037* |

***Forma grafike janë të shprehura në vite dhe në përqindje.***


Sherbimet
536427
640037
640037
608241
1052716
2017
2018
2019
2020
2021


SHERBIMET TE SHPREHURA NE PERQINDJE
2017
16%
2018
18%
2019
18%
2020
18%
2021
30%

**Forma tabelore dhe grafike e participimit është shprehura më poshtë :**

**2019**

| Nr. | *Emri I shërbimi* | *Gjithsejtë* | *M* | *F* | *Participim* | *Shërbimi* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF-Vushtrri | 65946 | 30741 | 35205 | 10585 | 102638 |
| 2 | Laboratori | 17367 | 6234 | 11133 | 3822 | 192864 |
| 3 | Urgjenca | 30606 | 14131 | 1647 | 4122 | 142835 |
| 4 | Stomatologjia | 11650 | 5296 | 6354 | 1532 | 56504 |
| 5 | Rtg | 5852 | 2717 | 3135 | 1335 | 15589 |
| 6 | Rtg e dhëmbit | 840 | 377 | 463 | 164 | 1563 |
| 7 | Vaksinim | 3732 | 2016 | 1716 | 0 | 15443 |
| 8 | QMF-1 | 65617 | 30400 | 35217 | 13695 | 88190 |
| 9 | QMF-2 | 7064 | 3088 | 3976 | 996 | 11088 |
| 10 | QMF-3 | 6071 | 2674 | 3397 | 1065 | 19729 |
| 11 | QMF dhe AMF | 18694 | 7594 | 11100 | 2761 | 29093 |
| 12 | V. shtëpiake | 1608 | 657 | 765 | 0 | 8040 |
| | *Gjithsejtë:* | *235047* | *105925* | *114108* | *40077* | *683576* |

***Forma grafike participimit që janë të shprehura në vite dhe në përqindje.***






**Forma tabelore e participimit është shprehura më poshtë : 2020**

| Nr. | Emri I shërbimi | Gjithsejtë | M | F | Participim | Shërbimi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 39445 | 18911 | 20534 | 6093 | 115469 |
| 2 | Urgjenca | 22176 | 10438 | 11738 | 1587 | 114119 |
| 3 | Laboratori | 11159 | 4092 | 7067 | 2300 | 126681 |
| 4 | Stomatologjia | 7973 | 3706 | 4267 | 1015 | 33138 |
| 5 | RTG | 4795 | 2298 | 2497 | 881 | 13195 |
| 6 | Rtg e dhëmbit | 501 | 230 | 271 | 63 | 1080 |
| 7 | Vaksinimi | 5092 | 2710 | 2382 | 0 | 20183 |
| 8 | QMF-1 | 40572 | 18961 | 21611 | 6453 | 86329 |
| 9 | QMF-2 | 4392 | 1988 | 2404 | 672 | 13315 |
| 10 | QMF-3 | 4362 | 1958 | 2404 | 687 | 21624 |
| 11 | QMF-AMF | 13579 | 5917 | 7662 | 1773 | 48595 |
| 12 | V .Shtepiake | 2402 | 1092 | 1310 | 0 | 11840 |
| 13 | Këshillimore AQH | 794 | 386 | 408 | 0 | 2673 |
| | Gjithsej : | 157113 | 72624 | 84489 | 21440 | 608241 |

*Vërejtje: Pacientet të cilët kanë participin është 21,440 ndërsa në euro është 28,375.*

*Forma tabelore e participimit është shprehura më poshtë :2021*

| Nr. | Emri i sherbimit | Totali | Meshkuj | Femra | Participim | Sherbim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | QKMF | 65784 | 30753 | 35031 | 10795 | 225052 |
| 2 | Urgjenca | 34134 | 15572 | 18562 | 2776 | 166867 |
| 3 | Laboratori | 20482 | 8051 | 12431 | 4322 | 228338 |
| 4 | Stomatologjia | 9015 | 4003 | 5012 | 965 | 42542 |
| 5 | RTG | 5612 | 2554 | 3058 | 1160 | 22948 |
| 6 | Rtg e dhembit | 838 | 363 | 475 | 127 | 1779 |
| 7 | Vaksinimi | 4750 | 2593 | 2157 | 0 | 19546 |
| 8 | QMF-1 | 57142 | 26618 | 30524 | 11734 | 151735 |
| 9 | QMF-2 | 5845 | 2610 | 3235 | 809 | 35262 |
| 10 | QMF-3 | 6940 | 3024 | 3916 | 1092 | 48030 |
| 11 | QMF-AMF | 16995 | 7341 | 9654 | 2367 | 69274 |
| 12 | V.Stepiake | 3374 | 1533 | 1841 | 0 | 35275 |
| 13 | Këshillimore eAQH | 1551 | 704 | 847 | 0 | 6068 |
| | Gjithsejt | 232462 | 105719 | 126743 | 36147 | 1052716 |

***Raporti nga këshillimorja e AQH-së 2021***

*Raporti per smundje kronike (diabet,hipertension,astma )te cilat vitet e fundit po shtohen gjithnje e me shume si ne vend ashtu edhe ne komunen tone .*

*Ne baze te raportit te dhene nga infermieret e Mjekësise Familjare kemi gjetur keto rezultate.Raporti QKMF,QMF-1.QMF-2,QMF-3 dhe 7 QMF ne fshatra*

2021

| **Nr.** | **Muaji** | **Diabeti** | **Hipertensioni** | **Asthma** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 329 | 316 | 65 |
| 2 | Shkurt | 352 | 564 | 84 |
| 3 | Mars | 275 | 514 | 51 |
| 4 | Prill | 364 | 485 | 71 |
| 5 | Maj | 217 | 450 | 52 |
| 6 | Qershor | 207 | 342 | 95 |
| 7 | Korrik | 244 | 427 | 55 |
| 8 | Gusht | 398 | 455 | 96 |
| 9 | Shtrator | 471 | 581 | 100 |
| 10 | Tetor | 311 | 587 | 88 |
| 11 | Nentor | 544 | 612 | 149 |
| 12 | Dhjetor | 356 | 710 | 227 |
| | Totali | 4068 | 640 | 1133 |

## *Raporti nga Relief Islamiku ne Terene*

*Projekti i Relief Islamikut eshte projekt qe realizohet sipas objektivave per ofrimin dhe dhenjen e sherbimeve mjekesore si;*

*Pacientet mbi 65 vjeq,personat me aftesi te ndryshme ,personat me semundje malinje ,kronike.*

| Nr. | Raporti Mujor per vitin 2021 | Totali | Meshkuj | Femra | Pacientat mbi 65 vjet | Shërbim |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Janar | 2073 | 929 | 1144 | 424 | 4944 |
| 2 | Shkurt | 1622 | 724 | 898 | 406 | 4056 |
| 3 | Mars | 1792 | 782 | 1010 | 526 | 4636 |
| 4 | Prill | 2932 | 1273 | 1659 | 476 | 6816 |
| 5 | Maj | 2663 | 1145 | 1518 | 447 | 6220 |
| 6 | Qershor | 1564 | 696 | 840 | 388 | 3904 |
| 7 | Korrik | 2002 | 859 | 1085 | 567 | 5138 |
| 8 | Gusht | 2903 | 1260 | 1656 | 719 | 7244 |
| 9 | Shtrator | 2199 | 1003 | 1746 | 936 | 6270 |
| 10 | Tetor | 2699 | 1168 | 1531 | 1480 | 8358 |
| 11 | Nentor | 2984 | 1312 | 1672 | 1620 | 9208 |
| 12 | Dhjetor | 1118 | 503 | 615 | 802 | 3840 |
| | **Gjithsej:** | **26551** | **11654** | **15374** | **8791** | **70634** |

**Tabela dhe grafiku për vitet 2017,2018,2019,2020,2021 janë si me poshtë :**


QKMF VUSHTRRI
Participimi
Sherbimet
Pacienta
34276
536427
214616
45952
640037
220961
45952
640037
220961
21440
608241
157113
36147
1052716
232462
2017
2018
2019
2020
2021


QKMF VUSHTRRI
[CATEGORY NAME], [VALUE], [PERCENTAGE]
[CATEGORY NAME], [VALUE], [PERCENTAGE]
[CATEGORY NAME], [VALUE], [PERCENTAGE]
[CATEGORY NAME], [VALUE], [PERCENTAGE]
[CATEGORY NAME], [VALUE], [PERCENTAGE]

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA VUSHTRRI

# QENDRA PËR PUNË SOCIALE VUSHTRRI

## RAPORTI VJETOR I PUNES 2021

Detyrat programore të Qendrës për Punë Sociale janë të rregulluara me Ligjin mbi Asistencës Sociale,Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, Ligjin për përkujdesjen materiale të familjeve me fëmijë të aftësisë së kufizuar si dhe Ligje dhe akte tjera të përcaktuara nga Ministria e Punës dhe Mirqenjës Sociale.

Në kuadër të veprimtarisë së vetë profesionale, Qendra për Punë Sociale:

1. Zbulon dhe përcjellë nevojat dhe problemet sociale të qytetarve,
2. Zbulon familjet në gjendje të vështirë materiale dhe zbaton formën e ndihmës sociale në kuadër të kritereve të përcaktuara me Ligj.
3. Propozon, organizon dhe ndërmer masa në aplikimin e formave adekuate të mbrojtjes social dhe ofrimit të shërbimeve sociale,
4. Inicon, organizon dhe koordinon punën profesionale dhe vullnetare në lëmin e mbrojtjes sociale,
5. Mban kontakte dhe bashkëpunon me OJQ dhe institucione që kanë fushëveprimin e e mbrojtjës sociale.

Përveç punëve të lartëcekura, Qendra kryen edhe punë dhe shërbime të përcaktuara nga Ligji mbi Familjen, Ligji mbi Martesën dhe marrëdhënjet familjare, pra kryen punë si ato të kujdestarisë,

1. Merrë pjesë në procesin e marrjes së aftësisë së veprimit dhe rikthimit të sajë ndaj personave,
2. Kryen kujdestari të drejtëpërdrejtë përmes punëtorve të vetë profesional,
3. Merr pjesë në marrjen e së drejtës prindore dhe rrikthimit
4. Kryen punë të adoptimit,
5. Ofron ndihmë në rregullimin e marrëdhënjeve bashkëshortore dhe familjare
6. Jep mendim dhe propozim Gjykatës për pajtim të bashkëshortve, besimit të fëmijëve dhe ndërimit të Vendimit për besim të fëmiut,
7. Ofron ndihmë në problemet zhvillimore të fëmijëve dhe çrregullime në sjelljet e tyre.
8. Ofron ndihmë familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar.
9. Ofron ndihmë dhe trajton personat e trafikuar dhe viktimdhunës në familje

si dhe përsonat e abuzuar seksualisht.

10. Sistemon të moshuarit në shtëpi të pleqëve.

## D I N A M I K A
## LËVIZJA E NUMRIT TË SHFRYTËZUESVE DHE REALIZIMIT TË FORMAVE TË MBROJTJES SOCIALE

Në periudhën raportuese mundë të themi se kanë ardhë në shprehje maksimale të gjitha grupë moshat të shprehura përmes kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale dhe janë ofruar shërbime apo forma adekuate të mbrojtjes sociale. Krahasuar me vitin paraprak kemi ngritje të sherbimeve dhe të kategorive të ndryshme të mbrojtjes sociale .

## ASISTENCA SOCIALE

Pranë QPS –Vushtrri në Asistence Sociale janë 1473 familje, prej tyre 1412 familje me 6873 anëtarë janë shqiptarë si dhe 61 familje me 178 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 174 kërkesa për asistencë sociale prej të cilave 54 janë aprovuar, kurse 120 prej tyre janë refuzuar si familje të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret. Ndërsa janë riaktivizuar 17 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 62 familjeve të cilat kanë qenë shfrytezuese të asistencës sociale.

Në këtë periodë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 3, prej tyre 1 është aprovuar në vlerë prej 100 euro .

Gjatë kësaj periode në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 145 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 124 aplikues, janë refuzuar 19 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 2 .

Gjatë kësaj periudhe 9 familje i kan kthy mjetet pasi që janë refuzuar nga ATK dhe janë të obliguar ti kthejn mjetet,kthimi i mjeteve bëhet për shumen e marrë të ndihmes sociale për një muaj.

# SHËRBIMET SOCIALE

Në periodën raportuese krahasuar me vitin paraprak numerikisht numri i klientëve ka pasur ngritje si rezultat i trajtimit të kategorive të reja, dhe e gjithë kjo ka rezultuar edhe me rritjen e volumit të punëve dhe ofrimit të shërbimeve përmes formave të mbrojtjes sociale. Të gjitha këto konkretizohen përmes shënimeve të mëtutjeshme.

Vlen të theksohet se gjatë kësaj periode kemi pasur 22 raste të trajtimit të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, ku prej tyre 4 kanë arritur pajtim dhe 6 ndarje.
Nga këto familje janë 43 fëmijë, prej tyre 25 i janë besuar nënës në përkujdesje, ndërsa 18 ju janë besuar babait në përkujdesje.

# FËMIJËT PA KUJDES PRINDOR

Edhe në këtë periodë QPS-ja detyrë prioritare ka pasur punën me fëmijët pa kujdes prindor dhe në përgjithësi fëmijët nga familjet devijante. Është bërë evidentimi i këtyre fëmijëve, hapja e dosjeve dhe përpunimi profesional i kësaj kategorije deri në përfundim e sipër si punë permanente.
Kemi pasur 2 femijë të braktisur të bartur nga viti i kaluar kurse gjatë këtij viti kemi 1 fëmijë të braktisur gjithsej 3 fëmijë, ku janë ofruar këto shërbime pas qëndrimit në spital për një periudhë një mujore fëmijët janë regjistruar, ju është caktuar kujdestari ligjor, 2 raste të bartuara nga viti i kaluar janë në procedur gjygjsore për vërtetim të atësis, 2 femijë janë vendosur në SOS fshati Prishtinë, pastaj janë vendosur në strehim familjar në komunitet, kurse fëmiju tjetër i braktisur është adoptuar. 2 fëmijë janë vendosur në strehim familjar në komunitet, 1(një) fëmijë i prindërve të penguar në detyrën prindore i bartur nga vitet e kaluara është në mbrojtje institucional i strehuar në Caritas Klinë. Gjatë këtij viti i kemi pasur 25 kërkesa per kujdestari të veçanta, kemi caktuar kujdestar ligjor për 12 raste, me rastet e bartura nga vitet paraprake

gjithsej 46 kujdestari active. Strehim familjar 22 raste, të gjithë fëmijët që janë në strehim familjar tek të afërmit janë vizituar të gjitha rastet problematike janë trajtuar në formën e duhur duke ju ofruar fëmijëve dhe familjeve seanca këshilluaese, e shërbime të tjera të nevojshme, DPSF na ka njoftuar permes trajnimeve të organizuara me OJQ, OFAP se sipas nevojave të kërkuara nga QPS mund të ofrohen shërbime dhe trajtime në fushën e psikologjis për fëmijët në strehim familjar tek të afërmit dhe në komunitet. Po ashtu kemi asistuar në gjykatë dhe kemi dhënë mendim, raport për 2 raste, martesë e të miturve.

Pra krahasuar me vitin paraprak në periodën raportuese janë zbatuar në masë më të madhe format e mbrojtjes sociale si vënja nën kujdestari të fëmijëve pa kujdes prindor 3 raste, 12 kujdestari për raste të veçanta, asistenca sociale si dhe shërbime tjera të punës sociale. Ndihma në natyrë këtë vit krahasuar me atë paraprak ka qenë shumë e vogël me që është mvarë nga donator.

## TË MITURIT ME SJELLJE TË ÇRREGULLUARA DHE DELIKUENT TË MITUR

Në këtë periodë kemi këtë gjendje 26 raste të delikuencës së të miturëve dhe 2 raste fëmijë me sjellje asociale, 26 raporte vlersuese rreth gjendjes sociale për fëmijë të cilët kanë bërë kundravajtje. Puntorët e shërbimeve sociale asistoin në polici dhe gjykatë për rastet e të miturëve delikuent në përgjethësi. Për kategorin e fëmijëve që bëjnë kundravajtje japin raport vlersues dhe propozues për masat ndëshkuese. Ndërsa për të miturit delikuent trajtimin dhe përpunimin e rasteve e bënë Shërbimi Sprovues të Kosovës, pra dhënjen e mendimeve gjykatave, ndërsa në i trajtojm edhe më tutje në aspktin e mbiqkyrjes. Në këtë drejtim me qëllim të arritjes së rezultateve më të mira në procesin e risocializimit dhe riedukimit kemi pasur bashkëpunim të drejtëpërdrejt me policin, familjen, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe subjektet e tjera.

Veprat me të cilat karakterizohen të miturit me sjellje asociale janë bredhja, si rezultat i kësaj është prezente edhe trafikimi i vajzave të mitura. Ndërsa delikuenca e të miturëve karakterizohet më tepër me vepra penale, si vjedhje nga neni 135 LPK. Si dhe veprat prishje e rendit dhe qetësis publike, drejtim i automjetit pa patent shofer. Gjatë tretmanit psiko- social të këtyre fëmijëve dhe të miturëve Qendra ka vendos kontakte permanente me të miturit, familjet apo kujdestarët e tyre si dhe bashkëpunim me subjekte tjera si OJQ, shkollat etj. Puna ka qenë e përqëndruar në identifikimin gjegjësisht diagnostifikimin e rastit, hulumtimin e personalitetit të

fëmijut, identifikimin e interesave të të miturit dhe harmonizimin me normat e përgjithshme morale dhe juridike, organizimi dhe racionalizimi i kohës së të miturëve,etj.

## VIKTIMA TE TRAFIKIMIT DHE TENTIM DHUNIMIT

Gjatë periodës raporutuese kemi 1 rast tentim dhunimi të të miturës, e cila është trajtuar nga Instituti i Mjeksis Ligjore dhe është referuar për trajtim psikologjik në Diakoni Kosova Mitrovicë pas trajtimit viktima është rikthyer në familjen e saj, dhe 1 rast e mitur e shfrytëzuar për pornografi rasti është në procedur, 2 raste të abuzimit seksual. Në këtë vit kemi 1 raste të të rriturave të cilat dyshohet për trafikim

Ekipi shërbimeve sociale në këto raste përcjellë këto viktima prej fillimit të hetuesisë në bashkëpunim me policin, gjykatën, familjet dhe subjektet e tjera. Vlen të theksohet se nga QPS-ja në këtë vit janë ndihmuar reth riintegrimit 4 viktima të trafikimit nga vitet paraprake këto viktima të trafikimit kanë pasur edhe mbështetjen financiare me qëllim të rehabilitimit dhe reintegrimit të tyre. Pra puna kryesore ka qenë e fokusuar në risocializimin, kthimin e tyre në familje dhe të rikthimit në shkollim të rregulltë. Në këtë drejtim nuk ka munguar edhe bashkëpunimi me qendrën e shëndetit mendor, kemi pasur raste të trajtuar nga kjo qender dhe mendoim se ka pasur sukses në stabilizimin e tyre psiko-social.

## DHUNA FAMILJARE

Gjatë periodës që po raportojmë ka pasur shtim të rasteve ku kemi 48 raste të raportimit të dhunës familjare, ndaj femrave dhe raste ndaj antarëve të familjes, çka është mjaft brengosëse kur të kemi parasysh se rastet po shtohen dhe ekipet e Qendrës për Punë Sociale duhet të jenë në gadishmëri dhe të ju ofrojnë asistim në polici,asistim në gjykatë, vendosje në strehim të përkohshëm, seanca kosultuese e këshilluese dhe bashkimin familjarë.

Në këtë vit kemi 8 gra + 8 fëmijë gjithsej 16 persona të cilët janë vendosur në strehimoren Raba Voca Mitrovicë. Dhe 1 rast të mbartur nga vitet e kaluara e vendosur në Shtëpin e Sigurt Gjakovë.

Janë dhëne 40 urdhra mbrojtje prej gjykatës për rastet e dhunës në familje,12 raste kemi arritur ta

pajtoim , 10 ndarje, ndërsa rastet e tjera janë në procedur. Punëtorëve të shërbimeve sociale ju mbetet të vazhdoin me trajtimin e këtyre rasteve në vitin vijues.

## PERSONAT E MOSHUAR

Sikurse edhe kategorit tjera të mbrojtjes sociale edhe këto kategori të moshës së pleqërisë kanë pasur tendencën e rritjes, mirëpo në këtë periodë rëndësi të veçantë i kemi kushtuar sidomos të moshuarve pa kujdes familjar ku i kemi pasur të vendosur 3 raste 2 në shtëpinë e pleqëve Skenderaj dhe 1 në Prishtinë, 4 kerkesa te reja, 1 kërkes eshte në procedur për tu vendosur ne shtëpi të pleqëve Prishtinë, dhe janë dhënë 6 raporte për bashkim familjar tek të afërmëve jashtë shtetit.

## KATEGORI DHE SHERBIME TË TJERA

Në Qendër për Pune Sociale ofrohen sherbime edhe për këto gategori jane dhenë:

Vertetime për lirim nga shtëtësia e Kosovës 211

Certifikata për zotësi të veprimit për punë dhe për armbajtje 489,

Asistime ne polici per fëmijët e mitur dhe raste te dhunës në familje 80,

Pjesmarrje ne seancë gjygjsore 100,

Vizita në familje 108,

Kontaktim prind fëmijë 170,

Seanca konsultime dhe këshillime 358

Bashkëpunim me Institucione 74

Konstatime Zyrtarë 25

Regjistrim i më vonshëm i fëmijëve 2 etj

Gjithashtu-vlenë për të njoftuar organet përkatese te Drejtori se Urbanizmit, Bordin e drejtorve të KK-es Vushtrri,Kryetarin e Komunes,Komisionin përgjegjes i cili është caktuar për verifikimin e dokumentacioni të parashtruar në Drejtorin e Urbanizmit KK-es Vushtrri, Ministrine e Planifikimit Hapsinor të Mjedisit të Republikes se Kosovës, që për here të tret kamë ushtruar kerkesen me daten 15.03.2016 , ne Drejtorin e Urbanizmit KK-es Vushtrri, për të mos skaduar afati i dytë i vazhimit te lejes se ndertimit prej 2 vjetesh të dates 08.06.2016,lidhur me leshimin e lejes së ndertimit te shtepis ose legalizimit, por sipas ligjit ne fuqi të ndertimit të shtepiave për banim të përsonave Fizik apo Juridik vitit 2012.

Në bazë të nenit 23 dhe 26 të Ligjit për Planifikim Hapsinor nr. 2013/14 dates 03.07.2003, nenit 32 dhe 33 Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndëtim e objektit 01 Nr. 119/10 të dates 27.05.2010 drejtoria e Urbanizmit duhet vendosur, pasi qe procedura ka filluar ne vitin 2012 edhe kjo qeshtje duhe përfunduar me ligjin e vitit 2012.

Bazuar ne LEJE URBANISTIKE 08 Nr.353-2324/66 dt. 08.05.2012 të lejuar nga Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtjeës të Mjedisit KK-ës Vushtrri, dates 08.05.2012 Pronarit Ismail Hazirit, duke u bazuar në ligjin ne fuqi të vitit 2012 mbi ndertimin e shtepiave dhe dokumentacionit të bashkangjitur kesaj deklerate-kerkeses te kerkuara nga ana e Drejtoris së Urbanizmit KK-es Vushtrri, të parapar me ligjin e urbanizmit për here të tret me daten 15.03.2016, kamë Ushtron Kerkese për leshimin e Lejes se ndertimit të

shtepis, për të mos skaduar afeti i kerkeses se dyte të dates 08.06.2016. duke i bashkangjitur shtes përseri edhe dukumentacioni e ri si vijon:

- Fleten Poseduese
- Kopjen e planit te prones si dhe pagesen e taksave administrative pre 9,oo eruo. per flet posedues dhe kopje te planit.
- Kopjenë e Lejes Urbanistike 08.Nr. 353-2324/66 dates 08.06.2012 mbi Caktimin e vendit kushteve të parapar për ndertimi e shtepisë me kopjen-skemen e protokol Rregullimit të lejuar nga Drejtori për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit KK-es Vushtrri, mbi përcaktimin e kushtetve dhe afatit të parapar për ndertimin e shtepis per banim.
- Tre ekzemplar te Projektit Kryesor me kaseten e inçizimit te Objektit të banimit P + I të projektuar nga ekspertet e lamive përgjegjës te fushave përkates të Arkitektura,Statika, Instalimt
  -Pelqimin e KEK njisis Punuese Mitrovicë.
  -Pelqimin e Ndermarrjes se Ujësjellsit dhe Kanalizimit,Njisis punonjese Mitrovictë me deftesen e pageses se takses administrative ne shum prej 6,00 euro.
  -Vlen për te theksuar edhe pas kerkeses se tret të ushtruar në Drejtorin e Urbanizmit të KK-ës Vushtrri, nuk me është leshuar leja e ndertimit të shtepis e as nuk mu është dhanur as një përgjigjëj me gojë e as me shkrim.
- Ndersa tri here me rradh me kane detyruar për të paguej taksa administrative dhe shpenzime tjere, administrative për të njejtjen çeshtje, që do të thot së në as një dispozit Ligjore apo Kushtetues nuk parashifet për të njejten qeshtje të pages taksa tri here me radh.
- Unë kesaj deklerat do tja bashkangjes deshmi-dokumentacioni, leshuar nga Drejtori Katastrale KK-es Vushtrri, gjërë në fund të vitit 2016, me fleten poseduese dhe kopje të planit e kame poseduar parcellen e ndar katastrale nr. 2037/5 prej 5 ari me kultur shtep prej 1, 20 ari metrash, ndersa troll-oborr 3,80 m-2 , gjithsejt 5 ari. të fletes posedues nr. 2901 Zona katastrale Vushtrri, (Kontrata e vertetuar ne Gjykaten Komunale Vushtrri Vr. Nr.212/76 dt.07.04.1976, si dhe parcelln katastrale nr. 2038/4, e Drejoris Katastrale KK-es Vushtrri, me një siperfaqe prej 1.75 m-2 të fletes posedues nr. 2901 Komuna Katastrale Vushtrri, sipas Aktgjykimit te formes se prer te Gjykates Komunale Vushtrri "C" nr. 147/80 11.04.1980 i plotfuqishem me daten 11.04.1980, pasi qe palet kane heq dorë nga e drejta e ankese, gjithësejt 6.75 m-2, ari.

-Vlen për të theksuar, se si është e mundur, që në shenime katastrale te planit te mos Kete evidencë te nderjes te prones edhe pas pronari i ka dorzimuar Drejtoris Katastrale KK_es Vushtrri kopjet e planit mbi pronsin për caktimin e kufijve edhe ne bazë te ketyre kopjeve-shenimeve Drejtori e Urbanizmit KK-es Vushtrri me është leshuar Leja Urbanistike nr. 08 nr. 353-2324/66 dates 08.06.2012, tani përseri kerkohet nga Unë që te angazhom një kompanit privat të gjeodezis për ta punuar-verifikuar për caktuar kufit ne kopjen shabllanë te fotografimit ajrore i cili punim pronarit po kushton 835,00 euro për shkak të mos kryrje të punese nga punëtoret e gjeodezis, sepse unë ju kamë afryar të gjtha provat e duhhura me kopjen e plani katastral të prones të vertetuar nga Gjykata Komunale e Vushtrri, të parceles nr.2037/5 dhe 2038/4 të zanes katastrale Vushtrri nr. cilin ndryshem të Ndermarrjes Projektuese Sherbyese BS Arkitekt Prishtinë, të cilen e kamë paguar ne shume prej 500,00 euro. dhe

me ka kushtuar i cili me ka garantuar se projekti i objekti te ndertuar te shtepis, është bërë në bazë të normave dhe standarteve investive, i cili i plotson ne tersi kerkesat ligjore dhe teknike për Ndertimit e shtepis ose -Legalizimit për 0bjektin e banimit P+1+K i cili gjindet në Rr."Avni Kutllovci"tani Rr."Istref Haziri " nr. 15 Vushtrri të fleses posedues Zanes katastrele Vushtrri nr.2037/5 dhe 2038/4 me nje siperfaq prej 6.75 ari.

Sherbimi i Drejtoris Katastrale i KK-es ne Vushtrri, është i obliguar që të bër çdo ndryshim katastrale në bazë të fletes poseduese që e posedon pranari edhe kopjen e planit, por nuk guxon të bere ndryshime pa pajtimin e palve dhe deshmive të organeve kompetenteështu si ka qënë gjendja e ma parshme momentale e fotografimit ajror e jo ti asgjasoj tersish shenime e planit katastral. sepse me kete bere veper penale tja mohojësh dokumentit pronari i cili posedon deshmit mbi prone e vertetuar nga Gjyqësori apo organit kompeten kjo është ne kundershtim me ligjine dhe kushtetuten.

-Ndryshimet i bërë Drejtoria e Sherbimit administrativ katastrale, ne bazë te dokumentacionit valid-Komisioni pergjegjes dhe prezenca e pronarit, ne te kunderte bjen ne kundershim me ligjin mbi te drejtjen e pronsis dhe rregullimin katastral te pronave.

Si mundet të leshon një çertifika mbi ndertimin apo legalizimin e shtepis për banim nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtes se Mjedisit KK-es Vushtrri, e cila nuk ka kurfar mbrojtje të prones - pronsis për shtepis. Duke marrur për bazë keto te dhana:
-Me rastin e shtjes se shtepis blersi duhet njoftuar se kjo shtepi nuk ka leje te Ndertimit-por te legalizimit,që do të thot pronarit do të dëmtohet pa fajne e tij.
- Korpurata e Enegjis Elektrika nuk i garanton siguri, Furnizim me rryme, mirëmbajte te rrjetit dhe si shkaktar është vete korporata, si mundenit të fajsoni pronari,
-Ndermarrja e Ujësjellsit nuk e mirëmbajen rrjetit e ujësjellit dhe kanalizimit dhe si shkaktar është jo si mundet të fajsohet pronari, që do të thot së kjo qeshtje nuk është kompetencë e Drejtoris së Urbanizmit por kjo është qeshtje është qeshtje Gjyqësorit e cila nuk ja aprovon padin dhe kerkes padin paditesi per shkak te mos posedimit te lejes se ndertimit nga Drejtori e Urbanizmit edhe pse ndosha shtepia ju ka djegur shtepija.

Gjithashtu po ju njoftojë së Unë posedojë mbi 80% te fakturave të ndertimit te shtepis te vitit 2012, me të cilin deshmojë se Drejtori e Urbanizmit ka bërë shkelje të procedures për mos leshimin e Lejes se Ndertimit, pasi qe nuk ka pasur kurfar pengese ligjor.

E njoftojë Drejtorin e Urbanizmit KK_es Vushtrri si dhe të gjith 0rgane Kompetente KK-es Vushtrri gjere me tani kamë paguer 215,5o euro taksa administrative komunale si dhe 500,00 euro. për projektet e ndertimit te shtepis me inqizimin te kasetes digjitale, që do te thot gjithsejt 215,50 + 500,00 = 715,50 euro.ndersa për kopje të planit të prones shkoni te një Kompani privat Katastrale, me ka kushtuar 835,00 euro. edhe pse i posieduar kopjen e planit dhe çdo gja ishte ne rregullimin të dokumentacionit.

Kerkojë nga Drejtori Urbanistike e KK-es Vushtrri qe të me lirojnë tersisht nga taksat administrative komunale, për shkak se shtepia e vjeter e cila ka qënë e demtuar nga bobartimet e luftes se vitit 1988/1999, për të cilen na është rekamandura nga Drejtoria e Urbanizmit KK-es Vushtrri që të rrenohet pasi qe është e rrezikeshme për banim, ndesa shtepia e re është ndertuar pjesrisht mbi temelin e shtepis se vjeter, qe sipas ligjit ne fuqi ka qenir 50 % te paguhet taksa ,gjithashtu jamë pjestar i UCK, Pensionit me te ardhura

mujore prej 190, 00 euro. edhe ka paguer taksa tri ma pare për të njejten qeshtje për shkak te neglizhences se Juaj dhe jo ligjore edhe tani jame ne nje pozita material , ekonomike edhe sociale jo te volitëshme.

Te gjitha kerkesa e lartëpërmednur jane të bazuar ne dispozita ligjior për lejimin e lejes së ndertimit të shtepis së banimit.

Bazuar sipas formularin standard te aplikacionit të kategoris I dhe te dytes II.të Ligjit ne fuqi vitit 2012 me rastin e ushtrimit të kerkeses ne Drejtorin e Urbanizimit KK-es Vushtrri duhet vendosur për lejimin e lejes së ndertimit të shtepis së banimitpasi ligjit ne fuqi te vitit 2012, pasi që për ketë çeshtje fajtor është Drejtoria Urbanizmit për shkak te neglizhenes dhe pa pergjegjsis.

DEKLERATEN E PRONARIT TË NDËRIMIT PA LEJE

- Për ndërtimin Kategoris I dhe shtëpitë e kategorisë II

Nuk do ta neshkruej, për shkak se Unë kerkesen e kamë ushtruar në menyr institucionale dhe sipas rekamandimit të Drejtori së Urbanizmit të KK-ës Vushtrri për leshimin e lejes për ndertimin e shtepis për banim.

Lenda e ime duhet vendosur ne bazë te ligjit ne fuqi të vitit 2012 për leshimin e lejeve të ndertimit për banim.

Vlen për të theksuar së unë as kend nuk e kamë penguar edhe nuk do ta pengojë inspektimin e nderteses të ndertuar nga ana e organit kompetent, kjo është ne te mirë e pronarit dhe familjes se tij, qe dokumenti i cili leshohet për leshimin e leja për ndertimit e shtepis për banim apo legalizimit të jetë dukumet i vlefshem dhe legjitim.

Formulimi i Teksti të deklerates nga ana e Drejtorive të Urbanizmi apo Ministris në Rreshtimin dy dhe tre të deklerates është nenqmues për pronarin, sepse po ja humbni -demtoni vler e prones pronarit si kur të ishtë ndonj ardhacak ne pronen e vet,ndersa shtepit janë ndertuar para syve të pushtetit.

Deklerat duhet dhenur pronari me vedtdijen të plotë pa imponim të as kujt dhe duhet shqyrtuar nga organe kompetente apo komisioni të caktuar për kete qeshtje, pa ja cenuar të drejten e pronsis, sepse as kush nuk ja ka falur,por e ka fitura me mund dhe punë e cila është pasuri-pron e shetjt.

Certifika të cilen e leshon Drejtoria e Urbanizmi KK-es Vushtrri për legalizimin e shtepis nuk ka kurfar bazë Juridike, përveq realizimin-mbledhenë e taksave administrative.

Ju nuk e merrni përgjegjsin për sistruktures e ndertimit të shtepis, por projektuesi i projektit te ndertimit.

Unë si pronar betohem se nen përgjegjsin morale, materiale dhe penale për të gjitha të dhanat e lartëpërmendura së janë të verteta dhe të sakta.

VREJTJE:

Me 23.11.2020

DEKLARUESI-PRONARI
Ismail Haziri

Nenshkrimi i Pronarit- të prones ne procedur

Nenshkrimi i zyrtarit kompeten që e pranon këtë deklleratë

Nr. Prot. 01/1423 3705/21
Data 13.09.21
-64-
PRISHTINË

MINISTRISË SË MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS-PRISHTINË

PËR: MMPHI- DIVIZIONI I NDERTIMIT
Drejtori-Shefit të Divizionit Ndertimor; z. Xhemail Metolli
dhe Kryetarit te Komisionit, për shqyrtimin e ankeseve.

NGA: Pronari Ismail Haziri nga Vushtrri Rr."Isterf Haziri" nr. 15

LËNDA: Plotësimi i dytë shtës i ankesesë 02-IWS. nr. 2443/21 dates 21.06.21, lidhur me trajtimin e Ndertimit pa leje, nga ana e Komisionit, që themelohet nga MMPH. Prishtinë, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e vendimevei paraprake.

Më anën e keti plotësimit të dytë-shtës të ankeses 02 IWS. Nr. 2443/21, të dates 21.06.2021, të dorzuar Titullit të lartëpërmendur, si dhe të Ndëmarrja Projektuese Ndërtimore BS Arktitekt Prishtinë,lidhur me marrjen e ketij:

**V E N D I M**

Me të cilin caktoen projektuesit kryesorë të cilet do të hartojnë projektin për legalizimin për objektin e Banimit P+1+K i cili gjindet në Vushtrri. si vijon:

1. Arkitektura.................................... Bersant Selimin
2. Llogaria Statike............... ..............Shpëtim Hajdaraj
3. Instaimet elektrike......................... Liridon Berisha
4. Ujësjellësi dhe Kanalizimit............Nafije Loshi

Në bazë punimeve dhe përcjelljes së ndertimit të objektit ndertimor në vendin e përcaktuar të Drejtoris së Urbanizmit të KK-es ne Vushtrri konstatimeve dhe Bazë të konstatimit kanë për përpiluar këtë:

**D E K L E R A T**
Me të cilen deklarojmë që Dokumentacioni Investivo-Teknik për Projektin per Legalizim për Objektin e Banimit P=1+K
Është hartuar në bazë të normave dhe Standardeve investive.

Në bazë të Vendimit dhe Deklerates të hartuara ne objektin e ndertimit ka Konstatuar se janë përmbushur, në bazë të normave dhe Standarteve investive, dhe ne fund është Nenshkruar nga ekspertete e lartë shenuar.

Pas deklarates së nenshkruar, nga ana e ekspertve për katës ata kanë leshuar edhe kete Konstatime:

Në bazë të nenit 39 të gazetes zyratre te Kosoves nr. 5/86 kamë leshuar këtë

**V E R T E T I M**

Në baze te vendimit te Arktitektes Ardita Latifaj, dhe ne perputhje te nenit 23 dhe 39 te gazetes zyrtare te Kosoves nr. 5/86 është bërë Kontrolliti brendeshme i dokumentacionit dhe ne forme te raportit kemi dhene vrejtjet tona. .
Së pari është bere kontrollimi i breneshem i dokumentacionit dhe ne forme raporti i kemi dhene vrejtjet e tyre për ti plotësuar.
Pas kontrollimit te dyte te dokumentacionit investiv teknikishte konstatuar se i njejti i knaqe kerkesat ligjore per kete lloj dokumentacioni. Kerkesat.

**Pronari Ismail Haziri nga Vushtrri Rr."Avni Kutllovci" tani Rr."Istref Haziri nr. 15**

**Bazuar ne Ndërmarrjen Projektuës ndërtimore BS Arkitekt Prishtine, dhe Dekleraten te ekspertve të lamis përkates të caktuar me Vendimin e ndermarrjes në fjale si dhe të deklerates te nenshkruar dhe Vendimin e Arktitektes Ardita Latifaj te nenshkruar edhe konstatuar si vijonë;**

**Në bazë te kesaj konstatoj se:**
**Dokumentacioni investivo teknik per realizimin e Projektit per legalizimin e objektit te banimit P+1 ne Vushtrri, i ploteson ne teresi kerkesat ligjore dhe tektike.**
**Pronari Ismail Haziri Pranon në tërsi Dekleraten, konstatime e ekspertve të lamive perkates, te caktuara nga ana Ndermarrjes Projektuese Ndertimore BS Arkitetekt Prishtinë, lidhur me legalizimin e objektit te banimit P+1 te Projektura ne Shkurt te vitit 2014**
**Vlen për të theksuar se Unë pranoj të nenshkruar çdo dokumentacion, që është ne përputhje me ligjin te Vitit 2012, qoftë ate te dnertimit apo legalizimit, sepse Unë kamë ushtrruar kerkesen per ndertimin e shtepis ne vitin 2012 e që prej asaj kohe e gjere tetani nuk me kanë leshuar-lejuar leja e ndertimit te shtepis apo legalizimie edhe pse te gjitha dokumentacionit e nevojshme ishin te kompletuar ne afatin ligjore.**
**Andaj, kerkojë nga titulli i lartëpërmendur, që ankesa te miratohe e bazuar, ndersa Drejtoris se Urbanizmit KK_es ne Vushtrri ti REKAMANDOHET-Obligohet që ti leshohet Aktvendimi Mbi Legalizimin e Objektit, sipas ligjit ne fuqi te vitit 2012, sepse Unë nuk kamë ndertuar shtep pa leje por me leje dhe nen mbikqyrje te organeve Urbanistike dhe Inspekcionit KK_es Vushtrri.**
Bashkangjitur me kete plotesim te ankeses e bashkangjes Vendimin e Ndermarrjes Projektuese, Dekleraten e Ekspertve te lemive e ndryshme Konstetimet te punuar-hartimin e projetkuar te punuar ne shkurt te vitit 2014.

USHTRUESI I ANKESES

M13.09.2021

Ismail Haziri
nga Vushtrri Rr."Isterf Haziri"ne.15
Nr. ID. 1004321428
Nr.tel. 044960363

Ndërrmarrja projektuese ndërtimore

# BS Arkitekt

**Prishtinë**

## VENDIM

Me të cilin caktohen projektuesit kryesorë të cilët do të hartojnë Projektin per Legalizim për **Objektin e Banimit P+1+K** i cili gjendet në Vushtrri

---

FAZAT:

| | |
|---|---|
| ARKITEKTURA ............................................. | **Bersant SELMANI** |
| LLOGARIA STATIKE ...................................... | **Shpëtim HAJDARAJ** |
| INSTALIMET ELEKTRIKE ............................... | **Liridon BERISHA** |
| UJËSJELLËSI dhe KANALIZIMI ......................... | **Nafije LOSHI** |

## DEKLARATË

Me të cilën deklarojmë që Dokumentacioni Investivo-Teknik për Projektin per Legalizim për Objektin e Banimit: **P+1+K**
është hartuar në bazë të normave dhe standardeve investive.

FAZAT:

| | |
|---|---|
| ARKITEKTURA | ______________ |
| LLOGARIA STATIKE | ______________ |
| INSTALIMET ELEKTRIKE | LIRIDON BERISHA |
| UJËSJELLËSI dhe KANALIZIMI | NAFIJE LOSHI |

Drejtor:

Bersant SELMANI

+37744175850
bersantselmani.com

Ne baze te nenit 39 te gazetes zyrtare te Kosoves nr 5/86 leshojme kete

# Vertetim

## Mbi kryerejen e kontrollit teknik te brendshem te dokumentacionit investivo teknik

Ne baze te vendimit te Arkitektes Ardita Latifaj, dhe ne perputhje te nenit 23 dhe 39 te gazetes zyrtare te Kosoves nr 5/86, eshte bere kontrolli i brendshem i dokumentacionit dhe ne forme te raportit i kemi dhene vrejtjet tona.

Pas kontrollit te dyte te dokumentacionit investivo teknikeshte konstatuar se i njejti i knaqe kerkesat ligjore per kete lloj dokumentacioni.

Ne baze te kesaj konstatoj se:

Dokumentacioni investivo teknik per realizimin e Projektit per legalizimin e objektit te banimit P+1 ne Vushtri, i ploteson ne teresi kerkesat ligjore dhe teknike.

Ardita Latifaj, Arkitekte

BS ARKITEKT

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Sheshi "Ahmet Krasniqi"nr. 10 , Tel.038/200 42402, E-mail: ferit.idrizi@rks-gov.net

| | |
|---|---|
| PËR/ZA/TO: | **Kuvendin e Komunës** |
| CC | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | |
| NGA/OD/FROM: | **Ferit Idrizi**<br>Kryetari i Komunës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Letër Rekomandim për mbledhje të KK-së të datës 24.02.2022 |

Në pajtim me nenin 17 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008), dhe nenin 22 paragrafi 4 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 prill 2019), nenin 27 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) nr. 09/202 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, si dhe bazuar në raportin nr. 8614/22, dt. 18.02.2022 të komisionit profesional për mbikëqyrje të zbatimit të kontratave për shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës (kiosqeve) nga pronar të bizneseve në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri, Kuvendit të komunës i jap këtë,

REKOMANDIM

1. I rekomandohet kuvendit të komunës të bëj shfuqizimin e pjesërishëm të nënpikës 1.1.1 të vendimit të KK-së 01Nr. 125/14, dt. 28.05.2014 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër (me qira) të pronës së paluajtshme të komunës (kiosqeve) në Rr. "Adem Jashari (tani Sheshi "Hasan Prishtina"), ngastra kadastrale nr. P-653, Zona Kadastrale Vushtrri, e që ka të bëj me këto lokale (kiosqe) për të cilat janë lidhë kontratat për qiradhënie, si në vijim:

   1.1 Kontrata 14Nr.003/P2/17, dt. 16.01.2017, lokali nr.6.
   **Qiramarrës**: Erxhan Ahmeti,
   Shfrytëzues i lokalit, Sami Plakolli.

   1.2 Kontrata 14Nr.10/14, dt. 17.11.2014 lokali nr.10.
   **Qiramarrës:** "Te Beni-B"
   Shfrytëzues i lokalit: "Mobil Shop"

1.3 Kontrata 14Nr. 003/P2/17 dt. 16.01.2017 lokali nr.12.
**Qiramarrës:** Shpresa Klinaku
Shfrytëzues i lokalit: Kompania e sigurimeve "Eurosing"

1.4 Kontrata 14Nr.13/14 dt. 17.11.2014 lokali nr. 13.
**Qiramarrës:** DPT "Bina"
Shfrytëzues i lokalit: Zyra për shërbime Juridike "Juristi"

2. Obligohet Kryetari i Komunës të merr vendim për shkëputje të kontratave të cekura nga nënpika 1.1-1.4 e këtij rekomandimi konform legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Me ligjin në fuqi për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme te komunës, përkatësisht nenin 22 të këtij Ligji, si dhe Rregulloren e Qeverisë së Kosovës nr. 09/202 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Komuna mbikëqyrë realizmin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Në zbatim të dispozitave të ligjit dhe rregullores në fjalë, Kryetari i komunës ka autorizuar komisionin profesional për verifikim të zbatimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të kiosqeve në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri. Komisioni në bazë të të gjeturave, ka hartuar raport me shkrim në të cilin ka konstatuar se nga gjithsejtë 14 kontrata të lidhura nga komuna me qiramarrës, 4 prej tyre kanë bërë shkelje të kontratave përkatësisht iu kanë shmangur qëllimit të shfrytëzimit të pronës komunale duke e tjetërsuar të drejtën e shfrytëzimit, te personat e tretë.

Në paragrafin 4 të nenit 22 të Ligjit të lartpërmenur saktësohet se, citojmë: "Në rast të evidentimit të shkeljes së kontratës apo shmangies nga qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës nga shfrytëzuesi, kryetari i komunës obligohet që në çdo kohë të njoftoj Kuvendin e Komunës me shkrim, së bashku me rekomandimin e tij për shkëputje të kontratës apo masat e caktuara ndaj shfrytëzuesit".

Sipas të dhënave në raport të komisionit, qiramarrësit iu kanë shmangur qëllimit për të cilin iu është dhënë prona e paluajtshme e komunës në shfrytëzim, që donë të thotë se nuk e kanë përdorë pronën e komunës për ushtrim të veprimtarisë së tyre por të njëjtën ia kanë tjetërsuar peronave të tretë me çka kanë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit dhe Rregullores së sipër cituar si dhe dispozitave të kontratave të lidhura në të cilat gjithashtu është përcaktuar se prona komunale ipet në shfrynim pa të drejtë tjetërsimi te personat e tretë, ashtu siç është përcaktuar edhe në paragrafin 5 të nenit 19 të ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Andaj, në respektim të nenit 22 pika 4 Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të komunës dhe nenin 27 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) nr. 09/202 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i REKOMANDOHET kuvendit të komunës që të merr vendim si në pikën 1 dhe 2 të këtij rekomandimi.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
Nr. / Br. 8614 / 22
Nr. i fq. / Br. st.
Data: / Datum: 18.02.2022
VUSHTRRI - VUČITRN

**REPUBLIKA E KOSOVËS** **KOMUNA**
**VUSHTRRI**

| | |
|---|---|
| DATË/A | 16.02.2022 |
| REFERENC-Ë: | |
| PËR/ZA/TO: | **z. Ferit Idrizi, Kryetar i Komunës**<br>**z. Albanez Tahiraj,Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë** |
| Kopje | |
| PËRMES/PREKO/THROUGH | |
| NGA/OD/FROM: | Komisioni i formuar në bazë të Vendimit 02Nr.94/22, dt.10.02.2022.<br>Ilmi Zeqiri, kryesues<br>Selim Musa, anëtar<br>Fadil Selimi, anëtar |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Raport mbi gjendjen faktike të objekteve montazhe në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri |

Të Nderuar

Bazuar në Vendimin 02Nr.94/22, dt. 10.02.2022, Komisioni në përbërje Ilmi Zeqiri, Selim Musa dhe Fadil Selimi, me dt.14.02.2022, ka dal në vendin e ngjarjes për të verifikuar gjendjen faktike të objekteve të përkohshme montazhe (kiosqeve) në sheshin "Hasan Prishtina" në Vushtrri, nëse janë duke u shfrytëzuar nga operatorët ekonomik sipas kushteve të kontratave për shfrytëzim afatshkurtër të lidhura në mes tyre dhe Komunës së Vushtrrisë, dhe lidhur me këtë komisioni paraqet këtë:

## RAPORT

1. Lokali Nr.1. DPZ "Silver" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.01/14, dt.17.11.2014.
2. Lokali Nr.2. "Skender Spahiu" B.I. si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.001/P4/16, dt.03.02.2016.
3. Lokali Nr.3. DPZ "MX-138" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.03/14, dt. 17.11.2014.

4. **Lokali Nr.4 DPZ "Qendra" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.04/14, dt.17.11.2014.**
5. Lokali Nr.5. DPSH Kiosku "Niti" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.05/14, dt.18.11.2014.
6. Lokali Nr.6. Erxhan Ahmeti me nr. personal 117278019, **nuk e shfrytëzon** lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.003/P2/17, dt.16.01.2017 pasi që lokali nuk shfrytëzohet nga z. Ahmeti por nga operatori ekonomik "Migros" përfaqësuar nga Sami Plakolli.
7. Lokali Nr.7. DPSH Frizer për meshkuj "Bedria" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.07/14, dt.17.11.2014.
8. **Lokali Nr.8. DPT Kiosk "Te Bekimi" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.08/14, dt.17.11.2014.**
9. Lokali Nr.9. DPT "Rilindja-N.XH" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës pë Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.09/14, dt.17.11.2014.
10. Lokali Nr.10. DPT Kiosk "Te Beni-B" **nuk e shfrytëzon** lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.10/14, dt.17.11.2014, pasi që lokali shfrytëzohet nuk shfrytëzohet nga ky operator ekonomik por nga një operator tjetër me destinim"Mobil Shop".
11. Lokali Nr.11. NSH "Lotaria e Kosovës", lokali është i mbyllur për shkak të ndalimit të veprimtarisë të lojërave të fatit me ligj. Ndërmarrja në fjalë ka shprehë gatishmërinë të vazhdoj kontratën me shpresë që do të filloj punën në të ardhmen.
12. Lokali Nr. 12. Shpresa Klinaku me nr. personal 1005108370, **nuk e shfrytëzon** lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.003/P2/17, dt.16.01.2017, pasi që lokali shfrytëzohet nga Kompania e Sigurimeve "Eurosing".
13. Lokali Nr.13. DPT Kiosk "Bina", si operator ekonomik **nuk e shfrytëzon** lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14.Nr.13/14, dt.17.11.2014, pasi që lokali shfrytëzohet nga operatori tjetër ekonomik Zyra për Shërbime Juridike "Juristi".
14. Lokali Nr.14. DPZ "Casio" si operator ekonomik e shfrytëzon lokalin sipas kushteve të Kontratës për Qiradhënie Afatshkurtër 14Nr.14/14, dt.17.11.2014.

Nga shënimet e cekura më lartë del se nga 14 operator ekonomik, 4 prej tyre ( Lokali nr.6, 10,12 dhe 13) nuk i kanë shfrytëzuar lokalet sipas kushteve të Kontratave për Qiradhënie Afatshkurtër duke dhënë në shfrytëzim lokalin operatoreve tjerë ekonomik, në kundërshtim me nenin 19 paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të pronës Komunale dhe nenit 7, paragrafi 7.4 të kontratave në fjalë.
Sa i përket mundësisë së vazhdimit të kontratave për operatorët ekonomik të cilët ju kanë përmbajtur kushteve të kontratës, Vendimi i Kuvendit

01Nr.125/14, dt.28.05.2014 parasheh mundësin e vazhdimit sikurse që këtë mundësi e parashohin edhe kontratat. Mirëpo, nëse një mundësi të tillë a e parasheh Ligji aktual për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të pronës komunale, është e nevojshme të merret opinion ligjor nga Zyra Ligjore e Komunës.

Me respekt

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN
01 Nr. / Br. 125/14
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum 28.05.2014
VUSHTRRI - VUČITRN

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës-Vushtrri**

Në bazë të nenit 12.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 7 të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës Nr.04/L-144, nenit 4 të Rregullores QRK NR.23/2013 për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës, nenit 40.2 pika (k) të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më **28.05.2014**, mori këtë:

# V E N D I M
# PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE

## Neni 1

**1.1.** Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronave të paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në këto lokacione:

**1.1.1.** Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Adem Jashari" ngastra kadastrale nr.P-653, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 182 m2 dhe e cila është e propozuar të ndahet në katërmbëdhjetë hapësira me nga 13 m2.

**1.1.2.** Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Tirana" ngastra kadastrale nr.P-256, zona kadastrale Vushtrri pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 36 m2 dhe e cila është e propozuar të ndahet në katër hapësira me nga 9m2.

**1.1.3.** Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Kruja" ngastra kadastrale nr.P-1102, zona kadastrale Vushtrri, pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe ndërtuese prej 51 m2 e cila është e propozuar të ndahet në pesë hapësira tri me nga 9m2 dhe dy me nga 12m2.

**1.1.4.** Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Dëshmorët e Kombit" ngastra kadastrale nr. P-1116 dhe P-494/1 zona kadastrale Vushtrri, prona të komunës, të cilat përfshijnë një sipërfaqe ndërtuese prej 64 m2 dhe e cila është e propozuar të ndahet në dy hapësira me nga 32m2.

**1.1.5.** Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Xhon Buzuku" ngastra kadastrale nr. P-420/2 zona kadastrale Vushtrri pronë e komunës e cila përfshin një sipërfaqe prej 47 m2 dhe e cila është e propozuar të ndahet në tri hapësira një me 9m2, një me 12m2 dhe një me 26m2.

**1.1.6.** Lokacioni i cili gjendet me lokalet në rrugën "Jeton Tërrstena" ngastra kadastrale nr. P-2254/49, zona kadastrale Vushtrri prona të komunës të cilat përfshijnë një sipërfaqe prej 133 m2, për të cilat është propozuar të jepen sipas skicës:

*Lokali nr.1 me sipërfaqe prej 16m2,
* Lokali nr.2 me sipërfaqe prej 12m2,
* Lokali nr.3 me sipërfaqe prej 11m2,
* Lokali nr.5 me sipërfaqe prej 11m2,
* Lokali nr.7 me sipërfaqe prej 21m2,
* Lokali nr.8 me sipërfaqe prej 62m2

1.1.7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe skicat e lokacioneve të përcaktuara si dhe certifikatat e njësisë kadastrale.

**Neni 2**

2.1. Pronat e cekura si në nenin 1 të këtij vendimi jepen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit personave fizik dhe juridik, si objekete të karakterit të përkohshëm (montazh), në kohëgjatje prej 5 viteve me mundësi vazhdimi edhe për 5 vite.
2.2. Çmimi fillestar për m2 është 2.00 € në muaj.
2.3. Investimet për ndërtimin e lokaleve afariste i bart fituesi i ankandit.
2.4. Të gjitha shpenzimet të cilat kanë të bëjnë me lokalin, i bart shfrytëzuesi i ankandit.
2.5. Komuna rezervon të drejtën e shkëputjes së njëanshme të kontratës, në këtë rast komuna duhet ta njoftojë shfrytëzuesin e lokalit 3 muaj para ndërprerjes së kontratës.

**Neni 3**

Obligohet Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Shpëtim Zhegrova**

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOMUNA VUSHTRRI

**Për,** Kuvendin e Komunës
**Propozues,** Kryetari i Komunës
Ferit Idrizi ________

**Çështja për shqyrtim,** Propozim-vendim

---

Bazuar në nenin 12 dhe 58 "h" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040/2008, nenit 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, neni 42.1 "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _______2022 merr këtë:

VENDIM
PËR NDRYSHIM DHE PLOTËSIM TË VENDIMIT

1. Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet vendimi i Kuvendit të Komunës 01Nr.24/22, dt. 31.01.2022 përkatësisht paragrafi 1 pika 1.4 ashtu që në vend të, **Maliq Ferizi**, Drejtor për Mbrojtje dhe Shpëtim duhet të jetë **Bajram Beqiri** zyrtar në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Vushtrri.

2. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe 7 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli

________________

Kryesuese e Kuvendit

## A r s y e t i m

Bazuar në Udhëzimin Administrativ të MPB-së Nr.27/12 dhe MAPL-së Nr.03/12 për themelimin e KKSB-së, njëri nga anëtarët e Këshillit komunal për Siguri në Bashkësi duhet të jetë një përfaqësues i sektorit të emergjencave civile.

Siç është e ditur, në mbledhjen e kuvendit të komunës mbajtur në muajin janar 2022 ku është themeluar Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, nga ky sektor është emëruar z. Maliq Ferizi, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim. Mirëpo, i njëjti pas pranimit të vendimit të KK-së është deklaruar se nuk dëshiron që të jetë anëtar i KKSB-së dhe në këtë pozitë e ka propozuar z. Bajram Beqiri, zyrtar për emergjencë në Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Andaj, i propozoj kuvendit të komunës që ta miratoj këtë propozim vendim si në dispozitiv.

Me respekt!

**Republika e Kosovës** **Kuvendi i Komunës Vushtrri**

| | |
|---|---|
| **DATË:** | **23 shkurt 2022** |
| **PËR:** | **Kuvendin e Komunës** |
| **PROPOZUES:** | **Ferit Idrizi**<br>**Kryetar i Komunës** |
| **HARTUES:** | **Albanez Tahiraj**<br>**Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë** |
| **LËNDA:** | **Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtim të Tregut të Gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri** |

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 17 shkronjat (c) dhe (f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, dhe nenit 41.2, "ç" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më ______ 2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e lokacionit për ndërtim të Tregut të Gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri**

**Neni 1**

Me këtë Vendim caktohet lokacioni për ndërtimin e Tregut të Gjelbër për prodhime vendore në Vushtrri, në parcelën kadastrale P-70202016-00655-0, në sipërfaqe prej 1637 $m^2$, Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 2**

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

**Neni 3**

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikata mbi të drejtën e pronës dhe kopja e planit.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesja e Kuvendit**

______________________

**Melihate Basholli-Latifi**

# ARSYETIM

Prodhuesit vendor të produkteve bujqësore, ju kanë drejtuar Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë me kërkesë duke kërkuar nga Komuna e Vushtrrisë që të caktoj lokacionin për ndërtimin e Tregut të Gjelbër, ku prodhuesit në fjalë do të mund të shesin prodhimet e tyre bujqësore.

Pas analizimit të kërkesës në fjalë, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë vlerësoj se është në interes të Komunës së Vushtrrisë caktimi i lokacionit për ndërtimin e tregut në fjalë dhe një lokacion i tillë më i përshtatshëm në pjesën e parcelës së propozuar

Prandaj, Drejtoria në fjalë i propozon Kuvendit të Komunës që ta aprovoj këtë propozim-vendim.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
***Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure***
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

181 081

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70202016-00655-0

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **18-686/22** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 23.02.2022 - 13:59 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI |
| **Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:** | Vushtrri / Vushtrri / Vushtrri |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | VUSHTRRI / VUČITRN / VUSHTRRI |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-70202016-00655-0** | **PARCELË / PARCELA / PARCEL** | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | **1637** | | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivalište - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhurnuar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| VAROSH/TRG SLOBODE/VAROSH/TRG SLOBODE/VAROSH/TRG SLOBODE | | | | |



**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**

REPUBLIKA E KOSOVËS

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja ($m^2$)<br>Površina ($m^2$)<br>Area ($m^2$) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure | Rrugë E Pakategor/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad | | 1637 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Vushtrrisë** | 600535001 | VUSHTRRI / VUSHTRRI / VUSHTRRI / | | AHMET KRASNIQI | **1/1** | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

181681

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VUSHTRRI
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Vushtrri

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-70202016-00655-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 1637 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:555

Punoi/Obradio/Created:
Data/ Data/Date: 23.02.2022
Koha/ Vreme/ Time: 03:15:44
Nënshkrimi/Potpis/Signature:
Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director
Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shqip | Srpski | English LOGOHU

FILLIMI KËRKO DHE PARAQIT

Kërko

Lista e shtresës Ndihma

- Ortofoto
  - ☑ Orthophoto2018Rural
  - ☑ Orthophoto2018Malore
  - ☑ Orthophoto2018Urban
  - ☐ Ortofoto 2015 UAV
  - ☐ Ortofoto 2012
  - ☐ Ortofoto 2009
  - ☐ Ortofoto 2004
  - ☐ Ortofoto 2001
- Hartat Topografike
  - Harta Topografike 1:250000
  - Harta Topografike 1:25000 (2015)
  - ☐ Nomenklatura
- Rilevimi
  - ☐ Indeksi i Ortofotove 2018
- Rrjeti Rrugor
  - ☑ Autostradë
  - ☑ Rrugë Nacionale
  - ☑ Rrugë Rajonale
- Njësi Administrative
  - ☐ Kufiri Shtetëror
  - ✓ Kufijtë dhe Emrat e Komunave
  - ☐ Zonë urbane
  - ☐ Zonat Postale
- Njësitë Kadastrale
  - ☑ Zonat Kadastrale
  - ☑ Parcelat
    - ☑ Numri parcelës
  - ☑ Ndërtesat
    - ☑ Numri ndërtesës
- Sistemi i Adresave
  - ☑ Rrugët
  - ☑ Emrat e rrugëve
  - ☑ Adresa

1 : 500 Auto ☐ Shfaq keshillat




KosovaRef01 Pozita:

Copyright © Agjencia Kadastrale e Kosovës